



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 6 DHE 7 NËNTOR 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 6. i
7. NOVEMBRA 2008. GODINE**

NËNTOR - NOVEMBAR

2008

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 17 tetor 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për faljen,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lizingun financiar,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, nr. 03/L-002,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, nr. 03/L-003,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, nr. 03/L-018,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë, nr. 02/L-073,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Ansamblin e këngëve dhe të valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera, nr. 03/L-056,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kualifikimet kombëtare, nr. 03/L-060.
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat, nr. 03/L-077,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet për mbrojtjen e bimëve, nr.03/L-042.
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë private,
16. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri...për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionin të Konkurrencës,
17. Shqyrtimi i Rekomandimit Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës,
18. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm, dhe
19. Njoftimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Usvajanje Zapisnika sa prethodne plenarne sednice,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o poljoprivredi i seoskom razvoju,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o pomilovanju,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o osnivanju Departmana za sudsku medicinu,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o finansijskom lizingu,
7. Razmatranje Preporuke za amandamentiranje Zakona o izmeni i dopuni Privremenog krivičnog zakonika Kosova br. 03/L-002,
8. Razmatranje Preporuke za amandamentiranje Zakona o izmeni i dopuni kodeksa o privremenoj krivičnoj proceduri Kosova, br. 03/L-003,
9. Razmatranje Preporuke za amandamentiranje Zakona o završnim ispitu i i isputu državne mature, br. 03/L-018,
10. Razmatranje Preporuke za amandamentiranje Zakona o prekidu trudnoće,

11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o ansamblu pesama i igara „Shota“ i o drugim ansamblima,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o nacionalnim kvalifikacijama, br. 03/L-060,
13. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.2003/7 o arhivskoj građi i arhivama, br. 03/L-077,
14. Drugo razmatranje Nacrta zakona o proizvodima za zaštitu biljaka, br.03/L-042,
15. Drugo razmatranje Nacrta zakona o privatnom osiguranju,
16. Razmatranje preporuke Komisije za privredu, trgovinu, industriju, energetiku, transport i telekomunikacije u vezi sa izborom kandidata za članove Komisije o konkurenciji,
17. Razmatranje preporuke Komisije za budžet i finansije u vezi sa predlogom Vlade o imenovanju članova Borda penzijskog trusta Kosova,
18. Razmatranje Izveštaja Komisije za budžet i finansije o nadzoru sprovođenja Zakona br. 02/L – 74 o unutrašnjoj reviziji, i
19. Informacija Parlamentarne grupe SLS o zameni članova u skupštinskim komisijama.

A g e n d a

1. Approval of the minutes from the previous session,
2. Time for Parliamentary questions,
3. First reading of the Draft Law on Agriculture and Rural Development,
4. First reading of the Draft Law on Pardon,
5. First reading of the Draft Law on the Establishment of the Department of Forensic Medicine,
6. First reading of the Draft Law on Financial Leasing,
7. Review of recommendation of the Law on amendment and supplementation of the Provisional Criminal Code of Kosovo, no. 03/L-002,
8. Review of recommendation for amending the Law amendment and supplementation of the Provisional Code of Criminal procedure of Kosovo, no. 03/L-003,
9. Review of recommendation for amendment of the Law on Final And Matura Exam,
10. Review of recommendation for amendment of the Law on Termination of Pregnancy,
11. Second reading of the Draft law on the National Song and Dance Ensemble “Shota” and Other Ensembles, nr. 03/L-056.
12. Second reading of the Draft law on National Qualifications, no. 03/L-060.
13. Second reading of the Draft law on amendment and supplementation of the law nr. 2003/7 on Archive Material and Archives, nr. 03/L-077.
14. Second reading of the Draft law on Products and Protection of Plants, nr.03/L-042.
15. Second reading of the Draft law on Private Security,
16. Review of recommendation of the Committee on Economy, Trade, Industry, Energy, transport and Telecommunications regarding the selection of members in Competition Committee,
17. Review of recommendation of the Committee on Budget and Finances regarding the Governmental proposal on appointing members of the Kosovo Pension Trust Board,
18. Review of recommendation of the Committee on Budget and Finances on overseeing the implementation of the Law nr. 02/L-74 for Internal Audit, and
19. Notification of the Parliamentary Group of SLS in replacing members of the Parliamentary Committees.

Seancën e kryesoi Kryetari i Kuvendit të Kosovës, **z. Jakup Krasniqi**.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar mysafirë,

Të nderuar qytetarë,

Kam privilegjin që në emrin tim dhe tuajin, në fillim të kësaj seance plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës të urojmë zgjedhjen e Presidentit të ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe zotin Obama për fitoren historike, të urojmë Kongresin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Senatin për zgjedhje që do të reflektojnë vizion, siguri dhe demokraci edhe përtej Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Sigurisht se përgëzime të veçanta meritojnë edhe Presidenti Bush dhe kandidati për president, zoti Mekein.

Të nderuar deputetë,

Përhëndesim Shtetet e Bashkuara të Amerikës, institucionet e tyre, qytetarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për mbështetje dhe mirëkuptim që kanë pasur në kontinuitet për Kosovën dhe qytetarët e saj dhe unë, edhe në emër të Kuvendit dhe të qytetarëve të Kosovës, konfirmoj miqësi të vazhdueshme që do të kenë institucionet e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Urime Shteteve të Bashkuara të Amerikës për shembullin e ri historik, për mësimin e demokracisë!

Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në Seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 84 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 6 pika 2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Nëse keni diçka lidhur me rendin e ditës, mund të paraqiteni. Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kolegë deputetë dhe ju Kabinet qeveritar,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kërkojmë që sot, urgjentisht, të futet në rend dite dhe të diskutohet për pjesën veriore të Mitrovicës meqë,

të gjithë e dimë, atje gjendja është shumë e nderë, atje shkelet Kushtetuta, atje shkelen edhe konventat ndërkombëtare me të cilat garantohet prona, prandaj kërkojmë që sot urgjentisht të futet në rend dite kjo çështje, sepse vërtet situata është në eskalim.

Ky Kuvend dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka edhe propozime konkrete për të dalë nga kjo situatë shumë e rëndë. Ju lutem, që të keni parasysh këtë dhe të futet në rend dite kjo pikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Një çështje, për të cilën unë desha tani të diskutojmë, është Raporti vjetor i Radio-Televizionit të Kosovës. Ne po shkojmë në muajin e 11-të të këtij viti dhe akoma ky raport nuk ka arritur në këtë Kuvend.

Raporti, në realitet, ka ardhur në maj dhe Komisioni ynë funksional e ka shqyrtuar anën narrative të këtij raporti dhe i ka rekomanduar Kuvendit që, pasi ta shqyrtojë edhe Komisioni për Buxhet e Financa, ta procedojë pastaj në seancë plenare.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin më 11 korrik 2008 dhe i ka rekomanduar Kuvendit që me shkrim t'i drejtohet Auditorit Gjeneral të Kosovës për ta bërë auditimin e rregullativës financiare, duke përfshirë edhe kontrollimin e evidencave financiare të RTK-ës.

Raporti i RTK-së është tërhequr nga Seanca plenare më 19 shtator 2008, me arsyetim se ende nuk ka arritur Raporti i Auditorit Gjeneral për Raportin financiar të RTK-së.

Ndërkohë, në media, ka një muaj e ca që është publikuar informata, për çka nga mediat kam marrë vesh, e besoj se edhe kolegët, se Auditori Gjeneral i Jashtëm e ka kryer punën e vet dhe nuk ka gjetur asnjë shkelje serioze financiare në RTK.

Ajo që unë ngreh këtu si çështje - është paradoksi që ky raport akoma nuk ka arritur në Kuvend dhe unë dua që sot, në këtë seancë plenare, që jemi në muajin e 11-të, dhe po e përsëris edhe një herë – të di dhe t'më shpjegohet se ku ndodhet ky raport dhe pse nuk ka ardhur? Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Unë do t'i dëgjoj të gjithë deputetët që janë lajmëruar për fjalë dhe përgjigjet do t'i marrin një pas një, në fund. Për fjalë është paraqitur deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë me vete kam sjellë dy kushtetuta të Republikës së Kosovës, njërën për Presidentin e Kosovës që e udhëzoj ta lexojë nenin 88, që kjo Kushtetutë nuk lejon bartjen e dy posteve. Prandaj, zotit Manaj, ia jep njërën.... Dhe, tjetrën e kam sjellë për Kryeministrin e Republikës së Kosovës dhe e uroj që ta lexojë nenin 125, 126, 127, 128 dhe deri në nenin 129, që i takon sigurisë së vendit dhe prapë edhe këtë Kushtetutë ia jap zotit Manaj, se ky mund t'i kryej dy funksione!

Faleminderit! Kjo ishte ajo që desha ta bëj dhe ju falënderoj shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Kjo nuk ishte në rend dite, po mirë! Për fjalë është lajmëruar kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit! Faleminderit, zoti Kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, unë kërkoj mocion për pikën 17 të rendit të punës për sot, në mënyrë që emërimi i Bordit të Trustit të realizohet sipas kërkesës dhe arsyes që e kemi bërë edhe në mbledhjen e kaluar.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar edhe sot, në mëngjes dhe, në koordinim edhe me zëvendëskryeministrin e Kosovës, që vjen nga radha e LDK-së dhe zotin Kuçi nga radha e PDK-së dhe kemi arritur deri te qëndrimi që nuk është bërë asnjë lëvizje nga seanca e kaluar deri tash për çështjen që LDK e ka kërkuar.

Unë jam i vetëdijshëm se emërimi i Bordit shkakton probleme, shkakton probleme në kuptimin e masave dhe të vendimeve që duhet t'i marrë sipas ligjit.

Po i përmend dy arsyt kryesore që ne i kemi dhënë në mbledhjen e kaluar:

Nën një, është se nuk është i përfaqësuar, apo nuk janë të përfaqësuar punëtorët e Kosovës në këtë Bord sipas Ligjit në fuqi, dhe

Nën dy, i kemi tre përfaqësues ndërkombëtarë të emëruar në këtë Bord apo 50% e Bordit është në përbërje të të emëruarve që vijnë nga faktori ndërkombëtar.

Po ashtu, mendoj se është e tepërt të flitet për arsyt që ky Bord duhet të jetë i kosovarizuar dhe sipas Ligjit, mendoj, duhet ta ushtrojë sa më shpejt detyrën që e ka.

Unë lus për mirëkuptim, zoti Kryetar, në mënyrë që Qeveria ta gjejë rrugën më të shkurtër të mundshme që kjo çështje të tejkalohet. Në të kundërtën, Grupi Parlamentar i LDK-së, nuk mund ta mbështesë në asnjë formë mënyrën e tillë të emërimit të një organi shumë të lartë, që është në interes të Fondit Pensional dhe të investimeve që, sipas një vendimi të Bordit të vjetër, i ka bërë në institucione financiare paratë tona...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Përgjigjen do ta merrni pak më vonë. Për fjalë është lajmëruar deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Unë do të thosha që në frymën e parafolësit tim të vazhdoj. Do të doja që Parlamenti të kërkojë zyrtarisht nga Trusti që t'i informojë kontribuuesit në mënyrë të rregullt me atë se çfarë po ndodhë atje, sepse përshtypja është se Trusti po e fsheh dhe po e vonon informatën, sidomos shumë e humbjeve, e cila nuk është 49 milionë, siç thotë Trusti, por është rreth 70 milionë euro, duke i marrë parasysh edhe këto vibracionet e fundit që i patën bursat kryesore.

Po ashtu, zoti Kryetar, për shkak se Parlamenti ka filluar të akuzohet për gjendjen në Trust, unë kërkoj që të insistohet te Radio-Televizioni i Kosovës që ajo, gjithsesi, ta

transmetojë seancën parlamentare të fundit, mendoj të së premtes, të 17 tetorit, të cilën për arsye të pakuptueshme RTK nuk e transmetoi për publikun e gjerë, në të cilën seancë, siç e dimë, u debatuan shumë gjëra, për të cilat, Parlamenti, sikur që e ceka, tashti akuzohet dhe të cilat edhe më tutje janë shumë aktuale dhe të rëndësishme për kontribuuesit. Të kërkohet decidivisht nga Televizioni publik që ajo seancë të transmetohet në orët sociale, pra atëherë kur mund të përcillet nga opinioni i gjerë.

Gjithashtu, zoti Kryetar, unë kërkoj nga Parlamenti që ta fusë në rend të ditës në seancën e radhës Marrëveshjen e Bordit të PTK-së me Kompaninë virtuale Dardafon ngase ajo marrëveshje është arritur në rrethana të dyshimta dhe jotransparente. Sipas ekspertëve, kjo marrëveshje do t'ia ulë vlerën 70% PTK-së dhe dyshohet se kjo është bërë me qëllim në prag të privatizimit për interesa të caktuara të individëve dhe të grupeve të caktuara. Sa për t'ia rikujtuar ministrit shumë të përfolur, zotit Ahmet Shala, kjo nismë është në kundërshtim me Ligjin në fuqi mbi ndërmarrjet publike. Pra, për hir të opinionit të thuhet se vlera e PTK-së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është lajmëruar deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Mendoj se para këtij Kuvendi dhe qytetarëve të Kosovës është dashur të dilet me një sqarim çka po ndodhë në Kaçanik. Është rrethuar dhe është bastisur ndërtesa e komunës atje. Një kryetar komune është në arrati. Ministri i Punëve të Brendshme është dashur të dalë me sqarim para Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës, Kryeministri ose ministri i Pushtetit Lokal.

Unë para veti e kam transkriptin e seancës së mbajtur më 21 dhjetor 2006, faqe 3, fjala e ish-kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së, atëherë, për një ngjarje që pati ndodhur. Nuk akuzoj këtu, por këtë faqe 3 të atij transkripti merreni për veti, sepse mendoj se është dashur të sqarohet dhe jo ne dhe qytetarët e Kosovës të njoftohemi përmes mediave. Çka ka ndodhur, çka po ndodhë dhe pse po ndodhë kështu? Faleminderit!

KRYETARI: Qytetarët e Kosovës do të njoftohen për shumëçka edhe për të kaluarën, edhe në të ardhmen, por ne jemi duke folur për rend dite dhe ju lutem ta respektoni rendin e ditës. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi!

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për të gjithë kolegët dhe ministrat!

Edhe pse në rendin e ditës i kemi 19 pika, unë mendoj apo ndaj mendimin po ashtu që i takon në mandatin e këtij Parlamenti që edhe në këtë foltore, edhe në seancat e radhës që vijnë, vërtet të vendoset një agjendë, e cila është në interes qoftë për temat që trajtojnë çështje politike, të funksionimit të Qeverisë, të sovranitetit të vendit apo edhe tema të tjera, që u prekën këtu, sepse me kalimin e kohës dhe me vonesat e mëdha që po ndodhin, mendoj se nuk po e luajmë rolin si parlamentarë dhe si Kuvend i Kosovës, për çfarë jeni në dijeni edhe ju, zoti Kryetar, dhe unë, bashkë me ju, si deputet.

Dua të vazhdoj ose të plotësoj atë që e tha shefi i Grupit Parlamentar lidhur me çështjen e Trustit të Pensioneve dhe të reagoj po ashtu nga Parlamenti që iu dha hapësirë dikujt nga

Trusti ta akuzojë LDK-në se po e vonon një proces dhe po shkaktohet një problem apo një humbje e madhe. Nuk ka kuptim ajo, prandaj e parapëlqej atë që e tha deputeti më herët që seanca të transmetohet. Përgjegjësia është e atij bordi, por unë po ashtu kërkoj nga Qeveria, jo këtë informatë që është shumë e thatë dhe s'thotë asgjë, por një informatë të plotë për atë çka ka ndodhur me vite atje dhe një vendim që për 2 muaj, 3 muaj që ad-hoc duhet ta marrë Qeveria për të shpëtuar atë që mund të shpëtohet deri në zgjedhjen e bordit të ri.

Prandaj, jo veç kësaj, por edhe temat që kanë karakterin e ekonomisë nacionale, ndryshimi e strategjive dhe iniciativat duhet të vijnë në këtë Parlament e jo pastaj të konfrontohemi dhe të na dalin probleme. Ju lutem, zoti Kryetar, bashkë me Qeverinë t'i vendosim temat në rendin e ditës në kohën ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Ju lutem, përqendrohuni në rend dite, sepse shumë deputetë nuk po i përmbahen rendit të ditës. Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Respekt, zoti Kryetar!

Qeveritarë dhe deputetë të nderuar,

Unë angazhohem që pikat e rendit të ditës të reduktohen maksimalisht 6 deri në 8, sepse po bie efekti dhe pastaj edhe po formalizohen çështjet. Të mbajmë dy seanca, fundi i fundit.

Dhe, ju lutem, sa i përket Trustit të Pensioneve, unë angazhohem që Kuvendi i Republikës së Kosovës t'ia dedikojë së paku një pikë të rendit të ditës, edhe ekzekutivi të sigurojë, sepse ka instrumente, ka mekanizma – sistemin e pagave. Ju lutem, nuk mund të pranohet kurrësi dhe nuk mund të justifikohet që një menaxher atje apo bordist ta ketë pagën 3 herë a 4 herë më të madhe se Kryetari i Kuvendit apo i Republikës së Kosovës dhe atë nga paraja...

KRYETARI: Ju lutem deputet, përmbajuni rendit të ditës!

RIZA SMAKA: Ju lutem, pikërisht jam në rend dite!

KRYETARI: Jo, nuk je!

RIZA SMAKA: Dhe, lidhur me këtë e në kontekst me këtë, pyetjes kuvendore i ka dalë boja, sepse në këtë drejtim janë adresuar disa pyetje dhe nuk janë dhënë përgjigje ose janë dhënë ad-hoc, me duar në xhepa, kështu që, ju lutem, këto janë çështje tepër serioze dhe nuk mund të tolerohen. Në Trustin e Pensioneve përveç tjerash, që është për mua antitrust, pa fije të dyshimit ka baza të sigurt të abuzimeve, të uzurpimeve të mjeteve financiare dhe manipulime spekulative me kuazi dhe pseudo-informata të adresuara opinionit. Ne nuk mund të tolerojmë, populli nuk toleron asisoj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përsëri më duhet t'ju them, ju lutem përmbajuni rendit të ditës. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk është herë e parë që ky Parlament vihet në sprovë me letra abstrakte. E kam tani fjalën për letrën që është dërguar nga Trusti Pensional i Kosovës dhe të vihet kjo pikë e

rendit të ditës, shumë e rëndësishme, që është temë dite dhe çdo parlament normal i secilit shtet normal do ta diskutonte si pikë të veçantë, në një seance të veçantë. Të vihet në pikën e 17-të të rendit të ditës, unë e di që po tentoni të instaloni diktaturë edhe në media, edhe censurë... I kuptoj hallet e kësaj Qeverie. Vërtet, keni halle serioze! I di problemet në mes dy partnerëve të koalicionit, por të vihet kjo...

KRYETARI: Naser, të lutem, me gjithë respektin, por ne nuk jemi Qeveri, jemi Parlament...

NASER RUGOVA: Kryetar, të lutem! Ne jemi duke e formuluar rendin e ditës dhe po bisedojmë për rend dite. Pse gjithë këto shqetësime? Andaj, të vihet kjo çështje kaq e rëndësishme si pika e 17-të, kujtoj se është jo serioze, por njerëzit po njoftohen, qytetarët po njoftohen dhe po e dinë mirë se si po shkon puna këtu.

Edhe një gjë. Ky Parlament duhet në një nga seancat e radhës, sepse po ikin temat si aktualitete të çështjeve të rëndësishme, të thotë diçka për Raportin e progresit vjetor të Komisionit Evropian. Sepse, si janë duke u shkelur ligjet dhe si po na burgosen kryetarët e komunave në çdo tre muaj, kujtoj se ky Parlament duhet seriozisht të diskutojë për këto çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ne nuk mund të përzihemi në sundimin e ligjit, prandaj ne kërkojmë zbatimin e ligjit. A janë kryetarë qeverie a kryetarë komune, është diçka tjetër. Ju lutem, përsëri, përmbajuni rendit të ditës. Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti Kryetar! Keni parasysh të drejtën e deputetit për të qitur në rend dite ndonjë pikë. Është e drejtë elementare që deputeti ta thotë fjalën e vet për t'u plotësuar rendi i ditës dhe askush s'mund atë t'ia ndalë. Të gjitha këto që u cekën deri tani nga deputetët, ishin propozime për rend të ditës dhe duhet respektuar. Në të njëjtën kohë, në pikën 17 të rendit të ditës, keni ofruar rekomandimin për Komisionin për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës.

Nëse flasim shqip dhe marrim vesh shqip, qysh në seancën e kaluar është kërkuar raport nga Trusti Pensional edhe mbi punën që ka bërë deri më tani, edhe për humbjet dhe pasojat që janë shkaktuar në këtë fond, që janë para të qytetarëve të Kosovës. Prandaj, nuk mund të kalojë asnjë bord pa pasur një raport të plotë mbi atë çka po ndodhë me Fondin Pensional të Kosovës. Prandaj, keni parasysh këtë sepse ka të bëjë me një trust pensional i cili sot ka humbje dhe ju doni ta anashkaloni këtë pikë duke mos diskutuar për këtë deputetët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe pse s'është e vërtetë ajo që po e thua! Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit që po e demokratizon kaq shumë pjesën hyrëse të seancës! Faleminderit prej të gjithëve që ngritën çështje të cilat e kanë vendin për t'u diskutuar në Parlament, por ka një procedurë që më duhet t'ju përkujtoj dhe asnjëri nga grupet parlamentare dhe nga deputetët nuk e ka bërë asnjë kërkesë drejtuar Kryesisë së Kuvendit për ta shtruar në rend dite lidhur me këto çështje që u diskutuan. Prandaj, ju kisha lutur që çështjet që janë të futura me procedurë të shpejtë, dihet cila është procedura – të mblidhen nënshkrimet dhe askush s'mund t'i refuzojë ato. Pra, për çështjet të cilat duhet të vijin në radhë dhe duhet

të debatohen e të diskutohen, të bëhen kërkesat siç e përcakton Rregullorja e Kuvendit dhe të futemi në punë normale. Përndryshe, krejtësisht, edhe kjo është normale, sepse kur po vjen puna për t'i futur çështjet në debat, një pjesë po i tërheqin nënshkrimet dhe po mbetet pa hyrë në rend dite.

Tani, a po diskutojmë për opinion sot, apo po kërkojmë ta fusim një çështje të cilën, në mënyrë elegante, secili nga ju, me grupin tuaj parlamentar, ka mund ta bëjë kërkesën në Sekretari dhe sot do të ishte futur në rend dite. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rregulla 23, pika 2: “Në fillim të seancës plenare, propozimi i rendit të ditës do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një a më shumë grupe parlamentare apo 6 anëtarë të Kuvendit i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament për rendin e ditës, i cili hidhet në votim.”.

Përveç kërkesës së shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, të gjitha kërkesat tjera, vërtet, janë treguar për opinionin, por nuk janë të mbështetura në Rregulloren të Punës së Kuvendit.

(Ndërhyrje, pa kyçje të mikrofonit)

Në Kosovë, nuk ka çështje urgjente, për të cilën duhet të bisedohet. Nën një.

Nën dy. Esat Brajshori, e ka bërë një kërkesë, që mendoj, pjesërisht ka të drejtë, por Komisioni për Buxhet e Financa nuk e ka sjellë raportin e vet. Ju e dini që kjo është shtyrë për shkak të raportit të auditimit dhe ne presim që ai raport të vijë, të vijnë rekomandimet e Komisionit dhe ajo çështje do të hyjë në rend dite.

Çështja e Gani Gecit, që doli, ishte krejt jashtë rendit të ditës, por megjithatë ne nuk e pengojm ta paraqet.

Lutfi Haziri, kishte të drejtë, por ka pasur të drejtë ta bëjë edhe me shkrim.

Ju po kërkon raport nga bordi, por Trusti nuk ka bord dhe s'mund të vijë raporti. Këtë duhet ta dini.

Prandaj, kjo është çështje e ngutshme dhe duhet ose të votohet, ose të mos votohet. Unë nuk do të paragjykoj se a do të votojë Kuvendi, ju lutem!

(Ndërhyrje, pa kyçje mikrofonit)

Ju lutem, e keni marrë fjalën dhe s'dua të dëgjoj më, sepse e keni tepruar.

Driton Tali është një deputet dhe i ka shtruar 4 çështje.

(Ndërhyrje, nuk dëgjohej për transkriptim)

Ju lutem, dihet si duhet shtruar kërkesat. Prandaj, nuk kam faj që je deputet i vetëm, prandaj respektoje mundësinë dhe fuqinë që e ke!

(Ndërhyrje, nuk dëgjohej për transkriptim)

Jo, nuk e ke hiq atë të drejtë!

Naim Maloku, thjeshtë, edhe ai e pati për opinion, por nuk është çështje për t'u shtruar në rend dite, sepse dihet procedura për disa çështje si shtrohen në rend të ditës.

(Ndërhyrje, nuk dëgjohet për transkriptim)

Unë, s'dua të përgjigjem në asnjë pyetje tuajën më, por dua t'i përgjigjem kërkesës së Lutfi Hazirit, për të cilën kam obligim.

(Ndërhyrje)

Ju lutem, unë e kam fjalën, e kur ta kryej unë, e merrni ju. Shikoni! Çështja e Bordit të Trustit! Lidhur me këtë çështje është shqyrtuar nga një komision i veçantë një konkurs në mars të vitit 2008. Janë propozuar 6 kandidatë, 3 janë vendorë, 3 ndërkombëtarë. Ju duhet ta dini dhe është mirë ta lexoni Ligjin. Do të thotë, në bazë të Ligjit, konkursi ka qenë ndërkombëtar dhe sipas kërkesave ligjore, as 3 kandidatët që janë shqiptarë, nuk i kanë plotësuar kushtet. Kjo është përbërja. Trusti është pa bord. Ju po kërkon një raport. Trusti nuk mund të sjellë raport në Kuvend pa bord dhe kot e kërkon raportin.

Unë nuk jam për ta shtyrë këtë pikë të rendit të ditës. Ju lutem! Nuk kemi nevojë ta shtyjme këtë çështje. Ne ose duhet ta zgjedhim ose mos ta zgjedhim bordin, e pastaj të fillojnë procedurat. Mirëpo, nuk është mirë ta shtyjme kështu, siç po e shtyjme pa asnjë kërkesë të saktë.

Realisht, unë e vë në votim kërkesën e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, sepse e kam për obligim, por ta dini se më mirë është të votojmë "për" ose "kundër" se sa ta shtyjme kështu dhe ta lëmë Trustin pa bord.

Fjalën e kërkon Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Për hir të korrektësisë së Kuvendit dhe të korrektësisë tuaj, lidhur me kërkesën e zotit Brajshori për Raportin e Radio-televizionit të Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka pasur çka të shqyrtojë, prandaj mos bëni adresime te Komisioni për Buxhet dhe Financa. Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ta keni parasysh dhe ky Komision nuk ka pasur asnjë material tjetër zyrtarisht ta shqyrtojë dhe të procedohet në Kuvend.

Kërkesa ka qenë që revizioni gjeneral, pas raportit të tij, të shtrohet në Kuvend. Raportimi është kryer, por zyrtarisht nuk është sjell në Kuvend. Është kërkuar atë ditë, kur është shtyrë kjo pikë e rendit të ditës, kush e ka kërkuar dhe pse është kërkuar, e dini shumë mirë. Është dashur t'ia bëni një shkresë Zyrës së Revizorit gjeneral që ai raport zyrtarisht t'i drejtohet Kuvendit.

Prandaj, ju si Kryesi dhe si Administratë, nuk e keni kryer këtë veprim dhe nuk është mirë... Jo, jo, po them nuk e keni kryer dhe nuk është mirë që të adresohen gjërat te Komisioni i Kuvendit.

Çështja e dytë që dua ta them, është rreth pikës 17. Po më duket, edhe herën e parë, kur kemi diskutuar, edhe tash, janë të ngatërruara gjërat. Kemi pasur dy çështje – ose dy pika të veçanta që kanë të bëjnë me Trustin Pensional – një: zgjedhja e bordit dhe çështja e dytë ka qenë rreth tarifës menaxhuese, të zbritjes së tarifës menaxhuese të këtij bordi. Pra, diskutimet më të mëdha kanë qenë për tarifën menaxhuese, sepse nuk mund të miratohet diçka e tillë pa e pasur një raport të Trustit Pensional. Raporti i Trustit nuk mund të ijë. Ne kemi një material, të cilin të hënën do ta shqyrtojë Komisioni rreth tarifës menaxhuese, por jo edhe rreth përzgjedhjes së Bordit të Trustit Pensional.

Ju lus, merrni Rregulloren...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Ju lutem, u krye fjala, nuk i ke dhjetë minuta këtu. Të lutem, ulu tash! Koha është e përcaktuar dhe ju lus, të uleni!

(Ndërhyrje)

Për çështjen e parë, kërkoj falje, që e kam cekur Komisionin tuaj. Për çështjen tjetër, administrata e ka kryer shumë mirë çështjen e vet dhe jo një, por dy kërkesa i ka.

(Ndërhyrje)

Unë dua të them, në rend të parë, do të duhej të bëhesh më i edukuar, të dëgjosh mirë e pastaj të përgjigjesh. Këtu, dikush e jep fjalën dhe dikush e merr fjalën! Nuk mund të bëjmë pazar! Unë thashë, për çështjen e parë të kërkoj falje. Administrata e Kuvendit e ka kryer punën e vet, kurse ata pse s’e kanë sjellë raportin, është çështje tjetër. Le të vendos komisioni përkatës, e ne procedojmë në mbledhjen e ardhshme. Prandaj, nuk kemi çka të zgjasim këtu dhe askush s’është kundër. Unë nuk e kam shty çështjen e RTK-së dhe as që e kam ndërmend, as ta shtyj, as të ndërhyj, as në media, as publike, as ato private.

Prandaj, ju lus, edhe njëherë po kërkoj nga Qeveria, nëse dikush nga ta dëshiron ta sqarojë çështjen e Trustit, le të urdhërojë. Por, po ju them, kot pritni raport nga Trusti derisa trusti nuk ka bord. Këtë mendoj duhet ta keni parasysh.

(Ndërhyrje – propozime)

Pse pauzë! Jo, jo nuk ka nevojë për pauzë. As nuk ka nevojë për sqarim. Tani e kemi mocionin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, për të cilin unë nuk pajtohem. Megjithatë, Kuvendi vendos. Këtë e vëmë në votim.

Kush është “për”? Urdhëroni, Kryeministër, për sqarim! E ka fjalën Kryeministri Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!

Anëtarë të kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Qeveria ka proceduar në mënyrë krejt të rregullt çështjen e bordit të Trustit. Historia e Trustit është një histori jo bash e pëlqyeshme për të gjithë ne e që ndërlidhet shumë me të kaluarën dhe nuk është ndërlidhur me ditët e fundit. Qeveria ka proceduar në mënyrë të rregullt, por shoh se ka hezitime të ndryshme, ka paqartësi të ndryshme që kërkojnë

qartësi. Jam në favor të asaj që këto qartësi të cilat u kërkuar nga deputetët të jepen dhe pastaj të vazhdohet me procedurë të rregullt. Qeveria i ka kryer obligimet e veta dhe tash jemi të gatshëm t'i japim ato qartësi të nevojshme dhe të domosdoshme nëse ju e shihni të arsyeshme për seancën e radhës apo në pikën e rregullt që është propozuar, prandaj për këtë vendosni ju si deputetë, por mendoj se do të ishte mirëkuptuese për çështjet e ngritura të jepen sqarime plotësuese.

(Ndërprerje e shkurtër)

KRYETARI: Faleminderit! Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Kolegë të nderuar deputetë,
Sa i përket kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të cilën e shtroi sot Lutfi Haziri, s'ka kurrëgjë të re. Kjo është situatë e seancës tjetër. Atëherë është shtyrë kjo pikë e rendit të ditës, duke menduar se do të reflektojnë edhe Qeveria edhe Kuvendi dhe të gjithë njerëzit që implikohen rreth këtij Trusti dhe udhëheqjes së vet, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje. Pra, deri më sot, s'kemi asnjë fije sqarimi, as rreth përbërjes, as rreth asaj që do të bëjmë sot.

Unë mendoj se nuk është kurrfarë humbjeje kohe që kjo pikë, që shihet nuk do të ketë zhvillim dhe rezultat normal, sepse janë përzier vërejtjet në përbërjen e atij bordi të propozuar, struktura e tij, puna dhe gjendja e Trustit, Trusti, me prononcimet publike që janë shumë joracionale, gabimet që i ka bërë në histori të vet përpiqet t'i mbulojë me procedura të Parlamentit, domethënë s'kanë të drejtë hiq, ndërsa Parlamenti nuk mund të marrë ad-hoc një vendim që s'i pëlqen për hatër se Trusti thotë – “ne nuk po mund të veprojmë mirë për shkak se ata po na ndalin”.

Pra, kur jemi këtu, unë e dëgjova edhe Kryeministrin çka tha. Pra, unë mendoj se nuk është kurrfarë humbjeje kohe që kjo pikë të mos trajtohet hiq në këtë seancë dhe të mendohet kjo për seancën e ardhshme. Sepse, edhe nëse vijmë në fund, unë sa shoh, nesër nuk do të zgjidhim kurrëgjë. Për një seancë nuk humbet as nuk fitohet asgjë dhe unë mendoj se është mirë të shqyrtohet në seancë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë dëshiroj që të shpreh qëndrimin tim si Kryeministër i Qeverisë që e udhëheq. Qeveria aktuale është edhe më kritike sesa zhurmat e mëdha që mund të bëhen prej rreshtit të fundit për Trustin Pensional.

(Reagime)

Tash, unë kërkoj... Kërkoj që kjo çështje të futet, nëse ka mirëkuptim, në përkrahjen për votim, natyrisht me kërkesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ne do të votojmë në favor, natyrisht, të çështjes së ngritur por do të ishte me rëndësi që të futet si pikë e veçantë e rendit të ditës e të mos jetë diku atje krejt në fund.

(Ndërhyrje – reagime)

KRYEMINISTRI: Zoti Kryetar, unë dëshiroj që të vihet në votim dhe pastaj vetë Parlamenti të vendosë.

KRYETARI: Fjalën e ka Ethem Çeku, me siguri shkurt, a!

ETHEM ÇEKU: Shumë shkurt! I respektuari Kryeministër, nuk jemi rreshti i fundit. Po ju shpjegojmë edhe njëherë. Ju respektojmë si Kryeministër, prandaj keni një konsideratë në komunikim me deputetët. Ju faleminderit shumë për opinionin që dhatë.

Ne e mbështesim propozimin e Kryetarit të Parlamentit, sepse e dimë që jemi duke humbur si Trust. Jemi duke pasur kriza të mëdha, prandaj ne kërkojmë që sot të jetë në rend dite dhe të procedohet për këtë me procedurë të rregullt. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem! Urdhëroni, Kryeministër!

KRYEMINISTRI: Vërejtjet, sugjerimet, kritikën dhe për gjithçka të keqe që keni ndaj atij bordi të Trustit janë ato që janë, por ai Trust është zgjedh në kohën e qeverisë tuaj, prandaj unë i kam opinionet e mia që duhet t'i shpreh në mbledhjen e ardhshme ose në momentet kur hapet ky debat.

KRYETARI: Jo, ju lutem, unë kërkoj prononcimin e shefave të grupeve tjera parlamentare për propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike. Në emër të Partisë Demokratike, kush po e merr fjalën? Safete Hadergjonaj!

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar! Në emër të Grupit Parlamentar, ne mendojmë se kjo pikë e rendit të ditës duhet të mbetet si pikë e rendit të ditës, të debatohet dhe të diskutohet për këtë çështje. Mua me vjen keq sot që debatohet në lidhje me këtë çështje. Të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe shefat e grupeve parlamentare kanë qenë në mbledhjen e Kryesisë dhe aty është dashur që mos të lejojnë të futet si pikë e rendit të ditës.

Ne mendojmë se kjo çështje nuk duhet të mbetet peng dhe të mos zgjidhet, kurse mundësia është që të votohet “për” dhe të votohet “kundër”, kështu që, duke votuar “për” ose “kundër”, ne e zgjedhim këtë problem. Nëse votohet “për” vazhdohet, nëse votohet “kundër”, atëherë mbetet që me procedurë të shpejtuar të bëhet zgjedhja e një bordi tjetër, të respektohen procedurat ligjore dhe të bëhet zgjedhja e bordit duke e parë rëndësinë që ka ky bord i Trustit Pensional të Kursimeve.

KRYETARI: Urdhëro!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Kjo është një çështje shumë e ndjeshme që tejkalon kornizat partiake, të interesave të ngushta partiake, është interes shtetëror që kërkon veprim unik të gjithë spektrit politik kosovar dhe institucional shtetëror të Republikës së Kosovës.

Dëshiroj që të ketë një orientim unifikues të spektrit politik për këtë çështje tepër të ndjeshme dhe të përgjegjshme shtetërore. Në kuadër të kësaj, e ritheksoj, pas debatit që u dëgjua prej deputetëve, kërkesa për sqarime plotësuese, mendoj se këto sqarime kërkojnë një hapësirë të shkurtër kohore të plotësohen, pasi që këto sqarime u kërkuan edhe nga Qeveria. Prandaj, ky është qëndrimi, mendoj, tash mund t'ju drejtohem edhe si

Kryeministër, por në të njëjtën kohë edhe si deputet dhe kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Vazhdojmë, fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
I nderuar Kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë,

Zoti Kryetar, edhe në mbështetje të Rregullës 23 të Kuvendit, jeni i obliguar që të ta hidhni në votim një kërkesë të shefit të grupit parlamentar, andaj nuk di pse do të duhej të deklaroheshim ne shefat e grupeve parlamentare dhe, natyrisht, pasi që po kërkonim deklarinimin tonë, Grupi Parlamentar i AKR-së është kundër heqjes nga rendi i ditës të kësaj pike. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Mendoj se nëse ndonjë ditë Kuvendi i Kosovës kishte për të diskutuar për krizën globale, Kryeministri kishte për të thënë se ish Qeveria e Kosovës i ka fajet. Nuk e di deri kur më kanë për të vazhduar të thonë -ish Qeveria. E di Kryeministri se vetë ka qenë në pushtet kur është krijuar Bordi, sa për t'ia përkujtuar.

Sa për çështjen e komunikimit me deputetë, ka qenë dashur të rregullohet me partnerët e vet të koalicionit dhe të mos vijnë këtu prapë të mendojnë se rreshti i fundit, qysh po e quan ky në mënyrë shumë të keqe të komunikimit, i ka fajet pse që një vit nuk po mundet ta kryej një punë që është dashur ta kryej vetë edhe para një viti. Edhe ne mendojmë se kjo pikë duhet të mbetet në rend të ditës, atëherë do të shohim se cilat do të jenë diskutimet, cilat do të jenë debatet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Po më gëzon fakti që, më në fund, po merremi me politikën nacionale të Kosovës. Trusti është çështje vërtet nacionale, nuk është as në nivel të një qeverie, as në nivel të një politike, por të qytetarëve të Kosovës. Respektojmë të gjitha ato propozime racionale, por zoti Haziri nuk ka mundur të na bindë me arsyeshmërinë, sepse arsyeshmëria e tij ishte aq e varfër në kuptimin pse duhet të shtyhet ose pse të mos shtyhet. Vetë fakti i ndarjes së dy çështjeve, mua po më duket që këtu është problemi edhe i grupeve parlamentare, nuk janë të harmonizuara, apo të partive, vet fakti i Trustit, janë dy çështje.

Ju e bëtë arsyetimin që duam ta shtyjme këtë rend dite sepse nuk na ka ardhur nga Komisioni. Komisioni nuk është marrë me Bordin, komisioni është marrë me tarifatat. Ju lutem, atë çka e tha Gani Koci, kishte mjaft të drejtë, andaj janë dy çështje të Trustit: njëra është përzgjedhja e Bordit, e ana tjetër për çka është shtyrë ajo çështje, kanë qenë tarifatat. Unë jam për politikë racionale, jam për interes nacional. Në qoftë se vërtet është çështje e interesit të përgjithshëm që të shqyrtohet në mënyrë globale në një rrethanë të caktuar, jam "për", por nuk keni mundur ende të na bindni, as Kryeministri që po thirret në emër të politikës nacionale nuk po mund të na bind a duhet të shtyhet apo nuk duhet

të shtyhet. Ne si Lidhje Demokratike e Dardanisë iu bindemi veç arsyeve racionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ajo që ishte me Ganiun, nuk ka pasur këtë lëndë, ka qenë një lëndë tjetër. Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik.

SADIK IDRIZ: Parlamentarna grupa „7+“ će podržati zahtev grupe LDK i smatramo da, ako se ovo pitanje odloži za jednu narednu sednicu, neće se mnogo izgubiti zato što je već puno izgubjeno u periodu koji je iza nas i za ovo kratko vreme neće biti... Ako je ovo nacionalno pitanje i od nacionalnog interesa, mi ukazujemo i na mnoga druga pitanja koja su od nacionalnog interesa i koja ne dolaze na dnevni red kada treba.

KRYETARI: Ne tash e kemi mocionin. E kemi prononcimin e shefave të grupeve parlamentare. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash. Është pra kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike për ta shtyrë pikën 17 të rendit të ditës. Ju u prononcuat, tash e kryem prononcimin dhe, kush është për ta hequr nga rendi i ditës dhe kush është për ta lënë në rend dite. Do të thotë, kërkesa është për ta shtyrë.

Kush është për ta shtyrë nga rendi i ditës kërkesën e Lutfi Hazirit?

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Në sallë kemi 101 deputetë, 47 deputetë janë për ta hequr nga rendi i ditës, 39 janë “kundër”, 3 kanë abstenuar. Pra, pika 17 e rendit të ditës hiqet nga rendi i ditës. Faktikisht, hiqet nga rendi i ditës për sot.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 17 tetor 2008

Ju njoftoj se procesverbalet e dy seancave plenare të mbajtura më 17 nëntor 2008 si dhe transkriptet nga këto seanca iu janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, nëse kanë vërejtje ne procesverbal? Fjalën e ka kërkuar Gjylnaze Syla, por për rendin e ditës, për pikën e parë të rendit të ditës.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!

Kanë kaluar njëzet ditë dhe unë ende nuk kam marrë përgjigje nga Kryeministri lidhur me pyetjen për integrimin e serbëve të veriut. Për më tepër, Kryeministri në seancën e 17 tetorit, ka mashtruar qëllimisht Kuvendin kur ka thënë se kam letrën e kryetarit të partisë tuaj që ka kërkuar të ndajë...

KRYETARI: Lus regjinë që t’ia ndërpresë fjalën deputetes!

Ju lutem, a ka vërejtje në procesverbale? Adem Hajdari e ka kërkuar fjalën.

ADEM HAJDARAJ: Zotëri Kryetar,

Kabinet qeveritar dhe kolegë të nderuar,

Unë për pikën e parë pata t’i them vetëm dy-tri fjalë për këtë transkriptin. Ju e dini fare mirë se unë, pasi që e ka shtruar çështjen ky zotëriu Ramë Buja përkitazi me sistemin komunist dhe të metat, që e kemi atë deklaratën, unë e pata marrë fjalën menjëherë dhe reagova. Kërkova sqarime se a është fjala vetëm për komunizmin në Kosovë, apo është

fjala për komunizmin edhe në Shqipëri edhe gjetiu, edhe pse i kam lexuar më parë edhe atë të Shqipërisë, edhe të Kroacisë, edhe të vendeve të tjera evropiane që kanë reaguar. Këtu menjëherë zotëri Ramë Buja i dha sqarimet, këtu nuk ka dalë në transkript reagimi im. Pse, kush i revidon këto dhe çka bën? Kaq!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Vërejtjet ia përcjellim administratës, por ju e dini që ne e votojmë procesverbalin e jo transkriptin. A ka dikush tjetër vërejtje në procesverbal? Urdhëro, zoti Riza Smaka! Unë po kërkoj vërejtjet në Procesverbal, jo në Transkript.

RIZA SMAKA: Zotëri Kryetar, unë natyrisht i referohem procesverbalit, por meqenëse aty nuk janë shënuar, janë në transkript, i kam 4 vërejtje për t'u përmirësuar gabimet, nëse më lejohet.

KRYETARI: Ju faleminderit!

A ka dikush tjetër? Jo! Konstatohet se miratohet Procesverbali i seancës së mbajtur me 17 tetor 2008.

Kalojmë në pikën e dytë:

2. Pyetje parlamentare

Para se të fillojmë me procedimin e kësaj pike, ju njoftoj se për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara, e me qëllim të ruajtjes së aktualitetit të tyre, Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur me 28 tetor 2008, ka vendosur që Kuvendit t'i propozojë shmangie nga Rregulla 26, pika 1, duke zgjatur kohën për pyetjet parlamentare në 60 minuta, si dhe duke proceduar me nga një pyetje të deputetit që ka shtruar më shumë pyetje. Kjo vlen edhe për seancën e sotme dhe vendimin e saj në ditën e nesërme. Do të thotë, për pyetje parlamentare i kemi dy orë, një orë e kemi sot, dhe një orë e kemi në seancën që do të vazhdojë nesër.

A jeni dakord?

Kush është "për"? Ju faleminderit!

A ka "kundër"? Abstenim? Në sallë i kemi 65 deputetë, do të thotë kemi kuorumin, vazhdojmë me pyetjet.

KRYETARI: Po kalojmë në një pyetje, jo aq me rend, pasi që ministri ka kërkuar t'i bëhet një pyetje, sigurisht ka ndonjë angazhim. Deputetja Sanije Alijaj, pyetje për ministrin e Pushtetit Lokal, zotëri Sadri Feratin.

Urdhëroni deputete, mund ta bëni pyetjen!

SANIJE ALIJAJ: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në këtë seancë plenare!

Zoti ministër, Sadri Ferati,

Në Ferizaj jepen lejet nga kuvendi komunal për ndërtimin e objekteve banesore mbi 7 kate, që nuk i plotësojnë standardet për banim. Vetëm në lagjen e re, përafërsisht në një hektar janë ndërtuar 5 objekte banimi 7- katërshe, që nuk plotësojnë asnjë element të infrastrukturës. Mungojnë parkingjet, trotualet, këndet e gjelbërura etj. Çka është ma e keqja, asnjë objekt nuk ka rrethojë për të mos u rrezikuar fëmijët, sepse daljet janë drejtpërdrejt në rrugë. Këto objekte janë të ndërtuara afër një institucioni arsimor, që edhe më shumë rrisin rrezikshmërinë për sigurinë e nxënësve.

Për objektet e tilla në komunën e Ferizajt janë dhënë leje edhe në të kaluarën, edhe tani, që vërtet nuk...

KRYETARI: Ju faleminderit!
Zoti ministër!

MINISTRI SADRI FERATI: Ju faleminderit!

I nderuari Kryetar,
Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
E nderuara deputete, është diçka që dihet se në bazë të Ligjit për ndërtimin dhe të Ligjit për planifikimin hapësinor, në lidhje me ndërtimet jo të rregullta është kompetente Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Sido që të jetë, është edhe kompetencë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që të monitorojë zbatueshmërinë e ligjit, por jo në rastet individuale, siç është interesimi i juaj në këtë drejtim, edhe pse interesimi i të gjithë neve, edhe i Kabinetit Qeveritar, edhe i Parlamentit është që të kemi edhe rregullime dhe rregullsi e ndërtime çfarë i dëshirojmë. Por, në këtë rast kompetente është ekskluzivisht komuna, por për ndonjë tejkalim të kompetencave të saj, në bazë të Ligjit të ndërtimit është kompetente Ministria për Ambient dhe Planifikim Hapësinor.

KRYETARI: Mirë, ju faleminderit, ministër!
Pyetje shtesë? Po më duket se pyetja ka qenë në adresë të gabuar, por urdhëroni bëjeni pyetjen shtesë!

SANIJE ALIJAJ: Zoti Kryetar, e di që pyetja i takon ministrit për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, është kompetencë e tij, por ia kam bërë ministrit të Pushtetit Lokal, sepse ky ka kontakte të drejtpërdrejta me kryetarët e kuvendeve të komunave dhe duhet të kërkojë këtë kompetencë që ndërtimi i objekteve banesore të jetë nën kontrollin e Inspektoriatit komunal, në mënyrë që të respektohet infrastruktura e banimit. Prandaj, kërkoj nga dy ministrinë që në këtë drejtim..., sepse vështirë do të zbatohet Plani zhvillimor dhe hapësinor i Kosovës në të ardhmen. Ndërtimet pa leje kudo, vështirë se Kosova do të bëhet shtet urban!

KRYETARI: Kosova është bërë shtet, por vazhdojmë më tej.
Deputetja Synavere Rysha, pyetje për ministrin e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, zotin Ahmet Shala. Deputete, e keni fjalën!

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë pyetjen time e pata parashtruar, gati rreth dy muaj po bëhen, mirëpo nuk mora përgjigje për arsye se ministri mungonte nëpër seanca, apo edhe për arsye të tjera. Ka qenë aktuale atëherë kur është parashtruar, tash ndoshta është pak më e vonë, por megjithatë unë do ta parashtroj. Është fjala për zjarrin që është shkaktuar në AKM.

Në objektin e ish AKM-së, do me thënë tash të AKP-së. Kush e shkaktoi zjarrin, pse u shkaktua ai zjarr dhe çfarë po bën Qeveria për t'i ruajtur dokumentet, kur dihet se aty janë privatizuar një pjesë e madhe e ndërmarrjeve shoqërore dhe kur dihet se ky proces ka shkuar dhe është i përfolur mjaft gjatë, ka shkuar me mostransparencë, ka pasur parregullsi të ndryshme dhe ka dyshime të shprehura nga qytetarët, prandaj kjo është edhe pyetja ime për ministrin Shala.

KRYETARI: Ministër Shala, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Përshëndetje deputete,
Përshëndetje të pranishëm,
Konsideroj që në këtë pyetje jemi përgjigjur edhe ministri i Punëve të Brendshme, edhe unë, sa e di unë. Çështja është nën hetime. Pasi që të merren rezultatet, sigurisht që do të merren institucionet hetuese dhe ekzekutuese.

Ne, si qeveri, po ashtu kemi kërkuar që të zbulohet dhe të trajtohet kjo çështje dhe me shqetësim, natyrisht, kemi reaguar konform kompetencave që i kemi.

Bordi i AKP-së është funksional tani, ai i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe unë sigurisht që së bashku me juve do të jemi të interesuar të dimë për rezultatet e hetimeve, çfarëdo qofshin ato. Kaq është komentimi im. Sigurisht që një shprehje popullore e Shqipërisë, thotë: “krimi as nuk thihet, as nuk vdes”. Ai mbetet. Në qoftë se dikush është i përzier aty, ia paftë hairin. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputete, ke pyetje shtesë?
Fjalë e ka deputetja Synavere Rysha!

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, ministër për përgjigjen! Mirëpo, unë si deputete e Kuvendit, por edhe ky Kuvend është i interesuar ta dijë kohën kur do t'i dorëzohet një raport këtij Kuvendi, sepse ndoshta do të ishte e arsyeshme edhe të debatohet për këtë çështje, nëse mundeni, nuk është patjetër.

KRYETARI: Ju faleminderit! Raporti vjen nga Bordi i APK-së. Vazhdojmë me pyetje parlamentare.
Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Deputet Rexhepi, mund ta bëni pyetjen!

ARSIM REXHEPI: I nderuar, zoti Kryetar,
Zoti ministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Prej vitit 1990 sistemi arsimor në Kosovë ka vuajtur ndjeshëm deri më 1999 nga praktika gjenocidiste e Serbisë, e pastaj nga defektet e shumta që e përcollën dhe po e përcjellin deri më sot.

Në këtë hark kohor, me gjithë mbijetesën dhe vazhdimësinë që ka mbijetuar arsimi shqip në të gjitha nivelet, për cilësinë e lë shumë për të dëshiruar. Defekti më i rrezikshëm janë prurjet titullore dhe është mirë të dëgjojë edhe anëtari i Kryesisë, Sabri Hamiti këtë gjë, janë prurjet titullore që ka shënuar puna në Universitetin e Prishtinës. Arritjet titullore shkencore kurrë nuk janë rishikuar, ndonëse është e ditur gjithandej se punimet e doktoraturave dhe procesi i disertacionit gjatë gjithë kohës në të shumtë ka qenë i dyshimtë, i rrezikshëm dhe antikombëtar.

Zoti ministër, a ka gjasa të rishikohen të gjithë ata tituj të marrë gjithandej në Universitetin e Prishtinës gjatë këtyre viteve të fundit?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën, edhe pse ajo kohë e moçme është!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zonja e zotërinj,

Të nderuar deputetë,

Ju faleminderit për një pyetje të tillë! Nëse është fjala për rishikimin e titujve shkencorë, dua të them që kjo është një procedurë e cila i takon brenda për brenda vetëm Universitetit të Prishtinës. Nëse është fjala për plagjiat ose për punë jo origjinale shkencore, definitivisht duhet të respektohet edhe Ligji edhe rregulloret në fuqi brendapërbrenda Universitetit të Prishtinës, meqë u përmendë vetëm tituj shkencor. Nëse është fjala për titujt akademikë, unë dua t'ju informoj si deputet dhe gjithë Kuvendin e nderuar, që ne si Ministri e Arsimit aktualisht jemi duke e hartuar një udhëzim administrativ, i cili i rregullon kriteret, procedurat për marrjen e titujve akademikë në Universitetin e Prishtinës dhe, po ashtu, dua t'ju informoj që gjatë vitit të ardhshëm, si Qeveri e Kosovës do ta sjellim Ligjin për arsimin e lartë për plotësim në Kuvendin e Kosovës dhe do të jetë punë e këtij Kuvendi të Kosovës, i cili vendos edhe për rishikimin e titujve shkencorë, edhe për rishikimin e titujve akademikë, pastaj mbetet vetëm Universiteti i Prishtinës dhe universitetet private vërtet ta respektojnë Ligjin.

Unë mendoj që deri më tash edhe infrastruktura ligjore që ka ekzistuar, ka qenë shumë e mirë, mirëpo nuk është zbatuar ligji në tërësi. Mendoj që do të duhej të shihen rastet veç e veç, ndërsa do të duhej ta krijojmë një sistem ku titujt akademikë dhe titujt shkencorë dhe karriera akademike nuk është e dhënë njëherë e për gjithmonë, por secili akademik do të duhej të konkurronte për vendin e tij të punës brenda një afati 5 vjeçar, ku plan-kriteret do të definohen me Ligjin për arsimin e lartë gjatë vitit 2009.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

Ju faleminderit!

Kalojmë te pyetja e radhës, e katërta me radhë, deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, zotin Ahmet Shala.

Deputet, e keni fjalën!

DRITON TALI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Me shpresë se RTK-ja do ta transmetojë seancën e 18 tetorit, atë seancë të cilën nuk e ka transmetuar, unë do ta bëj një pyetje në frymën e asaj seance, do të thotë edhe konform premtimeve që i ka bërë PDK-ja, por edhe partitë tjera për sjelljen e parave të Trustit dhe të privatizimit në Kosovë.

Ka kohë që Trusti tash po humb para. Pyetja është: Edhe sa kohë duhet të presim derisa të ndërmerri iniciativën për ndërrimin e Rregullores ekzistuese dhe kur mund të presin edhe kontribuuesit kosovarë, por edhe subjektet ekonomike dhe ekonomia në përgjithësi, që t'i kryeni ato përgjegjësitë tuaja? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Përshëndetje, Driton!

Vetë fakti që jemi në një, nëse mund të them, mbase qorrsokak në Trustin e Pensioneve, siç po shihet, me Bordin, mbase e parashtron nevojën urgjente që Rregullorja diçka të ndryshojë, qoftë në mënyrën e vendimmarrjes, qoftë në mënyrën e procedimit deri te vendimmarrja.

Sigurisht që me strukturën ekzistuese të kësaj rregulloreje ose të këtij legjislacioni, Qeveria e Kosovës pas procedimit të Bankës Qendrore të Kosovës, pra me kërkesën e Bankës Qendrore të Kosovës procedon në Kuvend anëtarët e Bordit, nëse është fjala për bordin, se nuk e di se a e pate pyetjen për këtë ndryshim dhe, pastaj, çështja vjen në Parlament për t'u zgjidhur, që sinjorisht besoj se do të zgjidhet në një mënyrë, përndryshe në çdo vonesë humbë secili nga qytetarët që ka besuar që t'i depozitojë këto pare këtu.

Në qoftë se e konsideroni për ndryshimin e strukturës së Bordit, nuk e di cilat ndryshime i kërkon, atëherë sigurisht që një Komision nga Banka Qendrore e Kosovës, sepse është institucion që më së shumti i takon të merret me këtë çështje, në bashkëpunim edhe me grupet parlamentare, në bashkëpunim edhe me Qeverinë e Kosovës, do t'i shqyrtojë kërkesat e juaja për ndryshime eventuale.

Disa shtete kanë praktika të ndryshme, qoftë në ekzistimin, nëse mund të them pozitë monopolistike të Trustit, disa kanë duopole, kanë edhe tri-katër, për shembull Kroacia i ka tri truste, katër truste, Sllovenia i ka dy, Maqedonia i ka dy dhe nuk e di unë cila është pyetja e juaj për ndryshimin. Në qoftë se ju keni specifike ndonjë pyetje, për cilin ndryshim e keni fjalën, unë do të përpiqem të përgjigjem. Ju faleminderit!”

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

Fjalën e ka deputeti Driton Tali!

DRITON TALI: Po, kjo është një arsye edhe më e madhe për RTK-në pse ta transmetojë atë seancë të famshme, se siç po shihet, edhe më tutje ministri nuk i ka të qarta përgjegjësitë e veta. Unë e pyeta karshi Ligjit, neni 6, pika 2.2, lexoje të lutem, se na ke kushtuar 60 milionë euro prej 15 qershorit. Nuk është shumë për ty, se na ke kushtuar edhe më shumë miliona, qindra miliona e miliarda me privatizim e je bërë ministër, me këto “kaq pak para” sa je duke na kushtuar, së shpejti ke për t'u bërë edhe kryeministër. Lexoji ligjet, o burrë, se na myte! Përgjigju në pyetje! Ligjin lexoje, je përgjegjës për ndryshimin e Rregullores me Grupin punës ndërministror, krijoje më atë grup se na teshe!

KRYETARI: Deputet, pyetje shtesë e jo komente! Të lutem!

Ministër, a ke përgjigje? Urdhëro!

AHMET SHALA: Pyetja është: a do të kemi ndërrimin e Rregullores ekzistuese? Unë, natyrisht që neve...

Në rregull, më lë tash të përgjigjem. Mirë, bre, ngadalë, po është një kulturë edhe e komunikimit, ndoshta, të lutem shumë.

Natyrisht që ndryshimet do të bëhen jo nën presionin e Driton Talit, por nën presionin e kërkesave dhe rrethanave dhe të mirëqenies. Nuk është diçka që ti dikton tash tempo këtu, ne jemi duke punuar konform objektivave dhe programit tonë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Forcës e Sigurisë, zotin Fehmi Mujota. Deputet Smaka, e keni fjalën.

RIZA SMAKA: Faleminderit!

Pyetje kuvendore referuar dispozitës së nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit numër 03/046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Me këtë dispozitë është përcaktuar, ndër të tjera, Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtetasit e shoqërisë. Ndërkaq, karakteri, roli, funksioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilin do shtet, nuk korrespondon me komponentën e vullnetarisë e aq më pak me atë të vullnetarisë së tërësishme, tërësisht vullnetare. Kjo është më parë kur me dispozitat ligjore në fjalë, kjo dispozitë nuk është koherente me dispozitën e nenit 126, paragrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Së këndejmi dispozita ligjore lëndore rezulton në diskrepancë me dispozitën kushtetuese...

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari deputet Smaka,

Mund t'ju përgëzoj për interpretim të përimtësuar, do të thosha, të një prej paragrafëve të ligjit, është çështje krejt korrekte që e keni ngritur, por njëkohësisht, dua t'ju përkujtoj në përgjigjen time që ngritja e Forcës së Sigurisë së Kosovës është e bazuar krejtësisht në Kushtetutën e vendit dhe në ligjet e miratuara në Kuvendin e Kosovës.

I nderuari deputet, neni të cilit ju i referoheni në paragrafin 9 pika 1 përmban këto çështje të cilat ju i keni ngritur, por njëkohësisht dua t'ju përkujtoj që në paragrafin 9, në pikën 3 theksohet: "Forca e Sigurisë së Kosovës do të jetë e dizajnuar dhe e përgatitur për ta përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë apo organizatave tjera për zbatim të ligjit". Ky paragraf është në përputhje me nenin 126, pikën 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që thekson karakterin profesional të Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila thuhet se "është profesioniste, pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës dhe rekrutohet nga shtetasit e Republikës së Kosovës"

Misioni dhe detyrat e kësaj force përcaktohen në nenin 10.1 të Ligjit për Forcën e Sigurisë, ku më tej thuhet se misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë, ... e mbështes Qeverinë e Republikës së Kosovës, ndërsa më për së afërmi kjo thuhet në nenin 10.2 a), ku detyrat fillestare të forcës së sigurisë së Kosovës janë të marrë pjesë në operacionet për reagim në raste të krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqes që nënkupton edhe misionet jashtë vendit, dhe të gjitha çështjet janë të nënkuptuara.

Forca e Sigurisë është e mbikëqyrur nga autoritetet civile dhe ajo forcë është shumëetnike, politikisht e paanshme, profesionale dhe vullnetare. Në fushën e armatimit do të ketë armatim të lehtë të standardizuar të ngritur mbi bazën e standardeve të NATO-s dhe nuk do të ketë mundësi të ofensivave ajrore. Pra, kjo është përcaktuar në ligjet që i kemi miratuar.

I nderuari Smaka, kur i referoheni fjalisë krejtësisht vullnetare, kjo nënkupton që secili qytetar i Republikës së Kosovës që dëshiron të aplikojë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

është krejtësisht në vullnetin e tij dhe kjo do të thotë se asnjëri nuk është i obliguar dhe është në përputhje me doktrinat moderne ushtarake që nënkuptojnë parimet, principet dhe standardet e NATO-s. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Jo, ti nuk bën, sepse rendi është këtu. Urdhëro Armend!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, Kryetar!

Faleminderit, për fjalën që e mora pa rend. Është për të të ardhur keq prej qytetarëve të Kosovës, që na kanë deleguar me votën e tyre. Në orën 11,30 nuk janë në gjendje deputetët e Parlamentit të Kosovës të jenë të pranishëm në sallë, ndërsa ne me 41 vota këtu na duhet vetëm edhe një të dalim edhe ta ndërpresim seancën. Është shumë papërgjegjësi e madhe. Le ta mbajnë përgjegjësinë, nuk janë të thirrur që të vijnë të rrinë as në korridor, as për të pirë kafe, por janë të thirrur edhe paguhen për të qëndruar në sallën e Parlamentit dhe t'i kontribuojnë rendit të ditës. Ndërsa, kur t'ju preken çështjet personale, nëse nuk iu emërohet ndonjë njeri i familjes nëpër borde, këtu na qorrojnë sikur na ndodhi para nja 10 ose 20 minutash.

KRYETARI: Armend, faleminderit, por, vërtet është mirë që ta vazhdojmë se kemi numër të mjaftueshëm për ta zhvilluar debatin. Dhe, pastaj a dëgjohet diku a nuk dëgjohet, është çështje e deputetëve.

Deputeti Ibrahim Makolli, pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Makolli nuk është këtu. Vazhdojmë me pyetjen e radhës.

Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Urdhëro, bëje pyetjen deputet!

NAIM RRUSTEMI: I nderuar ministër!

Kohët e fundit kemi raste të shpeshta të blerjeve të mallrave në komunën e Mitrovicës, të Zveçanit, të Zubin Potokut dhe të Leposaviqit, të cilat doganohen apo konfiskohen nga doganierët e doganave të Kosovës. Pyetja ime është: Me të cilën të drejtë doganoni dhe a po konfiskoni mallra që blihen në territorin e Kosovës? E kam fjalën kur posedon faturë të blerjes.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Përshëndetje të gjithëve! Naim, konsideroj se është një pyetje shumë aktuale që ka përcjellë mbase proceset e rënda që po zhvillohen në pjesën veriore të Kosovës. Qëndrimi zyrtar dhe ligjor i institucioneve të Kosovës, Kushtetuta e Kosovës njeh vetëm një territor të Kosovës, Dogana e Kosovës po ashtu respekton këtë ligj. Ne patëm një bisedë më të zgjeruar në lidhje me këtë çështje, në qoftë se ka raste individuale kur një polic ose një doganierë e ndal dhe e konfiskon mallin me një faturë që është marrë në Veri, ajo është çështje individuale, por në qoftë se një qytetar i Kosovës, pa marrë parasysh ka blerë një mall në çdo kënd të Kosovës në Leposaviq, në Zubin Potok apo kudo qoftë dhe ka ardhur në pjesën jugore, në qoftë se ndalet nga doganierët apo policia dhe e ka faturën nga veriu, ai është qytetar në rregull sa i përket çështjes së origjinës së mallit. Në qoftë se sasi të mëdha ndalen dhe nuk kanë prejardhje të mallit, malli konfiskohet. Në qoftë se sasi të mëdha, po ashtu, ndalen dhe nuk ka procedurë ose nuk ka konfirmim se malli është zhdoganuar, inspektorët, doganierët, inspektorët policorë, inspektorët tatimorë kanë të drejtë ta përcjellin çështjen deri në institucionet përkatëse për

të konfirmuar se a ka qenë çështja konform ligjit apo jo? Unë e di që kjo çështje është mjaftë e nxehtë. Ne po përpiqemi me gjitha njësitë mobile të doganave dhe të Administratës Tatimore dhe të policisë për të mos përcaktuar një kufi të ri atje por, natyrisht, proceset nuk janë aq të lehta së bashku tash me EULEX-in besoj që do të arrijmë që deri në fund të nëntorit – dhjetorit të depërtojmë edhe në pikat doganore në veri dhe situata do të vihet nën kontroll, por qëndrimi zyrtar dhe ligjor i Kosovës është që ekziston vetëm një njësi doganore dhe çdo lëvizje e qytetarëve është e lirë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë? Urdhëro!

NAIM RRUSTEMI: I nderuar ministër,
Gjatë dy ditëve të fundit, mua personalisht më ka rastisur të dalë e të qarkulloj disa herë brenda territorit të Mitrovicës dhe çdo herë që kam qarkulluar, jam ndeshur në pika doganore dhe në bisedë me policë më është thanë se çka do që ke, do të konfiskohet nëse bart ndonjë mall, pavarësisht e blen apo nuk e blen. A mund t'u thoni policëve dhe doganierëve që të mos i konfiskojnë mallrat apo nëse veç duhet t' i konfiskojnë, ta qesin në Vushtrri më mirë.

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Policët dhe doganierët e kanë ligjin dhe kodin që duhet ta zbatojnë dhe unë besoj që ata duhet të veprojnë konform kodit dhe ligjit në fuqi. Në qoftë se ndonjë person i autorizuar, qoftë polic, doganier apo kushdo qoftë, nuk e respekton ligjin, ai është jashtë ligjit dhe, natyrisht, në qoftë se keni informata të sakta në lidhje me këtë, ju lutem, paraqitni në dogana dhe paraqitni në polici dhe do të ndërmerren masa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj që morët përgjigjen e pritur.
Deputeti Ibrahim Makolli, pasi që erdhe, edhe pse të kaluam një herë. Urdhëro, bëje pyetjen për ministrin Enver Hoxhaj.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, Kryetar! Po kërkoj falje, por e kam tërhequr këtë pyetje, prandaj nuk kam pyetje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, vazhdojmë! Deputeti Naim Maloku ka pyetje për ministrin e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit të Kosovës, zoti Fatmir Limaj.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
I nderuari zoti ministër, Limaj,

Ndërtimi i infrastrukturës rrugore ka rëndësi të jashtëzakonshme për një shoqëri, edhe për shoqërinë kosovare, gjithashtu. Mua më intereson, zoti Limaj, a mbikëqyrët kualiteti i ndërtimit të rrugëve në Kosovë, me theks të veçantë në pjesën e magjistralit Fushë Kosovë – Sllatinë? Më lejoni që t' ju them, zoti ministër, se shqetësimet e mia nuk ngritën në bazë të vlerësimeve të mia profesionale, sepse nuk jam i atij profesioni, por në komunikim me njerëzit që e njohin atë fushë dhe vetë jam i shqetësuar që nuk është duke u kontrolluar dhe mbikëqyrur kualiteti dhe standardet që duhet t' i plotësojë një aks rrugor i tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, Kryetar!

I nderuari deputet, ju falënderoj për pyetjen!

Dua t'ju them që Ministria e Transportit, në mesin e shumë projekteve të nisura, gjatë këtij viti është duke realizuar edhe projektin e zgjerimit të rrugës – magjistralla 9 Prishtinë – Pejë, segmenti Fushë Kosovë – Sllatinë e Madhe. Punimet në këtë segment kryhen sipas projektit zbatues dhe sipas dinamikës së paraparë kohore. Mbikëqyrja e punimeve si këtu, edhe çdo kund tjetër, kudo që është kontraktor dhe investitor Ministria e Transportit, bëhet dhe është një nga segmentet shumë të rëndësishëm të ciklit të menaxhimit të projektit, bëhet nga ana e ekspertëve të Drejtorisë së Rrugëve, në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë të cilat kanë bërë hartimin e projektit zbatues të kësaj rruge, në rastin konkret në rrugën Fushë Kosovë – Sllatinë.

Gjithashtu, dua t'ju them që analizat e kualitetit të materialit për ndërtimin e rrugëve e bëjnë ekspertët pranë kësaj drejtorie, ndërkaq, me qëllim të sigurimit të kualitetit të ndërtimit të rrugëve- Ministria e Transportit ka kontraktuar një kompani e cila do të bëjë shqyrtimin e kualiteteve të materialeve të përdorura në projektet e infrastrukturës rrugore. Unë dua t'ju siguroj që me kapacitetet të cilat i ka ky vend, me ekspertët të cilët i ka ky vend në këtë fushë janë të gjithë të angazhuar në mbikëqyrjen e të gjitha punimeve që zhvillohen aty ku investon Ministria e Transportit, gjithmonë mbi bazën e mundësive dhe të kushteve në të cilat jeton ky vend dhe me potencialin kadrovik që e ka ky vend.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Naim Maloku e ka fjalën!

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti ministër!

Mendoj që ju e dhatë një përgjigje edhe kjo pyetje ishte që për t'u përdorur edhe në të ardhmen në qoftë se vërtetohet me kalimin e kohës që kualiteti nuk ka qenë në nivel dhe përgjigjja juaj nuk ka qenë ashtu siç duhet. Pra, koha do të tregojë për këtë.

Zoti ministër,

Një nënpyetje tjetër, a është e vërtetë dhe e mundshme që 8 kilometra rrugë në Kosovë kushtojnë 33 milion euro? Nuk kam mund ta gjej një krahasim të tillë në rrugët e shteteve tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Megjithëse dolëm nga pyetja të cilën ju e keni shtruar, për t'ju gjetur një shembull dhe për t'ju ndihmuar edhe unë juve në kuadër të çmimit dhe për t'ju treguar që ka shumë më shtrenjtë se sa këtu, e keni në Mal të Zi, zoti deputet, ku 1 kilometër rrugë kushton 8 milion e 400 mijë euro. Pra, 8 milion e 400 mijë euro 1 kilometër rrugë në Mal të Zi tani është duke u kontraktuar. Ndërsa, meqë dhatë një shembull, ndërsa për të shkuar më gjatë, edhe një herë dua ta them, ta shfrytëzoj rastin, duke ju falënderuar që ju ma dhatë rastin të përgjigjem, të them se askund në botë dhe as në Kosovë nuk është institucioni, nuk është Ministria që i përcakton çmimet, por ato i përcakton tregu. Pra, është kompania projektuese e cila i nxjerr paramasat e një projekti të caktuar dhe mbi bazën e këtyre paramasave ne shkojmë në kontraktim. Në qoftë se do të ndodhte se kompania projektuese ka nxjerrë një çmim 100%, 50% më të lirë dhe ne kemi shkuar në një ngritje të çmimit 100% më të shtrenjtë, atëherë ju do të kishit shumë të drejtë për të kërkuar sqarime. Unë dua t'ju siguroj dhe ju ftoj që të kontrolloni të gjitha dokumentet që ne i kemi aty, del se çmimi në rrugën Fushë Kosovë – Sllatinë është nën

planifikimin e paraparë nga kompania projektuese. Pra, janë ata që cilët e nxjerrin çmimet dhe është tregu i cili dikton çmimet, nuk është Ministria e Transportit. Se a është shtrenjtë, a është lirë, unë ju kisha ftuar t'i hulumtoni çmimet çka është duke ndodhur në rajon e përtej rajonit. Ju siguroj që kudo që të vëzhgoni, kudo që të hetoni, do të dalë minimumi 50% më i lirë në Kosovë në realizimin e punimeve që janë duke u bërë në krahasim me rajonin.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Vazdojmë.

Deputetja Nurishahe Hulaaj, pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq apo zëvendësministrin Gjergj Dedaj. Ju e dini që zëvendësit nuk përgjigjen, do të thotë veç ministrave u bëhen pyetje. Deputete, e ke fjalën.

NURISHAHE HULAJ : Faleminderit, Kryetar i Kuvendit!

Faleminderit Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Çështja: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e punës numër L/017, Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqeni Sociale ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin e punës në bazë të rregullave 35.4, 36 dhe 46 të Rregullores së punës së Kuvendit. Shqyrtimi i Projektligjit është bërë më 11 dhe 18 mars 2008 dhe ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Projektligji është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 29.4.2008. Zbatimi i këtij ligji është i lidhur në tërësi me Inspektoratin e punës që mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të këtij ligji në tërë territorin e Kosovës. Pyetja është: A është e vërtetë se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka formuar Agjencinë ekzekutive të Inspektoratit të Punës, ku një gjë e tillë nuk lejohet me Ligjin për Inspektoratin e punës për shkak të implikimeve buxhetore dhe të interesave...?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsjedniče,

Poštovane kolege ministri,

Gospodo,

Ja, u stvari, pitanje nisam dobio, ali pokušaću da vam odgovorim. Kao što znate, mi smo da kažem, situaciju u Inspektoratu za rad nasledili i ono na čemu ćemo mi ubuduće raditi u njemu je izmena ili dopuna određenih akata, zakona, da tu, što ste vi rekli, agenciju da na jedan način uskladimo sa zakonima i da to bude samo naglašeno u nazivu Inspektorata rada. Tu je bilo, u toj istoriji Inspektorata rada je bilo dosta promena, tako da je ostalo da mi u jednoj daljoj dopuni zakona uradimo sve da bi finalizirali da to bude u pravnim normama i pravnim okvirima kao što bi i normalno trebalo da bude. Ja u ovom momentu ne mogu da vam dam precizan odgovor kada bi to moglo biti, ali će sigurno to biti u što kraćem mogućem roku. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

NURISHAHE HULAJ: Ekziston Ligji për Inspektoratin e Punës, është bërë ndryshimi me qëllim që të mos ketë Agjenci për Inspektoratin e punës për shkak se ligji ka qenë shumë konfuz dhe për këtë arsye është bërë ndryshimi dhe plotësimi i ligjit. Ekziston si Ligj i Inspektoratit të punës, nuk mund të ketë agjenci në atë ligj dhe nuk mund të thirren në agjenci, por mund të thirren vetëm në Ligjin për Inspektoratin e punës. Nuk mora

përgjigje të saktë, a është themeluar agjencia apo nuk është themeluar kur e kemi Ligjin për Inspektoratin e punës.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Kao što sam već rekao, mi smo dosta tih nejasnoća nasledili, tako da ono što mogu da vam kažem jeste da ćemo ih u buduću popraviti, jer sam ja imao prilike da pokrenem u vezi Inspektorata za rad tih nekoliko pitanja koje ste vi rekli. Ono što mogu da vam kažem da je to, kao što sam i rekao, Inspektorat za rad i on će i u daljem periodu i u buduću to i biti. Nije kao što ste vi nazvali Agjencia Ekzekutive, ili Ekzekutivna agencija. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Kaqusha Jashari, pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Pula- Shiroka. Deputete, mund ta bëni pyetjen!

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë nuk ia kisha bërë pyetjen ministres, por e ka këtu pyetjen menjëherë për zotin Fatmir Limaj, me lejen tuaj.

KRYETARI: Ministri është këtu, prandaj mund ta bëni për ministrin Limaj. Urdhëroni!

KAQUSHA JASHARI: Prej zonjës i kemi marrë disa informata edhe në Komision, prandaj për atë nuk kam nevojë.

KRYETARI: Do të thotë, ajo pyetje tërhiqet. Mirë!

KAQUSHA JASHARI: Zoti ministër,

Ku ka arritur përgatitja për nisjen e realizimit të projektit autoudha Merdar – Vërmicë, si pjesë e projektit madhor Kukës – Durrës. Pjesa në Shqipëri, sikur që dihet, po ndërtohet dhe planifikohet kryerja e punimeve në vitin 2009. Më intereson të di për përgatitjet teknike, domethënë projekti a është gati e jo infrastruktura ligjore, sepse e kemi në proces Ligjin për shpronësim e të tjera, ose dhënia për koncesion, prandaj vetëm përgatitja teknike dhe a po diskutohet konstruksioni financiar? Faleminderit!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, Kryetar!

Faleminderit për pyetjen! Dua t'ju them që Ministria e Transportit gjatë këtij viti ka filluar procedurat e nevojshme për realizimin e projektit të ndërtimit të autoudhës Morinë – Merdar. Siç e dini, një herë kemi shpallur shprehjen e interesit për kompanitë e kualifikuara për ndërtimin e kësaj rruge, ndërkaq aktualisht është duke u përgatitur dokumentacioni i ofertimit publik për konsulencë financiare në të cilën do të përzgjidhet modaliteti më i mirë dhe më i favorshëm, po ashtu edhe më i përshtatshëm për financimin e këtij projekti madhor. Dua t'ju them që ne jemi duke përgatitur gjithë infrastrukturën ligjore të domosdoshme për një projekt të tillë madhor, të përgatitmi për të filluar me ekzekutimin e punimeve. Unë dua përsëri ta përsëris para jush se projekti i cili ekziston ka pasur defekte, mungesa të cilat janë të domosdoshme të përmbushen, të përmirësohen. Është fjala se matjet gjeomekanike i mungojnë këtij projekti dhe ne tash jemi të detyruar që të hapim ofertë edhe për konsulentë financiarë, edhe për mbikëqyrjen e punimeve, por edhe për përmbushjen ose revidimin e projektit për shkak të mungesave të këtyre matjeve gjeomekanike. Do me thënë, jemi në një proces të përpunimit,

shpresojmë, presim që gjithë kjo të përfundojë diku në pranverë dhe të jemi të gatshëm për ta bërë përzgjedhjen e kompanive të cilat do ta kryejnë punën.

Dua t'ju them, të nderuar deputetë, se për një projekt të tillë madhor ne jemi të interesuar të gjejmë burime financiar jashtë buxhetit të Kosovës. Është e pamundur që me buxhetin e Kosovës të realizohet një projekt i tillë madhor. Prandaj, kemi shenja pozitive nga financierët ndërkombëtarë, nga banka të ndryshme, të cilat janë të interesuara të futen në këtë projekt. Në qoftë se shkon kjo ashtu siç i kemi shenjat, do të dalë që nuk do të ketë nevojë që buxheti edhe ashtu i vogël i këtij vendi, të ngarkohet me një projekt kaq madhor, i cili, së paku, kushton sa i gjithë buxheti i Kosovës- përfundimi i kësaj rruge tepër të rëndësishme për vendin. Do të them që Ministria e Transportit po i merr të gjitha masat që ta përgatitë infrastrukturën edhe ligjore, edhe teknike për t'u futur në një projekt të tillë. Ne do të jemi të kujdesshëm se po marrim praktikrat e vendeve të tjera të cilat kanë pasur probleme. Ka pasur probleme edhe Shqipëria, ka pasur probleme edhe Mali i Zi, ka pasur probleme edhe Bullgaria, edhe Rumania me një projekt të tillë dhe ne duam që, duke marrë këto eksperiencë, të mos bëjmë gabimet e tyre, që në fillim të projektit të na paraqiten telashe, të cilat pastaj do të komplikonin zhvillimin e punimeve dhe përfundimin e këtyre punimeve në një projekt kaq të madh me interes të vendit.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!
Vazhdojmë edhe me një pyetje, pastaj e bëjmë një pauzë, a jeni dakord? Deputeti Emrush Xhemajli, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti ministër,

Pyetja ime ka të bëjë me krizën financiare globale që e ka përfshirë botën dhe deshëm të dimë përveç Trustit Pensional, për të cilën gjithë e dimë, a ka reflektuar në pjesë tjera të segmenteve financiare dhe në përgjithësi në ekonominë e Kosovës kjo krizë?

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Ahmet Shala!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari deputet,

Momentalisht, në fakt, për hir mbase edhe të një qeverisje mjaft të shtrënguar ose monitorimit të shtrënguar nga ana e Bankës Qendrore ndaj bankave komerciale në Kosovë dhe duke mos qenë bankat që operojnë në Kosovë në madhësi aq të madhe sa të kenë shtrirjen nëpër tregjet globale, Kosova në aspektin bankar nuk është drejtpërdrejtë e atakuar. Këto informata i japim në bazë të raporteve po thuaj se ditore që i marrim nga Banka Qendrore e Kosovës dhe informacioneve tjera nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Sigurisht që ndodhjet në glob, sidomos në sferën bankare dhe ekonomike, nuk do lëshojnë pa pasur efekte afatmesme dhe afatgjate në zhvillimin ekonomik. Prognozuesit e mëdhenj botëror parashohin një ngecje në zhvillimin ekonomik, nëse jo një recesion. Askush nuk mund me saktësi të pretendojë se cila do të jetë shkalla e recesionit dhe sa e thellë do të jetë ajo, por fatmirësisht, nëse mund t'ju them, tregjet kosovare tani për tani janë ato bankare janë në rregull. Efektet e recesionit do jenë afatmesme dhe afatgjate. Në anën tjetër, ana, nëse mund të them, pozitive, është që kjo krizë zvogëlon kërkesën dhe me zvogëlimin e kërkesës mund të shkaktojë edhe zvogëlimin e çmimeve dhe të shërbimeve. Andaj, duke qenë treg importues ose vend importues, nuk do të afektohem shumë në aspektin e çmimeve, por mund të afektohem në aspektin e dinamikës së zhvillimit ekonomik.

Megjithatë, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare ka marrë masa që rezervat buxhetore, ato që i kemi paraparë ne për vitin 2009, të jenë 200 milionë euro dhe masat tjera, nëse mund të them, ose qasja konzervative ndaj propozim buxhetit është një siguri që na jep neve që të jemi pak më të relaksuar në aspektet afatshkurtra. Në aspektet afatgjata do jemi goxha hezitues tani të flasim, sepse është vështirë për t'i predikuar zhvillimet ekonomike në Evropë dhe në tregun global. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

A ka pyetje shtesë? Nuk ka. Faleminderit!

Ju njoftoj që 10 minuta ju kemi mbetur borxh për pyetje, vazhdojmë nesër, domethënë 70 minuta. Tani do të kemi një pushim. Edhe pushimi i drekës le të jetë për shkak se Qeveria ka mbledhje në orën 12,00, kurse në orën 13,30 vazhdojmë seancën.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI SABRI HAMITI: I lusim deputetët të ulen se do t'ia fillojmë punës.

Vazhdon seanca, pika e tretë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë projektligjin.

Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti Kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht ta prezantoj Projektligjin për bujqësinë dhe zhvillim rural.

Qëllimi i projektligjit është krijimi i kornizës ligjore, përparimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me përcaktimin e politikave për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural në përgjithësi.

Arsyet për propozimin e këtij projektligji janë: eliminimi i zbrazëtirave ligjore që kanë të bëjnë me objektivat, masat dhe programin e politikave të bujqësisë dhe të zhvillimit rural në bazë të planit për zhvillim rural dhe bujqësor 2007-2013.

Ky projektligj është hartuar sipas teknikës juridike bashkëkohore dhe është në harmoni me standardet e BE-së, përkatësisht Rregullorja numër 1782/2003 e datës 29 shtator 2003, e cila përcakton rregullat e përbashkëta për mbështetje të drejtpërdrejtë për politikën e përbashkëta bujqësore.

Pastaj Rregullorja numër 1290/2005 e datës 21 qershor 2005 për financimin e politikave të përbashkëta bujqësore dhe Rregullorja numër 1698/2005 e datës 20 shtator 2005 për mbështetjen për zhvillim rural nga Fondi Evropian i Bujqësisë.

Përmbajtja e Projektligjit:

Çështjet e adresuara nga projektligji janë të përfshira në XI kapituj me gjithsej 32 nene.

Në kapitullin I janë të përshkruara dispozitat e përgjithshme,
Në kapitulli II programi i politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural,
Në kapitulli III masat e politikës bujqësore,
Në kapitullin IV përshkruan masat e politikës së zhvillimit rural,
Në kapitullin V është struktura e institucionale për politikën bujqësore dhe zhvillimin rural,
Në kapitullin VI përshkruan bazat e të dhënave dhe të sistemit të informimit,
Në kapitullin VII format e organizimit të prodhuesve, përpunuesve dhe tregtuesve të produkteve bujqësore,
Në kapitullin VIII shërbimet publike në bujqësi dhe zhvillim rural,
Në kapitullin IX mbështetja për hulumtim, arsimim dhe trajnim,
Kapitulli X ankesat dhe
Kapitulli XI dispozitat përfundimtare.

Hartimi i këtij projektligji është në përputhje me nenin 36 të Rregullores së Punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës, Rregullorja nr. 1/2007.

Gjatë hartimit të këtij projektligjit si model bazë janë marrë: ligji slloven, austriak dhe ai gjerman.

Versioni final i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural është shqyrtuar dhe përfunduar nga grupi punues qeveritar në përbërje: Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Fakulteti i Bujqësisë dhe Agjencioni për Kadastrat e Kosovës.

Projektligji është në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së.

Propozoj që ky projektligj të pranohet në parim nga Kuvendi i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Unë nuk po shoh që kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Lulzim Zeneli e ka kërkuar fjalën. Nuk po shoh që kanë kërkuar fjalën as komisionet e tjera, komisionet e përhershme. Atëherë, fillojmë me prononcimet rreth ligjit të grupeve parlamentare. Thërras përfaqësuesin e PDK-së që ta japë fjalën. Elhame Hetemi.

ELHAME HETEMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Bujqësia dhe zhvillimi rural kërkon një vëmendje dhe trajtim të duhur institucional. Zhvillimi rural nënkupton rregullimin e infrastrukturës, ndërtimin e infrastrukturës së përgjithshme në zonat rurale, me qëllim të krijimit të një ambienti më të përshtatshëm për të jetuar dhe zhvilluar veprimtaritë e biznesit, me theks të veçantë agrobiznesit. Kjo

do të mundësonte krijimin e vendeve të reja të punës dhe rigjenerimin e të ardhurave nëpër ato zona.

Infrastruktura ligjore për rregullimin e kësaj fushe është e nevojshme, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj për ta dhënë kontributin e vet në komisionin funksional gjatë shqyrtimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Meqenëse Kosovës i mungon infrastruktura e përshtatshme ligjore për çështjet që kanë të bëjnë me bujqësinë dhe zhvillimin rural, Projektligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural ka një rëndësi të veçantë për plotësimin e kësaj zbrazëtire në infrastrukturën ligjore.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore për parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me zbatimin e planit të zhvillimit rural dhe bujqësor në Kosovë, me të cilin përcaktohen: objektivat, masat dhe programi i politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Andaj, Grupi Parlamentar i LDK-së është për miratimin e këtij projektligji në parim. Kontributin tonë do ta japim në kuadër të komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Pantina!

Në emër të Aleancës Kosova e Re, Haset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Projektligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural ka për qëllimin përcaktimin e politikave zhvillimore për bujqësinë në zonat rurale.

Ky projektligj është hartuar në XI kapituj dhe ka gjithsejtë 32 nene. Kapitulli II, neni 5 parasheh planin kombëtar të bujqësisë dhe zhvillimit rural, i cili bazohet në analizën aktuale, objektivat afatmesme të politikës bujqësore dhe zhvillimit rural, masat, programet dhe veprimtaritë në realizimin e këtyre objektivave.

Ky plan kombëtar i bujqësisë dhe i zhvillimit rural duhet të hartohet sa më shpejtë që është e mundur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji me qëllim që të arrihen objektivat e parashtruara para tij.

Ky projektligj është i hartuar në përputhje me Deklaratën e pajtueshmërisë së legjislacionit të Bashkimit Evropian. Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e ka shqyrtuar këtë projektligj edhe përkundër disa vërejtjeve të përgjithshme dhe konkrete në ligje të caktuara, për shembull neni 18, neni 27 është pajtuar që të procedohet në Komisionin funksional, por ne si Grup Parlamentar do të angazhohemi që me

propozime konkrete të kontribuojmë që ky projektligj të jetë sa më i aplikueshëm në praktikë. Ju faleminderit, zoti Kryesues

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Cakolli

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka fjalën deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti Kryesues

Të nderuar kolegë,

Si Grup Parlamentar ne e mbështesim në parim këtë projektligj. Mendoj që ky projektligj është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit tonë duke ditur se në prioritetet qeveritare duhet të ishte sektori i bujqësisë, njëri nga sektorët bartës zhvillimor, hartimi i këtij projektligji duhet të ndihmonte sektorin e bujqësisë

Ne e përgëzojmë Ministrinë për punën që e ka bërë në hartimin e këtij projektligji. Mirëpo, shtrojmë dilema tepër të mëdha se me këtë projektligj a mund të arrijmë që ta mbrojmë edhe një herë të shtrojmë probleme që mbrojtjen e tokës bujqësore bashkë me ministrinë përkatëse, posaçërisht me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe si mund ky projektligj të hyjë në funksionin e zhvillimit ekonomik, duke ditur se një pjesë e madhe e popullsisë- afër 60% të popullsisë jetojnë në zonat rurale.

Prandaj, them edhe një herë në parim e mbështesim këtë projektligj si Grup Parlamentar do të japim kontributin tonë në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Çeku!

Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputetja Besa Gaxherri.

LULZIM ZENELI: Me kartel të Besa Gaxherrit nëse bën.

KRYESUESI: Lulzim Zeneli flet, jo Besa.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë konsideron se ky projektligj dallon për nga natyra, për nga përmbajtja dhe për të gjitha elementet që kanë të bëjnë me natyrën e një projektligji dhe në këtë kontekst duke konsideruar si kornizë e cila e ka paraparë Qeveria e Kosovës të kornizojë rregullimin e politikave dhe masave për të cilën pretendon të adresojë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, atëherë duhet të shpresojmë se ky projektligj do të ofrojë të paktën një ndihmesë në implementimin e politikave të kësaj natyre në këtë segment. Prandaj, pa hyrë në detaje ne si Grup Parlamentar japim mbështetje parimore dhe konsiderojmë se, në qoftë se ky projektligj do të vihet në implementim të asaj çfarë pretendojnë Qeveria dhe Ministria përkatëse, atëherë do të krijohet një bazë e mirë që do t'i operacionalizonte politikat qeverisëse. Ju faleminderit

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zeneli!

Për Grupin “7+” nuk ka paraqitje. Për Grupin SLS nuk ka paraqitje. Kush është ai? Haxhi Merxha e kërkon fjalën në emër të Grupit “7+”. Urdhëro Haxhi.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti Kryesues!

Zonja dhe zotërinj ,

Zotërinj ministra,

Edhe Grupi ynë “7+” e mbështet Ligjin e bujqësisë në parim, më tutje do ta shohim Komisionin çka do të bëjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Merxha!
Fjalën e merr deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryesues!

Pa dyshim mendoj që ky projektligj duhet të përkrahet edhe është shumë i nevojshëm do të thosha ky sektor edhe prapë po vazhdon, ndoshta, të mbet më i prapambeturi në ekonominë e vendit tonë dhe me një ritëm të ulët të rritjes në krahasim me sektorët tjerë.

Deri sot në Kosovë shumë pak i është dhënë mbështetje e drejtpërdrejtë për prodhimet e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe, ndoshta, ky projektligj me hyrjen në fuqi do ta rregulloj apo do ta përmirësojë këtë çështje.

Mendoj që gjatë punës në Komisionin funksional prapëseprapë edhe përkundrazi që kanë punuar ekspertë në hartimin e këtij projektligji duhet më shumë të thirren në ekspertë edhe në çështjet që i takojnë situatës vendore apo ekonomisë vendore. Këtu konkretisht ajo çka mendoj unë sepse mungon fjala bujk dhe ajo e cila është definicioni i bujkut individual dallon nga fermerët dhe kjo çështje është shumë më e theksuar në vendin tonë se sa organizimi që është në kooperativa apo fermerë, sidomos tani pas lufte. Mendoj se dallimi është i madh dhe kjo çështje duhet të rregullohet, askund në ligj nuk përmendet fjala bujk as si definicion po as si rregull si do të bëhet regjistrimi i bujqve individual vetëm i atyre të cilët janë në mënyrë të organizuar.

E përmendën, ndoshta, tërthorazi plani kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural mendoj që prapëseprapë është shumë vështirë për momentin i zbatueshëm duke marrë parasysh tokat dhe parcelat bujqësore të uzurpuara me të drejtë apo pa të drejtë unë nuk mund të gjykojë në këtë rast por prapë se prapë edhe këtu duhet një bashkëpunim me Ministrin e Ambientit dhe një rregull më efikas ligjor që kjo të jetë e suksesshme dhe efikase, sepse e dimë se pas lufte tokat bujqësore vetëm janë ndarë ngastrat në mënyrë individuale dhe sot e asaj dite shumica janë të uzurpuara.

Te neni 9, edukimi i fermerëve i bujqve dhe për mënyrën e prodhimit është edhe për mundësitë për plasman të produkteve. Njëkohësisht gjatë hartimit të projektligjit të konsultohen shoqatat e bujqve dhe fermerëve të Kosovës. kjo do t'i kontribuonte drejtpërdrejt në rritjen e prodhimtarisë së bujqësisë dhe në zhvillimin rural. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e merr deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Respekt zoti kryesues!
Qeveritarë dhe deputetë të nderuar,

Kam tri vërejtje parimore. Te neni 4 do të duhej të hiqe, të zëvendësohej termi konkurrencë me kompeticion, as konkurrencë, as kompeticion nuk është fjalë shqipe, as serbishte apo boshnakishte. Konkurrenca e ka një kuptim interesat, e përdorim masovikisht në kuptimin esencë e nocionit të kompiticionit, po fundi i fundit mund ta përdorim garë, se konkurrencë është kur 2 apo 3 janë koherentë, janë në harmoni me pikëpamje, me qëndrime, me veprime, e tjera, e tjera. Nuk është fjala për gara, kjo është kompiticion.

Më pastaj, kështu kush dyshon, mund të këqyrë në çfarëdo glosari apo fjalori terminologjik.

Te neni 7. Neni 7 i përcakton parimet e masave të politikave bujqësore. Kjo është tematikë e diskrecionit funksional, nuk është tematikë juridike, ligjore, kjo është ingerencë prorogative e ministrit, ju lutem, dhe ai apo ajo do të duhej t'i përcaktonte ato politika që do të ishin të gjitha të miratueshme për atë që nuk do të ishin në kolizion me ligjin apo me moralin. Prandaj, kjo është çështje e funksionit, e diskrecionit funksional.

Edhe një vërejtje kështu, që medoemos do të duhej të amendohej, është te neni 29. Këtu është formuluar gabimisht, edhe koncepti është gabim. Thotë, kundër vendimit të inspektorit mund të paraqitet ankesë. Më së pari, Inspektori është organ individual, organi individual kurrë nuk miraton vendim, po aktvendim dhe me shkrim. Te kryeshefi i inspeksionit, Kryeshefi i inspeksionit praktikisht është organi i instancës së parë në administratë, e nuk është inspektori dhe nuk mund të lejohet që ankesa kundër një organi t'i drejtohet, t'i adresohet të njëjtit organ dhe të vendos i njëjti organ, se do të ishte në kolizion në parimin e dy shkallshmërisë. Koncepti nuk është në rregull, edhe afatet. Më pastaj bëhet edhe më gabim kur në vend që..., se kjo është çështje juridike administrative. Çështjet juridike administrative nisen në organet e administratës dhe përfundojnë në Gjykatën Supreme të Kosovës, nëse shkohet deri atje në konfliktin administrativ. E këtu e ka drejtuar në gjykatë të kompetencës së përgjithshme, që nuk është praktikë në jurisdikcion, nën një. Edhe po të ishte, nuk do të duhej ta akceptojmë ne, sepse gjykatat tona mjerisht kanë me qindra mija lëndë të pakryera dhe nuk do të kryheshin kurrë, e këto janë çështje të natyrës urgjente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Smaka!
Fjalën e ka kërkuar deputetja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!
Përshëndetje të gjithëve!

Duke e vlerësuar nevojën e madhe për këtë Ligj në këtë sferë kaq të rëndësishme, ku ekonomia e Kosovës mbështet në fakt një komponentë të saj në bujqësi dhe agrikulturë.

Desha t'i theksoj disa çështje parimore.

Një, është fjala për fenomenin e zvogëlimit gjithnjë e më të madh të tokave pjellore dhe kthimin e tyre në vend-ndërtime, kantier të ndryshëm, ku mendoj se ky ligj duhet të jetë më i precizuar dhe, ndoshta, në kombinim edhe me ligjet tjera që rregullojnë planifikimin hapësinor, pra njëherë e përgjithmonë të ndërpritet ky trend negativ i cili po e dëmton Kosovën në planin e bujqësisë.

Së dyti, desha të theksoj se ka nevojë për një bujqësi të modernizuar ku në ligj do të duhet të reflektonin gjërat të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e aftësive në këtë fushë, një teknologji moderne, revitalizim, por edhe subvencione në këtë fazë kalimtare, sado që subvencionet duken jo atraktive dhe jo në frymën e standardeve evropiane, megjithatë në fazat e tranzicionit duhet të përdoren si mekanizma për ta ndihmuar bujqësinë e Kosovës.

Së treti, desha të theksoj po ashtu që për të pasur një bujqësi të mirë, duhet të forcohen mekanizmat e mbrojtjes së ambientit dhe ky ligj duhet të reflektojë në këtë çështje edhe me një ndërlidhje me ligjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit.

Së katërti, desha të them që edhe në bujqësi duhet të ketë partneritet publiko – privat, në mënyrë që proceset në të cilat gjendemi dhe duke marrë parasysh faktorin ekonomik, i cili ende nuk është i favorshëm në Kosovë, zhvillimi i një bashkëpunimi të tillë mund të jetë një kontribut dhe mendoj se ky ligj duhet t'i përfshijë këto aspekte. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Tahiri!
Nuk kemi më diskutues.

Unë e thërras regjinë të bëhet gati për votim, po ashtu, deputetët.

Në sallë kemi 78 deputetë. E vë në votim ligjin, në parim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 75 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, ne votuam në parim këtë ligj.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, si komision funksional,
2. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
3. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
4. Komisioni për Komunitete dhe
5. Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga ky shqyrtim, pra shqyrtimi i parë, Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për faljen

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji. Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Republikës të Kosovës para deputetëve të Kuvendit të paraqesë Projektligjin. Urdhëroni, zonja ministre.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari kryesues i seancës parlamentare,
Të nderuar deputetë e deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të Ministrisë së Drejtësisë t'ia paraqes për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për faljen, i cili ka dalë si rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë.

Në fillim dua të theksoj se dispozitat e këtij ligji janë në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të Bashkësisë Evropiane dhe të shteteve tjera demokratike.

Zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë, së bashku me zyrtarët e Qeverisë, të Presidencës dhe ekspertët ndërkombëtarë, përfshirë EULEX-in, ekspertët amerikanë, USAID-in, ICO-n, në takimet e përbashkëta kemi punuar për hartimin e këtij projektligji në mënyrën më të mirë dhe më profesionale. Me këtë ligj krijohet baza e nevojshme ligjore përmes të cilit Presidenti i Republikës së Kosovës do ta ushtrojë funksionin e tij ekzekutiv për dhënien e faljes në pajtim me paragrafin 29 të nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Përveç kësaj, me këtë projektligj krijohet edhe një bazë e mirëfilltë dhe e qëndrueshme ligjore për dhënien e faljes nga ana e Presidentit dhe përcaktimin e procedurave ligjore dhe të standardeve bazë që duhet të plotësohen nga i burgosuri për të përfutur nga ky ligj, përkatësisht nga falja.

Projektligji për faljen është hartuar në pajtim të plotë me parimet themelore të metodologjisë moderne legislative dhe të teknikës juridike për hartimin e ligjeve.

Megjithëse ky projektligj nuk është voluminoz, kjo nuk do të thotë se është i parëndësishëm, përkundrazi, miratimi dhe fuqizimi i shpejtë i këtij ligji është në interes të të burgosurve, të familjarëve të tyre dhe shoqërisë tonë në përgjithësi.

Gjithashtu, është në funksion edhe të kompletimit të infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë.

Prandaj, shfrytëzoj rastin t'ju lus që sa më parë të miratohet projektligji i propozuar, në mënyrë që të hapet rruga për nënshkrimin e tij nga ana e Presidentit dhe të shpallet në "Gazetën zyrtare."

Në fund, ju lus që të merret në konsiderim edhe vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/41 datë 23 tetor 2008, lidhur me kërkesën për përshpejtimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre!

Fjalën e ka Bahri Hyseni, në emër të komisionit raportues. Urdhëro, zoti deputet!

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht, komisioni funksional e ka pasur në shqyrtim dhe ka hartuar një raport preliminar për ligjin në fjalë.

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka projektligji dhe duke pasur parasysh që për herë të parë qytetarët e Kosovës do të kenë mundësinë që nga Presidenti i shtetit të bazohen në nenin 84 pikën 29 që t'i falë njerëzit të cilët gjenden në burgje. Edhe pse është falje individuale, komisioni konsideron se ligji është shumë i nevojshëm dhe është i gatshëm që me procedurë të përshpejtuar, brenda afatit të paraparë, të bëjë edhe leximin e dytë apo t'i përgatisë amendamentet e domosdoshme për leximin e dytë. Në këtë rast, do të respektojmë edhe kërkesën e Qeverisë së Kosovës që ka kërkuar që të bëhet me një procedurë të përshpejtuar.

Me rastin e shqyrtimit të projektligjit në fjalë, Komisioni konsideron se duhet të plotësohen edhe disa dispozita të cilat nuk janë paraparë në këtë projektligj. Fjala është që në këtë projektligj nuk është rregulluar apo është përjashtuar mundësia e përsëritjes së kërkesës për falje, nëse njëherë nuk e ka realizuar faljen.

Çështje tjetër me interes në këtë projektligj është se, ndoshta, duhet të hartohet një amendament apo nen përkatës, i cili do ta rregullojë çështjen e të dënuarve jashtë

gjykatave të Kosovës, ku janë marrë vendimet nga jashtë, kurse vuajtjen e dënimit e bëjnë në entet ndëshkimore në Kosovë, sepse edhe kjo çështje është e parregulluar.

Komisioni ka konstatuar se me rastin e hartimit të projektligjit janë tejkaluar kompetencat në nenin 3, paragrafi 1 dhe unë do ta lexoj. “Falja është një pushtet i jashtëzakonshëm ekzekutiv i Presidentit që ka për qëllim përdorimin e një mjeti jo të rregullt e të rrallë për t’i korrigjuar padrejtësitë e dukshme, të shpërblejë sjelljet dhe karakteret e jashtëzakonshme apo t’i adresojë shqetësimet e jashtëzakonshme humanitare”. Ky nen bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse Kushtetuta e Republikës së Kosovës në mënyrë parimore dhe normative i ndanë pushtetet, prandaj kjo nuk është një kompetencë e jashtëzakonshme e Presidentit për t’i rregulluar padrejtësitë, por është një e drejtë ekskluzive që ia njeh Kushtetuta, duke pasur parasysh edhe vendet të cilat kanë standarde evropiane dhe e njohin këtë të drejtë.

Prandaj, mendoj që ky nen duhet të amendohet, sepse është në kundërshtim me Kushtetutën.

Mandej, në paragrafin 3, thuhet: falja shlyhet, burgosja, masat mbrojtëse e kështu me radhë. Edhe ky nen është në kundërshtim, falja nuk ka për qëllim t’i shlyejë dënimet, sepse ajo është një procedurë tjetër, por falja ka për qëllim ta lirojë të dënuarin, i cili gjendet në burgjet apo në entet ndëshkimore kudo në Kosovë.

Dhe, krejt në fund, neni 10, nëse e merrni dhe e lexoni, thotë: “Ky projektligj nuk ka për qëllim t’ia kufizojë kompetencat Presidentit të Kosovës”. Edhe kjo bie në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, sepse asnjë projektligj dhe as Projektligji për faljen nuk e ka mundësinë që t’ia kufizojë kompetencat të cilat i njihen me Kushtetutën e Kosovës.

Komisioni konsideron që Projektligji për faljen duhet të miratohet, në parim, dhe ne jemi të gatshëm që këto çështje që i ngritëm këtu, në seancë plenare së shpejti të bëjmë amendamentet dhe ta sjellim për miratim në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni!

Tash kalojmë te përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Po më duket, në emër të PDK-së, deputeti Hajredin Hyseni.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra të pranishëm,

Është për t’u përshëndetur sjellja e këtij projektligji, i cili vërtet ka qenë i domosdoshëm kur të kihet parasysh se tani Kosova është shtet i pavarur dhe të burgosurit në Kosovë një kohë të gjatë nuk kanë mundur që ta ndiejnë dorën e institucioneve dhe të krijojnë mundësi dhe shanse të reja për t’u rehabilituar në jetën shoqërore.

Dua t’i theksoj disa vërejtje të cilat mendoj se duhet të përmirësohen në këtë projektligj për të qenë më funksional dhe për t’i kuptuar drejt.

Me këtë projektligj Presidenti nuk ndreq padrejtësi, siç thuhet në nenin 3 të tij, Presidentit i mundësohet të falë të dënuarit sipas ligjit, sepse kështu do të nënkuptojë se ligjet janë të padrejta apo gjykatat janë të padrejta në vendimet e tyre dhe tani Presidenti po i ndreq ato. Kjo mendoj se duhet të evitohet dhe të qartësohet se falja nuk është ndreqje e

gabimeve. Duhet të kuptohet se falja rregullohet me ligj dhe, derisa rregullohet me ligj, nuk është pushtet i jashtëzakonshëm ekzekutiv i Presidentit, por është mundësi e normuar ligjore e tij, e cila parashihet edhe në Kushtetutë. Mendoj se këto janë qenësore për këtë projektligj, andaj duhet të riformulohet tërësisht neni 3.1.

Mendoj që edhe kriteret dhe mundësitë e Presidentit duhet të qartësohen me ligj se kur mund të ketë falje.

Pra, ligji nuk saktëson mundësitë e Presidentit, të cilat duhet t'i saktësojë, por vetëm jep mundësitë. Mendoj se ligji është i domosdoshëm në një shoqëri tranzitore dhe duhet përshëndetur qëllimin humanitar të tij.

Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah në parim Projektligjin.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinetit qeveritar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Është e qartë tani se nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji për faljen është e domosdoshme me të cilin do të rregullohet dhe të sigurohet baza ligjore për dhënien e faljes.

Ne mendojmë që mbi faljen, domethënë për marrjen e vendimit për faljen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, duhet t'iu kushtohet kujdes i veçantë kriterëve, ajo çka është më kryesorja, kriterëve për dhënien e faljes, pasi që me ligj dhe me Kushtetutë sipas nenit 84 pika 29 Presidenti do ta ketë këtë autoritet ekzekutiv.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar me kujdes dhe e mbështet edhe pse, ndoshta, ka mundur edhe më përpara të vijë në Parlament dhe do të angazhohet maksimalisht në komisionin funksional të japë kontributin e vet që sa më shpejt ligji të kalojë nga procedurat e Kuvendit. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar Aleanca Kosova e Re, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Besoj që me padurim të madh është pritur shqyrtimi i këtij projektligji nga ana e opinionit kosovar, në veçanti nga ana e atyre që sot janë në vuajtje të dënimit, e që besoj se një pjesë mjaft e madhe e tyre dhe në këto momente e përcjellin punën e Kuvendit të Kosovës sa i përket këtij ligji.

Jam shumë i vetëdijshëm për nevojën që ka pasur dhe ka Kosova për një ligj të tillë, duke pasur parasysh po ashtu edhe shumë padrejtësi të cilat kanë ndodhur ndaj të burgosurve pas vitit '99 e këndej, sidomos me pamundësinë e tyre për t'i realizuar të drejtat të cilat

kanë qenë të parapara në të kaluarën për lirim me kusht dhe në të gjithë e dimë se tek vitin e fundit ka filluar që të zbatohet kjo e drejtë e tyre.

Për fat të keq, ligji sanksionon dhe nuk parasheh përfitim të gjitha kategorive të të burgosurve që të përfitojnë nga mundësia e Presidentit që t'i falë, por një ligj i tillë është i domosdoshëm për shkak të disa arsyeve.

Në radhë të parë sistemi i drejtësisë në Kosovë, po pajtohemi të gjithë, ka qenë shkelësi më i madh i të drejtave të njeriut.

Së dyti, po ashtu, një numër mjaft i madh i të dënuarve kanë paraqitur kërkesat e kahershme me plotësim të kriterëve për t'u liruar me kusht, qoftë me $\frac{1}{2}$, qoftë me $\frac{3}{4}$.

Së treti po ashtu ne kemi pasur pakënaqësi të shumta në burgjet e Kosovës, po ju përkujtoj kolegë të nderuar, se në shtatorin e vitit 2003 kemi pasur një tragjedi në Burgun e Dubravës nga e cila kanë pësuar 5 të burgosur që, për fat të keq, askush sot e kësaj dite nuk ka dhënë përgjegjësi.

Grupi Parlamentar i AKR-së është në favor të nxjerrjes së këtij ligji me procedura të përshpejtuara, megjithatë vërejtjet që i paraqitën kolegët sikurse që po ashtu do të sugjeroni Presidentin e Republikës, pasi që është për herë të parë falja, që t'i ketë parasysh sidomos ata të cilët kanë kaluar $\frac{1}{2}$ e vuajtjes së dënimit dhe $\frac{3}{4}$ e vuajtjes së dënimit, të cilët edhe ashtu i plotësojnë kushtet edhe në mbështetje të Ligjit penal, të Procedurës Penale, por edhe të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, që të lirohen, sikurse që kërkojmë që të precizohen kriteret për të pamundësuar parregullsitë e mundshme të cilat mund të jenë të pranishme.

Në emër të Grupit Parlamentar kërkoj dhe sugjeroj që ky ligj të miratohet me procedura të përshpejtuara për shkak të pritjeve të mëdha që janë edhe ashtu të vëllimit të vogël të ligjit. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Makolli!

Nga Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, flet deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Fillimisht dua të them se edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë në parim këtë ligj. Mendojmë se ka qenë i nevojshëm hartimi i këtij ligji dhe janë të qarta edhe arsyet politike në kuptimin pozitiv të fjalës. Sidoqoftë, mendojmë se ligji ka disa mangësi të cilat duhet të përmirësohen në komisione para se të vijë në leximin e dytë, pra ka disa çështje të cilat duhet të adresohen atje.

Një çështje e cila duhet të gjendet si zgjidhje, ne mendojmë se është çështja e kufizimit të mundësisë së kërimit të faljes të atyre të cilët kërkojnë që të falen për shkak se nuk do të ishte logjikë në rregull që t'i kufizohet Presidentit mundësia e faljes. Mund të rregullohet përmes këtij ligji çështja se kush ka të drejtë të kërkojë falje, fillimisht, pas sa kohe të vuajtjes së dënimit ka të drejtë të kërkojë falje, për të cilat vepra penale nuk mund të kërkojë falje, për shkak se kemi vepra penale, shembull ta marrim, ne mendojmë se nëse një zyrtar i shtetit dënohet për korrupsion, ne mendojmë se Presidenti i Kosovës nuk duhet ta falë dhe, kushtimisht, për të mos ia ndaluar Presidentit që ta falë, ne duhet t'ia ndalojmë atij që është dënuar për keqmenaxhim ose keqpërdorim të fondeve publike, t'ia ndalojmë që të kërkojë falje, për shembull.

Një çështje tjetër është se në ligj ka edhe shpjegime metaforike ekzakt për shkak se nuk është gjetur kjo metoda e pengimit të kërkesës për falje, për shembull, shpjegimet metaforike janë raste të rralla. Tani kur dikujt i jepet mundësia, ne nuk mundemi me fjalën “e rrallë” ose “e shpeshtë” t’ia kufizojmë se a do të jetë rrallë apo shpesh që Presidenti do ta përdorë këtë të drejtë të veten.

Çështja tjetër pse duhet të ketë kufizime është se, duke e ditur situatën në të cilën gjendemi, duke ditur konstelacionin e forcave, ne kemi frikë se Presidentit do t’i mbushet tavolina me kërkesat për falje shumë shpejt dhe atëherë do të shkaktojmë pak tollovi në njërin prej institucioneve më të rëndësishme të shtetit, do të ketë edhe ndikime politike, e tjera, e tjera, kështu që mendojmë se do të mund të shkaktojmë më tepër dëm se sa dobi në këtë rast.

Çështja e kohës - vuajtjes së dënimit prapë mendojmë se duhet të diskutohet për shkak se ne në Kosovë nuk kemi dënim me vdekje. Në disa vende, falja më së shumti nënkupton faljen prej dënimit kapital, me qenë se ne nuk kemi dënim kapital, atëherë duhet të kemi kritere tjera të cilat parashohin elemente se në cilat raste dhe në cilat mundësi dikush e fiton të drejtën për të kërkuar falje për shkak se nëse falja do të jetë element i shpeshtë, sidomos tash, do të mund të konceptohet si fyerje ndaj sistemit të drejtësisë ose ndaj pushtetit të drejtësisë.

Dhe, e fundit, ne e kuptojmë se ky ligj duhet që sa më shpejtë të miratohet dhe të nënshkruhet nga Presidenti i Kosovës. Mendojmë se është mirë që është sjellë tani, ka qenë dashur të sillet edhe më herët. Mirëpo, kur i jepet kuptim një ligji me procedurë të përsheptuar, atëherë lihet përshtypja se ligji po përsheptohet për dikën specifik. Ne e dimë se nuk është ashtu, mirëpo nuk guxojmë të lëmë përshtypje se dikujt po i ngutet ta miratojë një ligj, i cili është tepër i rëndësishëm, i cili do të ketë efekt në jetën dhe vazhdimësinë e jetës të shumë njerëzve.

Sidoqoftë, edhe një herë ta përsëris, do ta përkrahim në parim ligjin dhe do të tentojmë që të jemi sa më të vëmendshëm gjatë shqyrtimit të tij në punën nëpër komisione. Faleminderit!

KRYESUESI: Dëgjuam shefin e Grupit Parlamentar të AAK-së.
Për Lidhjen Demokratike e Dardanisë, flet deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryesues!
Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së do t’i them disa fjalë lidhur me Projektligjin

për falje. Së pari dëshiroj ta gjejme mënyrën dhe ta dimë më saktësisht se a kanë apo jo vendet e Bashkimit Evropian ligj si ky. Në sqarimin që është dhënë nga Agjencia për Integrim Evropian thuhet se lëmi në fjalë nuk është i rregulluar me legjislacionin e BE-së, që mund të nënkuptojmë se BE-ja nuk ka legjislacion që e rregullon këtë çështje. Nëse BE-ja nuk ka, mendoj se nuk është mirë ta kemi as ne, meqë në Kushtetutë e kemi këtë, atëherë duhet ta diskutojmë.

S dyti, dëshiroj t’i komentoj disa nene të këtij ligji. Neni 3, pika 2 dhe 3 thotë se Presidenti mund ta lirojë të dënuarin nga të gjitha dënimet që i janë ngarkuar, duke përfshirë burgosjen, masat mbrojtëse, gjobat dhe çdo lloj dënimi të shqiptuar nga gjykata, duke i ofruar të dënuarit rehabilitim të menjëhershëm. Nga kjo, ne mund ta

kuptojmë se Presidenti i Republikës së Kosovës mund ta lirojë çdo të dënuar nga çdo dënim, po e zëmë, edhe atë që është i dënuar 40 vjet, dhe mendoj se jo i tejkalon shumëfishë kompetencat e një presidenti të Republikës, e shpesh mund të themi që ndoshta edhe për një mbret do të ishte tepër, e jo për një president të Republikës. Në këtë kuptim ne duhet t'i kufizojmë mundësitë e presidentit që t'i lirojë të gjithë të dënuarit nga të gjitha dënimet dhe mendoj se është mirë që të kufizohet kjo mundësi në një përqindje të caktuar të falje së dënimit e jo të dënimit në tërësi dhe rehabilitimin e tij të menjëhershëm.

Ne e dimë që në çështjet që merren me të burgosurit, ka organe të ndryshme që merren edhe me lirimin me kusht, me zbutje të dënimit etj. etj. dhe mendoj që edhe atyre duhet, këto mundësi duhet të koordinohen edhe me Presidentin e Republikës.

Në fund, dëshiroj ta theksoj edhe një fakt. Ne e dimë se para disa kohësh ka qenë një grevë e të burgosurve në Dubravë. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka bërë një vizitë atje dhe ata me këmbëngulje kanë pyetur se kur do të miratohet Ligji për amnistinë kolektive, sepse thonë se i ka premtuar Presidenti dhe ministrja e Drejtësisë, dhe ne e dimë se këto premtime kanë qenë publike. Prandaj, me këtë rast ata presin shumë që mos të ndodhë diçka që nuk është mirë të ndodhë, edhe ministrja edhe Presidenti është mirë të japin sqarime lidhur me këtë çështje. Ju faleminderit.

KRYESUESI: E dëgjuam përfaqësuesin e LDD-së, tash besoj për Grupin "7+", Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući! Dozvolite da i ja pozdravim predstavnike Vlade i kolege predstavnike Skupštine!

I mi smo pažljivo razmotrili ovaj Zakon i nas pomalo iznenadjuje da ova oblast nije regulisana evropskim zakonodavstvom, a radi se o zamljama sa dugom demokratskom tradicijom, kao i o zakonu koji ima elemente i humane oblasti. S obzirom na to da sam jedan od članova i Komisije za zakonodavstvo i da smo kao i prethodne kolege obišli čitav kompleks Dubrave i upoznali smo se sa najraznovrsnijim slučajevima odsluživanja kazni i da se radi o oblasti kojoj ne cvetaju baš ruže u javnosti Kosova kada govorimo o pravosuđu. Ja delim mišljenje prethodnog sagovornika, odnosno analitičara izlagača o ovom zakonu da zatvorenici u Dubravi, mi znamo da je u pitanju 650 ljudi, gde je zaposleno skoro isto toliko ljudi koji brine o njima, sa velikim ali baš sa velikim nestrpljenjem očekuju kada će biti usvojen i ovaj zakon, kao i Zakon o amnestiji.

Na svakom koraku su bila pitanja, a imali smo priliku da razgovaramo sa zatvorenicima i u pratnji predstavnika koji ih čuvaju, vode računa o njima, ali smo imali povremeno priliku da razgovaramo i bez njihovog prisustva. Svi su se u glas interesovali i sa velikim nestrpljenjem očekuju maltene donošenje i usvajanje ovog zakona kao vrstu nekog kolektivnog pomilovanja i zaista je to bilo začudjujuće.

Ako je to mera da se isprave nepravda, a takvih ima sigurno u izricanju kazni, mi podržavamo u načelu ovaj zakon, ali ako mu prethodi zaista čitav taj kompleks zakonske procedure koja može da potvrdi određene pogrešne zaključke, možda pogrešno donete odluke, ili ako je to prilika nakon odsluženja polovice ili dve trećine kazne, a neko je zaista sebe prikazao u najboljem svetlu, jel da, pokazujući sebe kao pozitivnu ličnost, kao čoveka koji se iskreno kaje i tako dalje, i tako dalje.

Mi u naçelu prihvatamo usvajanje ovog zakona i po modelu, kako je rekao i predsednik Komisije. Medjutim, ja çu reçi da zakon u varianti jezika, kako srpskohrvatska ili bosanska varianta je izuzetno, izuzetno loše obradjena. Imate toliko materijalnih grešaka gde se zakon naziva često Zakon o žaljenju. Zamislite, to uopšte ne odgovara izrazu o pomilovanju. Zakon, ne znam, još neka druga imena, i tako dalje. Ja bih molio da se u daljoj proceduri obrati pažnja stručnog lektorisanja, ne bukvalnog prevodjenja, nego stručnog zakonskog lektorisanja ovog zakona kako bismo mogli u daljoj proceduri još jednom da se izjasnimo da li ga prihvatamo ili ne. Toliko. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! SLS, s'ka.
Deputetja Sanije Alijaj.

SANIJE ALIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!
I nderuar kryesues i kësaj seance plenare,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Shqyrtimi në parim i Projektligjin për falje është i rëndësishëm, sepse plotëson infrastrukturën ligjore edhe me një ligj, i cili përcakton kompetencat e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me materien që trajtohet në këtë Projektligj.

Projektligji është i rëndësishëm për të gjitha vendet demokratike, të gjitha shtetet demokratike, sepse jo rrallë në praktikat gjyqësore ndodhë që për veprat penale të rënda të pësojnë personat të cilët ndonjëherë janë edhe të pafajshëm.

Rregullat e këtij Projektligji për faljen i mundësojnë Presidentit të Kosovës të nxjerrë dekretin si mjet jo të rregullt, e të rrallë, për t'i korrigjuar padrejtësitë që bëhen ndaj individëve.

Projektligji ka karakter edhe humanitar, sepse për falje shpërblehen karakteret e jashtëzakonshme, duke i rehabilituar në mënyrë të menjëhershme, të plotë, dhe këtë e bën pas grumbullimit të fakteve nga mekanizmat përkatës.

Në nenin 5, i cili rregullon kriteret për falje, sugjeroj që të plotësohet edhe me një kriter, rrethanat e krimit të krijuar, kurse kriteri 2.3 pendimi i sinqertë, mendoj se në disa raste vështirëson mundësinë e plotësimit të këtij kriteri kur kemi të bëjmë me karakteret e jashtëzakonshme, e nuk e ka kryer krimin, si të pengohet sinqerisht? Propozoj me këtë rast që gjatë procedimit në komisionet parlamentare, të kihet kujdes gjatë përcaktimit të këtyre kriterëve.

Në nenin 6, paraqitja e kërkesës, i cili rregullon, përcakton rregullat se kush mund të bëjë kërkesë për falje, mendoj se duhet shtuar edhe një paragraf se pas cilit afat i dënuari apo qytetari i cili e vuan dënimin, mund t'i drejtohet Presidentit të Republikës së Kosovës me kërkesë për falje.

Projektligjin e përkrah në parim dhe me një shpresë që ky do të amendohet dhe të bëhet një ligj i ri, i cili mundëson faljet e qytetarëve të cilët vuajnë dënimin. E përkrah edhe faktin sepse nuk ka implikime buxhetore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kolegu Eqerm Kryeziu!

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zotëri kryesues! Jam shumë i lumtur që shumë shpejt më erdhi radha, do të thotë s'ka edhe të tjerë duke pritur. Më lejoni t'ju them që, me sa kuptoj unë, ky ligj do të duhej të ishte për përdëllim, jo për falje, nëse unë di gjë, e tash çështje tjetër është, do të thotë Ligji për përdëllim, jo për falje, e para. E dyta, unë do ta përkrah fuqimisht këtë Projektligj, por me njëfarë lloj shprese, nuk po mund të them të venitur, por madje shumë të bindur se do të ruhet ajo linja delikate ndërmjet viktimës dhe atij tjetrit. Mos të na ndodhë që viktimat të jenë gjithmonë viktima, ndërkaq këta të tjerët të përdëllohen vazhdimisht.

Në këtë kuadër, unë e çmoj shumë të rëndësishëm këtë projektligj, por më tepër i kam parasysh rrethanat e të burgosurit jashtë burgut se sa brenda, do të thotë sa keq e ka lënë familjen, natyrisht edhe sjellja e tjera, e tjera. Përndryshe, edhe unë pajtohem se ky nuk është, përdëllimi nuk është kategori ligjore, kjo është një akt tjetër që i takon Presidentit të Kosovës, dhe me të vërtetë, sa civilizuese edhe humane, aq është edhe delikate. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Kryeziu! S'ke të drejtë, ka edhe të tjerë që flasin, se mendove që po ta jap fjalën se je i fundit, nuk je. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues! Do të kisha falënderuar edhe më shumë sikur të isha paralajmëruar se do të jem në radhë. Le të paralajmërohen të tjerët, së paku!

KRYESUESI: Më fal Hydajet, atëherë në radhë pas teje janë, veç një moment, Riza Smaka, Gani Buçinca, Shkumbin Demalijaj, Ibrahim Makolli, mbani në mend!

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit!

Zoti kryesues,

Të nderuar ministra, e nderuar ministre,

Zonja e zotërinj deputetë,

E përshëndes dhe e mbështes sjelljen e këtij Projektligji në Kuvend. Dua ta theksoj edhe përshtypjen që ky Ligj po vjen me vonesë, kurse tani vjen me kërkesë që të procedohet në mënyrë të përshpejtuar. Kur vonohemi, pastaj duhet edhe të përshpejtohem. Druaj që gabojmë në të dy rastet.

Për më tepër, ky ligj është punuar nga Ministria e Drejtësisë, që është e pritshme të na sjell një ligj të përsosur, aq më tepër që është një ligj i vogël në vëllim, do të duhej të ishte edhe i punuar me pedanterinë që u shkon juristëve dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Për fat të keq, nuk ndodhë kjo. Që në titull, siç u theksua edhe nga parafolësit, kemi një paqartësi. Është Ligji për faljen, në shqip, pardon anglisht, është përkthyer, kurse në serbisht, herë žaljenje, herë pomilovanje. Secili e di që te dyja këto nuk mund të qëndrojnë në një ligj, nuk kanë kuptim, prandaj edhe krijohet teren tash për të luajtur lojë fjalësh, a është përdëllim, a është njëfarë mëshirimi apo njëfarë gjynahu, por ama Ligji që është premtuar, mungon. Nuk kemi ligj për instrumentin juridik të faljes, të amnistisë, të abolimit, të lirimit e lehtësimit të burgut, kurse është premtuar kjo, qytetarët presin diçka të tillë, zonja e zotërinj.

Për më tepër, nëse e vëreni, e lexoni me vëmendje, që në preambulën e Ligjit është kërkuar që me këtë Ligj të sigurohet një bazë ligjore për përcaktimin e një trupi të

autorizuar për dhënien e faljes, madje për përcaktimin e formave të faljes. Disa forma të faljes, por në të vërtetë në ligj ka vetëm një falje individuale, por kjo e formave të faljes mungon në variantin anglisht e serbisht. Cilin duhet ta marrim si shkronjë të Ligjit?

Në pikën vijuese, ku flitet për rëndësinë e Projektligjit, thuhet se Projektligji ka rëndësi të veçantë, sepse me dekret rregullon këtë e këtë. Kjo me dekret, në variantet në anglisht e serbisht, po ashtu, mungon.

E theksuan parafolësit edhe faktin që ka një kolizion me shkronjën e Kushtetutës. Ajo që është kompetencë e Presidentit në Kushtetutë, as nuk mund t'i atribuohet, t'i derivohet me Ligj, as nuk mund t'i kontestohet, prandaj mendoj që është vërtet pa precedencë edhe kjo gjuhë juridike në një ligj që, po e përsëris, është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë.

Për më tepër, në nenin 3, ky pushtet i veçantë që iu dhënka Presidentit me ligj, kurse i është dhënë me Kushtetutë, është për të korrigjuar padrejtësitë e dukshme. Vini re, Presidenti ka mundësinë për të korrigjuar padrejtësitë e dukshme të Gjyqësorit. Çka ndodhë atëherë me ndarjen e pushteteve dhe me pavarësinë e Gjyqësorit, janë notore, janë elementare.

Çështja e faljes, e amnistisë, e abolimit, nuk është vetëm kompetencë e Presidentit. Nëse në Kushtetutën tonë nuk janë paraparë edhe mundësi të tjera, megjithatë në praktikën ndërkombëtare është diçka që nuk mund të kontestohet, prandaj edhe nuk mund të bëhemi rob ndonjëherë të mangësive që vet i kemi prodhuar.

Mendoj që ky Ligj duhet të mbështetet, por duhet edhe të përpunohet dhe ne duhet t'i japim përgjigje kërkesave të kohës që Kosova, siç kanë pasur vendet e tjera dhe kanë vendet në tranzicion, sidomos, të ketë Ligjin për amnistinë dhe për atë për amnisti të përgjithshme ose të pjesërishtme.

Vendet që kanë kaluar situata si kjo e Kosovës, që kanë pësuar kthesa të forta, që janë bërë shtete, që kanë pasur luftëra dhe janë në situatë pasluftë tash, pas konflikti zakonisht përballen me detyra të tilla dhe kjo është ajo që kërkon kohë. Edhe falje, edhe amnisti, edhe abonim, edhe lirim me kusht, natyrisht me secilën kategori. Për më tepër, unë ju kujtoj edhe njëherë se edhe me dokumentin e Rambujesë, të cilit i referohet edhe Kushtetuta jonë, do të thotë na obligon, ne jemi obliguar që të krijojmë kushtet për amnisti për të gjithë ata që meritojnë.

Zonja e zotërinj,

Ju jeni dëshmitarë se gjatë viteve që kanë kaluar, ka ndodhur edhe fenomeni i dënimi të shumë njerëzve edhe pa arsye të mjaftueshme. Janë mbajtur me vite të tëra njerëzit pa vendime gjyqësore dhe janë dënuar pa fakte. Shumë prej tyre janë liruar. Ne nuk kemi krijuar kushte që ata të trajtohen në mënyrën e duhur. Mendoj se institucionet e Kosovës duhet të kenë edhe kapacitetet që të përballen, ta shtrojnë dhe pa e kontestuar këtë ligj, të plotësohet me ato që i mungojnë, do të thotë me dimensionin, me instrumentin e amnistisë, të abolimit, të lirit me kusht, e tjera.

Fakti që Kosova ka shpallur pavarësinë, është një arsye plus që të hyjmë në një ndërmarrje të tillë, e cila do të ketë vetëm efekte pozitive. Unë jam i bindur se kjo do të krijojë edhe më shumë respekt për institucionet dhe Gjyqësorin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Se ka nevojë për këtë ligj, ka nevojë patjetër. Unë e kam pasur një oportunitet me anëtarët e Komisionit për Legjislacion të vizitojmë Dubravën. Përpos të tjerave, atje kemi konstatuar, siç vijon: ka shumë persona në vuajtjen e dënimeve pa aktgjykim të formës së prerë, që nuk mund të ndodhë as në një vend qoftë më i prapambeturi në këtë globus. Aktgjykimi që nuk e ka formën e prerë, vetëm është një hipotezë e rrëzueshme, *presumptio legis tantum*, do me thënë, nuk ekziston, nuk është bazë për t'u burgosur e për t'u mbajtur në vuajtje të dënimit. Por, me këtë nuk do ta absolvohet ajo dhe, u thanë disa me vend, që do të duhej edhe për amnisti, por Kushtetuta nuk e ka përcaktuar vetëm faljen.

Edhe te përdëllimi, ju lutem, do të ishte e pranueshme, po e zëmë, apo për t'u diskutuar, po pikërisht te neni 1, gabimisht është thënë - dhënia e faljes, për shkak se në Kushtetutë thuhet, në nenin 84, në paragrafin 29, thotë: Kryetari shpall falje, që gjithsesi është shprehje e gabueshme, ama është inkluduar dhe miratuar në Kushtetutë. Kur Kryetari do të shpallte falje, do të delte se Kryetari nuk jep falje, nuk lejon, nuk miraton, por se dikush tjetër, po e zëmë, Kuvendi e vetëm e bën promulgacioni, shpalljen, që nuk është ajo, se drejtpërdrejtë kryetari e jep, e lejon, e miraton shpalljen.

Ju lutem, teksti i këtij Ligji në të tri gjuhët është shumë i dobët, tepër i dobët. Po ta lexojmë vetëm hyrjen, është krejtësisht e paqartë dhe nuk ia vlen për t'u lexuar, por duhet të riformulohet krejtësisht. Më pastaj, ju lutem, vetëm ta lexoj nenin 1 në serbisht-boshnjakisht, thotë: "ovaj zakon pokazuje zakon – ky ligj tregon ligj, koji odredjuje pravde, që i cakton të drjetat, koji predsednik davanje, dajanje. Ky ligj duhet të ripërpunohet me një seriozitet të madh, se ndryshe do të ishte tepër qesharak.

Te neni 3, ekziston një aline që kryetari, që nuk është gjyqësor, jep autorizime, praktikisht për të gjykuar, që nuk është e drejtë, kur thuhet, po e zëmë, për të korrigjuar padrejtësitë e dukshme. Kryetari me falje nuk i korrigjon padrejtësitë, po në kontekstin e rrethanave e të sjelljeve e vlerëson sipas diskrecionit, bazën, edhe e lejon apo nuk e lejon faljen. Nuk është fjala për eliminimin, për korrigjimin e padrejtësive. Ajo do të mund të bëhej vetëm në procedurën gjyqësore. Bie fjala, prokurori i shtetit sikundër të kishte vlerësuar, do të ngrehte kërkesë të jashtëzakonshme për mbrojtjen e ligjshmërisë apo për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe, Gjykata Supreme, në qoftë se duhet ta miratonte, me atë do të bëhej korrigjimi, e jo me aktin e faljes.

Më pastaj, do shprehje që nuk janë të tolerueshme për juridik. Nuk shqiptohet dënimi as masa, as falja. Ajo caktohet, ju lutem, as nuk ofrohet, se nuk është fjala për ofertën e kontratës...

KRYESUESI: Këto në lexim të dytë, ju lutem, parimisht, nenat, lëri nenet tash!

RIZA SMAKA: ...Neni 5, parimisht, kriteret të cilat shqyrtohen gjatë marrjes së vendimit mbi faljen, caktohen nga Presidenti. Nuk mund të pranohet në parim, sepse do të dilte se Kryetari do të bënte një ligj tjetër, do të caktonte kritere që do të ishin kritere të karakterit ligjor, por duhet kritere të caktohen me ligj, e jo me akt e me shpjegime e me interpretime se do të ishte non-sens. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Unë nuk sugjeroj asgjë, vetëm se është njëfarë kulture parlamentare që kur shefi i Grupit thotë, padyshim e përkrahim, të tjerët të qesin pikëpyetje! Po them, ekziston një kulturë e tillë në të gjitha parlamentet. Pa marrë parasysh, ju e keni të drejtën tuaj. Gani Buçinca e ka fjalën!

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Më kujtohet që edhe para do kohe e kemi pasur një debat në lidhje me gjendjen e të burgosurve tanë këtu në Kosovë dhe e kemi shtruar si nevojë që kjo çështje të rregullohet me Ligj.

Unë e përshëndes Qeverinë, përkatësisht ministrinë përkatëse që na ka sjellë në Kuvend në ligj të tillë për miratim, mirëpo t'ju them të drejtën, jam shumë i zhgënjyer me nivelin profesional të ligjit në përgjithësi, pa dashur t'i përmend, se u ... gati në tërësi ato vërejtje të cilat janë në ligj. Unë mendoj se Ligji nuk duhet të aprovohet me procedurë të përshpejtuar, por me procedurë të rregullt dhe ekspertët këtu në Kuvend, në komisione të punojnë mirë, duke i shqyrtuar edhe praktikat e shteteve në rajon. Nuk ka nevojë të mundohemi ne e të shkruajmë një ligj origjinal, një ligj i cili i përshtatet institucionit të Presidentit, për të bërë Presidentin si një figurë e cila jep, shpërndanë sheqerka dhe dhurata për të burgosur politikë, por duhet të shikojmë mirë si janë praktikat në rajon dhe më gjerë dhe mos të mundohemi dhe të lodhemi kaq shumë për gjëra të cilat popujt tjerë i kanë rregulluar para nesh dhe nuk duhet humbur shumë kohë.

Ligjet askund në botë nuk kanë konotacione shkencore, as kushtetutat, dhe kudo që të marrësh, nuk ke kurrfarë, nuk bën shkelje të të drejtave autoriale. Mjafton vetëm ta citosh burimin ku e ke marrë dhe nuk ke kurrfarë detyrimi tjetër. Këto gjëra, popujt në rajon, shtetet në rajon i kanë tejkaluar dhe i kanë të rregulluara shumë mirë dhe ne duhet të shfrytëzojmë. Kurse, unë mund t'ju them se ky ligj po vjen me një vonesë të konsiderueshme në parlament. Ne, për këtë kategori të qytetarëve tanë, të cilët në rrethana të caktuara kanë bërë vepra penale dhe janë nëpër burgje, ne duhet të përkujdesemi shumë më shumë se që jemi përkujdesur deri më tani, sidomos shumë më shumë se që është përkujdesur Administrata e UNMIK-ut. Administrata e UNMIK-ut, për fat të keq, ka bërë shkelje flagrante të të drejtave të burgosurve në Kosovë dhe ne nuk duhet të tolerojmë që mbi disa padrejtësi që janë bërë gjatë periudhës së Administratës së UNMIK-ut, të krijohen padrejtësi të reja.

Mirëpo, edhe gjatë procesit të amnistisë, ose të abonimit, ose të faljes, ose si ta quajmë, duhet të kemi shumë kujdes që në ligj, në dispozitat ligjore të përcaktohen mirë se mos po bëjmë prapë padrejtësi të tjera gjatë procesit të faljes. Do të shikojmë shumë mirë dhe duhet të jemi shumë më të përgjegjshëm. Ky ligj, edhe pse është i domosdoshëm, është mjaft delikat dhe duhet të trajtohet me shumë vëmendje dhe me shumë përgjegjësi edhe morale, edhe politike, edhe juridike, edhe profesionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Buçinca! Shkumbin Demalijaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë kolegë,

Të nderuar pjesëtarë të Kabinetit qeveritar,

Për përcaktimin tonë si grup parlamentar, e tha fjalën zoti Makolli, si shef i Grupit. Mirëpo, edhe ne të gjithë, si deputet të këtij grupi, bazohemi në atë çka e tha shefi i Grupit Parlamentar. Por, te mundësia e shqyrtimit të dytë të projektligjeve, deputetët nuk po kanë kohën e duhur dhe, me të drejtë, me Rregulloren u ndalohej, por duhet përcaktimi i shefave të grupeve dhe nuk po mundemi t'i shqyrtojmë vetëm ato amendamente që po rrjedhin nga komisionet profesionale parlamentare. Kështu që, i kisha lutur të gjithë deputetët që në kuadër të këtyre dispozitave që sot janë ofruar në Projektligjin për faljen, ta marrin secili fjalën, jo vetëm për atë që neve si shoqëri kemi pasur nevojë edhe e dimë se është e cunguar me dispozitat kushtetuese, mirëpo ka lënë këtë hapësirë që përpos Ligjit për amnisti, të nxirret edhe ky Ligj për faljen, që sot para nesh e kemi si projektligj. Mirëpo, e kisha lutur komisionin funksional që gjatë shqyrtimit dhe amendimit të tij, të përcaktojë shumë mirë kriteret se kush janë ata persona të dënuar që duhet të falen, të shqyrtohet mirë e kaluara e tyre kriminale dhe sa janë të rrezikshëm ata për shoqërinë pas faljes, sepse neve kemi me qindra njerëz që sot vuajnë në burgjet e Kosovës edhe nuk janë të rrezikshëm për shoqërinë kosovare dhe ata sot padrejtësisht vuajnë burgun në mungesë të një projektligji të tillë. Kështu, vetëm të shqyrtohen ato kritere dhe të përcaktohen mirë dispozitat. Jam për të gjitha vërejtjet që i dhanë kolegët më herët, kështu që duke ju përshëndetur, zotëri kryesues, po e ndërpres fjalën time. Ju faleminderit !

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Shkumbin Demalijaj! I fundit është Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zotëri Kryesues!

Është e vërtetë, kam folur njëherë, kam folur në cilësinë e shefit të Grupit Parlamentar, që konsideroj se nuk ma mohon të drejtën edhe mua, si deputet i këtij Kuvendi, që të paraqes edhe mendimet e mia individuale. Po ashtu, t'ju përkujtoj se Parlamenti i Kosovës nuk punon vetëm përmes shefave të grupeve parlamentare, prandaj duhet t'i jepet e drejta secilit deputet që të paraqes qëndrimet e veta.

Është një arsye shumë e madhe që ky Ligj, përkundër atyre që menduan se nuk do të duhej të shkojë me procedurë të shpejtë, të shkojë me procedura të shpejta, të përshpejtuara. E dini shumë mirë dhe për çdo ditë lexojmë gazeta ose kemi edhe kërkesa të organizatave për të drejta të njeriut që kërkojnë nxjerrjen e këtij ligji në afatin sa më të shpejtë kohor për shkak të paralajmërimeve të të burgosurve se mund të hyjnë në greva të ndryshme. Ju e dini që kohëve të fundit kemi pasur përpjekje për të hyrë në grevë të të burgosurve, prandaj do të duhej dhe është shumë e nevojshme që ky ligj të shkojë me procedura të përshpejtuara.

E dyta, është se në Kosovë edhe më tutje nuk po zbatohen dënimet alternative. Pothuaj se sikur në shëndetësi, që secili që kërkon nevojën e mjekut, i jepet një andoll, po ashtu edhe në sistemin e drejtësisë të gjithë ata që ofrohen para gjykatave, së paku kanë nga dy vjet burg, ndërkaq në asnjë moment, në asnjë rast nuk janë në zbatim dënimet alternative, të cilat i parashihet Ligji, i parashohin ligjet e Kosovës.

E treta, unë besoj se e dini shumë mirë se një numër mjaft i madh i të burgosurve në Kosovë gjatë këtyre viteve padrejtësisht kanë qëndruar në burgje me muaj dhe vite të tëra dhe pastaj janë liruar si të pafajshëm. Prandaj, kjo është një mundësi shumë e mirë që të bëhen këto përmirësime dhe korrigjime nga ana e këtyre, por po ashtu, po e shfrytëzoj rastin që të kërkoj nga ky Parlament dhe ministrja e Drejtësisë që të

detyrohen gjykatat e Kosovës që të fusin në zbatim dënimet alternative dhe në këtë formë do të lehtësohej edhe Buxheti i Kosovës. E di që kjo nuk është kompetencë e drejtpërdrejtë e Ministrisë, por megjithatë Ministria e Drejtësisë do të duhej që të përkujdesej për zbatimin e Ligjit në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Veç një moment. Buçinca, ke folur një herë, ke folur një herë, asnjë minutë, nëse..., atëherë të gjithë e kanë atë të drejtë. Për një materie ke folur një herë, askush nuk është marrë me ty. Kaq!

Fjalën e merr ministrja Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Të nderuar deputetë,
Unë nuk pretendoj se ky ligj është i përsosur, prandaj edhe bëhet leximi i parë me qëllim që në fazat e mëtejshme të amendohet.

Unë dëgjova këtu shumë vërejtje, komente e tjera, e tjera. Siç e keni vërejtur, ligji këtu e rregullon kërkesën individuale për falje, e jo numrin e pacaktuar të personave. Këtu është edhe dallimi midis Ligjit për amnistinë dhe Ligjit për faljen, sepse Ligji për amnistinë, numrit të pacaktuar të personave u jepet amnistia, kurse Ligji për faljen bëhet me kërkesë individuale.

U përmendën edhe cilat kategori, kush duhet, të cilët të dënuar, a me dënime afatgjata apo afatshkurtra, e tjera kush duhet të përfshihet me falje. Nuk duhet diskriminuar të burgosurit. Të gjithë kanë të drejtë të kërkojnë për dhënien e faljes, ndërkaq që është e drejtë diskrecionale e Presidentit të Kosovës se cilët persona apo cilët individë do t'i falë.

Këtu u ngatërruan edhe disa kategori të së drejtës ndërkombëtare, siç është: abolimi apo abolicioni, pastaj pse nuk lirohen me dy të tretat ose një të dytën. Çështja e lirimit me kusht, të gjitha këto, dy të tretat dhe një e dyta, janë kategori që janë të rregulluara me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe ka ndodhur në të kaluarën që ka pasur lirime me kusht pas mbajtjes së gjysmës së dënimit edhe atë mbi 400 të burgosur janë liruar. Sa i përket shqiptimit të masave alternative në vendimmarrje, nëse ne si Parlament, si Qeveri, si individ apo si ndonjë institucion tjetër i pavarur, u përzihemi gjykatave, atëherë ne besoni e kemi cenuar pavarësinë e Gjyqësorit si një ndër parimet më të rëndësishme që është për funksionimin e Gjyqësorit, e që Kushtetuta e parasheh, duhet të jetë i paanshëm, pa ndikim, e tjera, e tjera. Kjo do të ishte tërë ajo që pata për ta sqaruar.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja ministre!

E thërras regjinë, i thërras deputetët të bëhen gati që të votojmë në parim Ligjin për falje.

Votojmë, tash:

“Për” kanë votuar 56, 2 “kundër”, 4 kanë abstenuar, edhe një “për”. Pra, 58 “për”, 2 “kundër”, 4 abstenime, kalon në leximin e parë Projektligji për falje.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi i ngarkon këto komisione tutje të merren me Projektligjin:

- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues;
- Komisioni për Buxhet dhe Financa;
- Komisioni për Komunitete dhe

-Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që, në propozimin e Qeverisë, ta përshpejtojnë procedurën e shqyrtimit të këtij Projektligjit.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Në bazë të Rregullës 35,1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij Projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin Manaj, që ta paraqet Projektligjin para deputetëve.

RAMË MANAJ: I nderuari kryesues i seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Në emër të Ministrisë së Drejtësisë, paraqes për miratim në parim, para këtij Kuvendi Projektligjin për mjekësinë ligjore. Ky Projektligj është fryt i punës dhe përkushtimit të kësaj Ministrie për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj.

Duhet të theksoj se dispozitat e këtij Projektligji janë në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe të shteteve më të zhvilluara, për çka flet edhe deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, lëshuar nga Agjencioni për Integritet Evropian.

Në gjendjen shumë delikate sa i përket fushës së mjekësisë ligjore, në Republikën e Kosovës kemi pasur shumë vështirësi për shkak të ekzistimit në mënyrë paralele të Institutit të Mjekësisë Ligjore në njërën anë, i cili ka funksionuar në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, përkatësisht të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Zyrës për Persona të Zhdukur e Mjekësi Ligjore, e themeluar nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut.

Pos tjerash, ky projektligj synon që të bëhet unifikimi i fushës së mjekësisë ligjore në një organ të vetëm në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e cila do të ndikojë në përmirësimin e kushteve dhe të shërbimeve në fushën e mjekësisë ligjore. Po ashtu, me krijimin e këtij departamenti do të bëhet e mundur që të gjithë studentët, të kryejnë pjesën e tyre të punës praktike, në lokalet e tashme të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe të Zyrës për Personat e Zhdukur, e cila ka munguar deri më tani. Projektligji për mjekësi ligjore paraqet jo vetëm një masë ndihmëse, por një domosdoshmëri si për faktin që është ligj i ri dhe modern, po ashtu edhe për faktin se ky ligj është ndërhyrje komplementare dhe e fuqishme në përmirësimin e gjendjes ekzistuese, pa të cilin sot nuk mund të paramendohet sundimi i ligjit as në vendet më të përparuara të botës.

Zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë së bashku me ata të Qeverisë dhe ekspertët ndërkombëtarë në partneritet, përfshirë këtu EULEX-in, Ambasadën Amerikane, USAID-in, ICO, në takimet e përbashkëta kanë punuar për hartimin e këtij draftligji në mënyrën më të mirë dhe më profesionale.

Projektligji për mjekësinë ligjore rregullon strukturën organizative të mjekësisë ligjore në përgjithësi, duke përfshirë menaxhimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e

Departamentit për Mjekësinë Ligjore. Ky Projektligj ka për qëllim që të rregullojë në tërësi objektet e ekspertimit në fushën e mjekësisë ligjore, siç janë: personat, kufomat, provat materiale, materiet e çështjeve hetimore gjyqësore, e tjerë.

Ministria e Drejtësisë tani është duke punuar edhe në hartimin e Projektligjit për autopsitë, i cili po ashtu është i rëndësishëm shumë të madhe dhe planifikohet që brenda këtij viti të kalojë në Qeveri dhe me këtë të plotësohet infrastruktura ligjore në fushën e mjekësisë ligjore, duke ndikuar në parandalimin e kryerjes së mjekimeve të pandërgjegjshme dhe kujdesin më të madh për njerëzit.

Ky Projektligj përcakton parimet themelore dhe krijon mekanizma efikas për kryerjen e të gjitha aktiviteteve në fushën e mjekësisë ligjore, për realizimin të gjitha obligimeve që janë të kërkuara nga organet e hetuesisë dhe drejtësisë.

Fuqizimi i këtij projektligji në ligj është i një rëndësie të veçantë, sepse do të t'i hapte rrugë shtimit të efikasitetit në punën e Prokurorisë dhe Gjyqësorit, në përgjithësi, për zbulimin e veprave të ndryshme penale, gjë e cila do të ndikonte si preventivë si dhe do të shtonte besimin tek qytetarët, jo vetëm në punën e gjykatave, por edhe të prokurorive dhe të shërbimeve mjekësore në përgjithësi. Ky Projektligj nuk është aq voluminoz, përmban gjithsej 11 nene, të cilët paraqesin tërë kompozicionin e Projektligjit, i cili është hartuar duke respektuar edhe teknikat juridike të hartimit të legjislacionit.

I nderuari zotëri kryesues,

Të nderuar deputetë,

Fuqizimi i këtij projektligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe është në interes të përgjithshëm shoqëror të Kosovës, andaj ju propozoj që pas procedurave të shqyrtimit, natyrisht me amendimet e nevojshme, ky Projektligj të miratohet dhe të hapet mundësia e fuqizimit të tij në të ardhmen më të afërt. Ju faleminderit!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Ju faleminderit, zëvendëskryeministër!

Vazhdojmë, sipas radhës, të drejtën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, ndoshta e merr fjalën edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, apo vetëm në emër të Komisionit. Mirë!

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për dallim nga Ligji që paraprakisht e kaluam, në parim, për faljen, Komisioni e ka shqyrtuar edhe Projektligjin për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhe njëzëri ka marrë vendim që këtë Projektligj të mos e aprovojë apo të kërkojë nga Kuvendi që të mos e aprovojë, në parim. Unë po i përmendi shkaqet për çka jemi përcaktuar.

Projektligji ka gjithsej 11 nene dhe nëse merret dhe lexohet shihet se vetëm dy-tre nene flasin jo shumë në përmbajtje, por së paku flasin për qëllimin se për çka është duke u themeluar Departamenti i Mjekësisë Ligjore. Të gjitha nenet tjera flasin për strukturën organizative të Departamentit të Mjekësisë Ligjore që nuk është rrugë dhe e drejtë në asnjë ligj struktura organizative e departamenteve të caktuara bëhet me rregullore të brendshme. Mua më vjen keq që nuk e kemi prezent ministren e Drejtësisë, por po ia filloj prej fillimit.

Nëse e merrni dhe e lexoni qëllimin e ligjit, edhe ky nen nuk e përcakton qartë se për çka është duke u themeluar Departamenti i Mjekësisë Ligjore. A është duke u krijuar si departament i përhershëm, a ka për qëllim që ky Departament vetëm të flas për viktimat e luftës dhe lidhur me luftën.

Neni 2 i Projektligjit flet për përkufizimin, që këtu shkruan definicionet, por rregull është Projektligji të flasë për përkufizimet që nuk janë akte normative dhe këto nuk po ndalen fare të përkufizimet.

Kalojmë në nenin 3, flet për mandatin. Departamenti i mjekësisë ligjore nuk mund të ketë mandat, sepse nuk është organ, por është fjala për përgjegjësitë dhe kompetencat që i ka Departamenti i Mjekësisë Ligjore.

Po të dalim në nenin 4, flet komplet për strukturën organizative të Departamentit për Mjekësi Ligjore, duke filluar nga paragrafi 1, ku thotë:

“Departamenti i Mjekësisë Ligjore është pjesë integrale përbërëse e strukturës organizative dhe administrative të Ministrisë së Drejtësisë.”.

Pastaj, vazhdon, paragrafi 2: “Departamenti do të përbëhet nga divizioni”.

2.1. Divizioni për mjekësi ligjore”;

2.2. Divizioni për hulumtime;

2.3. Divizioni për identifikim;

3. Përbrenda divizioneve që janë në kuadër të Departamentit për Mjekësi Ligjore do të themelohen sektorë dhe shërbime tjera të veçanta”, ia fillon.

4.1. Sektori i autopsisë;

4.2. Sektori për ekzaminime, këqyrje klinike, e kështu me radhë, mos t’ju lodhi...

Shkon deri në nenin 7, domethënë e gjithë kjo strukturë organizative është e paraparë me nene, që është jashtë çdo teknike juridike dhe paramendoni, nëse ndërron një departament apo ndonjë sektor një divizion, një njësi, që e kemi strukturën organizative, duhet të fillohet ndryshimi i ligjit.

Për ta bërë të paimplementueshëm fare në praktikë Projektligjin, nisemi në nenin 7. Kështu së paku e kanë radhitur, sepse edhe kjo është edhe teknikisht, por ne nuk do të lëshohemi në çështje teknike.

“Në departamentin e mjekësisë ligjore”, thotë, “një zyre e administratës dhe e logjistikës do të jetë përgjegjëse për: buxhet dhe financa, burime njerëzore, prokurim, teknologji informative” dhe të gjitha janë të renditura me nene, që bie në kundërshtim me nenin paraprak ku flet që “po krijohet Departamenti i Mjekësisë Ligjore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë” dhe kjo po nënkupton që tani kemi komplet edhe një ministri tjetër sepse, ju e kuptoni, ato të cilët e kanë departamentin e prokurimit, ato të cilat e kanë buxhetin dhe financat, ato të cilat e kanë teknologjinë informative – janë organizata të pavarura buxhetore dhe kjo mund të jetë ose Agjenci ose Ministri, në raste të veçanta në Kosovë, edhe ndonjë institut i pavarur.

Dhe, paramendoni, kjo ndeshet tash komplet me Ligjin e financave publike, ka ndeshje me Ligjin e prokurimit publik, sepse e qartëson shumë qartë se ku mund të themelohet departamenti i prokurimit dhe bie edhe në kundërshtim me atë që vetë qëllimi i ligjit është, domethënë, që të krijohet si departament në kuadër të Ministrisë. Është bile edhe shumë interesant, nëse e merrni paragrafin 8, thotë “Selia e Departamentit të Mjekësisë Ligjore do të jetë në Prishtinë”.

Shkojmë më tutje. Neni 6. Kompetencat dhe përgjegjësitë e divizionit. Tash flet për kompetencat dhe përgjegjësitë e divizionit dhe në paragrafin 1.2. thotë “Mbajtjen e të drejtës ekskluzive për të udhëhequr hetimet mjekësore për vdekjen në vendin e ngjarjes i takon këtij divizionit” që e përmendëm. Kjo bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me nenin 109, sepse të drejtë ekskluzive për udhëheqjen e hetimeve ka vetëm prokurori i shtetit. S’po flas tash për prokurorin e qarkut, varësisht prej veprës penale. Prandaj, edhe këtë nen që e kanë bërë, është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.

Pastaj, vazhdon, vazhdon dhe nuk po ju lodhi me të gjitha, por po kalojmë më tutje. Tash flet për kompetencat e divizionit, kalon nga departamenti në divizion dhe e përshkruan komplet. Pastaj vijmë deri te dispozitat, te neni 7, që flet për dispozitat kalimtare. Është shumë interesant dhe po i lexoj:

“Instituti i mjekësisë ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë do të transferohen tek Departamenti për Mjekësi Ligjore brenda Ministrisë së Drejtësisë dhe bëhen pjesë integrale e saj”. Më parë krijon departamentin, tash me një dispozitë kalimtare i bartë edhe dy institucione dhe tash nuk e dimë si do ta gjejnë vendin këto institucione.

Pastaj thotë, Buxheti i alokuar, godinat, e kështu me radhë.

Pika 3. “Personeli i Institutit për Mjekësi Ligjore, do të transferohet në Departamentin e Mjekësisë Ligjore dhe do të punojnë së bashku në grupe të përziera në Zyrën për persona të zhdukur”. Këtu nuk jep pjesë normative, por tregon qysh kanë për të punuar bashkë dhe thotë në fund “personat e zhdukur dhe mjekësia ligjore të cilat tanimë janë transferuar në Ministrinë e Drejtësisë” dhe mandej jep një shpjegim që veç kanë kaluar dhe këtë e parasheh në ligj se duhet të kalojnë e pastaj del post-festum që kjo çështje ka përfunduar.

Dhe, shumë më interesant, kemi kah fundi. Neni 8 flet për dispozitat e EULEX-it. Unë, si Komision, nuk e kuptoj çka tash, çfarë kompetence ka komisioni apo Kuvendi që të flet për dispozitat e EULEX-it. S’po e lexoj. Diku nja 5-6 nene janë për dispozitat e EULEX-it. Unë e kuptoj shumë qartë se autoriteti i Kuvendit të Kosovës dhe ne si deputetë nuk mund të nxjerrim dispozita të cilat e rregullojnë çështjen e EULEX-it, qoftë kompetencat, qoftë përgjegjësitë. Këtu tregon edhe për bashkëkryesuesin dhe kështu me radhë.

Dhe, në fund, “ky ligj”, thotë “shfuqizon dhe zëvendëson të gjitha dispozitat e tjera ligjore, të cilat janë në kundërshtim me të”. Paraprakisht thotë t’i integrojë, pastaj t’i shfuqizojë.

“Aktet nënligjore për implementimin e plotë të këtij ligji mund të nxirren nga institucioni kompetent”. Nuk e dimë cili institucion dhe kush do t’i nxjerrë.

Prandaj, meqë nga fillimi dhe deri në përfundim nuk janë as 2 nene të cilat janë përmbajtjesore, si Komision nuk do të kishte problem dhe ne do ta kishim marrë ta punojmë, por kjo do të dilte shumë interesant në leximin e dytë, sepse do të duhej të bëhet komplet një ligj i ri dhe pastaj deputetët do ta kishin të paqartë se çka do të votojnë. Do të dilnin më shumë se 20 apo 30 amendamente, kurse ky gjithsej i ka 2-3 amendamente përmbajtjesore që nuk janë të rregulluara mirë, kurse tjetra është përshkrim i organizimit të strukturës organizative. Prandaj, si Komision, kemi menduar se Projektligji duhet të kthehet dhe më pastaj të sillet si janë sjellë projektligjet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Unë do të kisha një lutje për kryetarët e komisioneve që për ligjet, të cilat janë në parim, të mos shkohet kaq në detaje, por në pika më të shkurtra të tregohet pse ligji duhet të kthehet dhe vërtet mos ta ngarkojmë seancën me çështje të tilla. Do të thotë, mjafton të thoni, ligji nuk i plotëson kushtet për këto arsye dhe numërohen arsyet dhe puna kryhet, Kuvendi ia kthen Qeverisë për ripunim pa qenë nevoja të na ngarkojë kaq hollësisht.

Megjithëkëtë, tash po kalojmë te shefat e grupeve parlamentare. Kush e kërkon fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike? Si duket, fjalën e ka kërkuar deputeti Ramadan Gashi. Urdhëroni, deputet Gashi!

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, mbështet propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për ta kthyer këtë ligj në ripunim, pasi konsiderojmë se ka hapësirë për punim të një ligji më të mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Kështu, shkurt, duhet të shkojmë!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kush paraqitet? E ka fjalën Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes këtë Projektligj për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore. Pa u ndal shumë gjatë apo në pika, edhe ne i kemi vërejtjet tona që nga fusha e veprimit, të qëllimit dhe deri te ajo e fundit – te dispozitat e EULEX-it.

Për shkak të rëndësisë, edhe për shkak të kohës, Grupi Parlamentar mendon se duhet përkrahur, në parim, dhe të gjitha vërejtjet e sugjerimet do t'i adresojë në komisionin funksional sepse po na mungon koha dhe të mos ripërsëriten vajtje-ardhjet e projektligjeve. Prandaj, ne mendojmë se duhet të angazhohemi më tepër dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional. Ne e përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Nejse, e drejtë e grupit është, por është mirë të mbetet çfarë tha Bahriu në emër të Komisionit. Fjalën e ka Rita Hajzeraj, në emër të AKR-së.

RITA HAZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Ne jemi shumë të vetëdijshëm se kemi nevojë për një projektligj ose për themelimin e një mekanizmi për mjekësi ligjore. Mirëpo, Grupi Parlamentar i AKR-së nuk është dakord që ky mekanizëm të jetë Departament i Mjekësisë Ligjore, për arsye se ne vazhdimisht duhet të pretendojmë të shkojmë në zvogëlimin e administratës dhe jo në zgjerimin e saj. Ne mendojmë se nuk do të ketë efikasitet të duhur, sepse ky departament parashihet të jetë me shumë divizione, çka nuk do të jetë në favor të qytetarëve të Kosovës. Po ashtu, ne mendojmë se ky do të ishte më mirë të ishte një Institut i Mjekësisë Ligjore, i cili do të ishte në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, që do të ishte edhe më lehtë për buxhetin, do të ishte më efikas dhe do të ishte i përbërë prej ekspertëve ligjorë dhe me më pak administratë.

Ne në parim nuk e përkrahim këtë ligj dhe jemi dakord që ky ligj të kthehet të përpunohet dhe pastaj të kthehet me një version tjetër. Faleminderit shumë.

KRYETARI: Në emër të AAK-së, kush e dëshiron fjalën? Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

Më vjen mirë që s'ma ndale mikrofonin, kryetar, si e bëre në mëngjes.

KRYETARI: Po, tash e keni të lëshuar!

GJYLNAZE SYLA: Kryetari mund t ma ndalë mikrofonin po s'mundet ta mohojë të vërtetën.

Megjithatë, po i kthehem temës, Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore. Nevoja për themelimin e një departamenti për mjekësi ligjore është evidente, duke marrë parasysh se është e nevojshme që në Kosovë të ekzistojë një autoritet përgjegjës për menaxhimin e sistemit të mjekësisë ligjore. Unë dëshiroj të theksoj një arsye shumë të rëndësishme, siç është çështja e personave të zhdukur, çështje kjo që qe 9 vjet nuk është e zgjidhur ende dhe që është e nevojshme të ekzistojë një mekanizëm efikas, i cili do të merrej me këtë çështje.

Arsyeja tjetër për nevojën e një ligji të këtillë, është se deri më tani kjo fushë specifike e legjislacionit ka qenë kontradiktore me aplikimin e deritanishëm të mjekësisë ligjore për Gjyqësorin e Republikës së Kosovës. Prandaj, është e nevojshme që kjo të rregullohet në mënyrë të qartë dhe me një kornizë të caktuar ligjore. Deri më tani, po ashtu, kemi pasur dy mekanizma të veçantë që është Instituti i Mjekësisë Ligjore, që deri më tani ka vepruar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, që vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Do të thotë, kemi pasur dy mekanizma që nuk kanë siguruar efikasitet dhe përgjegjësi, për të cilat duhet të ekzistojë ky departament. Prandaj, me formimin e një departamenti brenda Ministrisë së Drejtësisë do të arrihet qëllimi për të cilin ky departament krijohet.

Departamenti është i rëndësishëm sepse siguron shërbime të mjekësisë ligjore, siç është ekspertiza mjeko-ligjore, hetimet mjekësore për vdekjen, për njohuri të reja, trajnime, ndihmë të autoriteteve, për përcaktimin e fateve të personave të zhdukur, zhvarrosjen e eshtrave apo mbetjet mortore të njerëzve, e them, nga lufta në Kosovë, dhe kthimin e tyre tek familjarët.

Edhe pse është paraparë organizimi i departamentit me nene të veçanta, konsiderojmë se kjo është dashur të bëhet me aktet nënligjore për arsye se, në ligj ceket, se do të nxirren aktet nënligjore, por nuk ceket se cilat akte nënligjore dhe kur do të nxirren këto akte nënligjore.

Sa i përket harmonizimit me legjislacionin e BE-së, kjo me ligje të BE-së nuk është rregulluar në mënyrë të veçantë, pasi që çdo shtet rregullon legjislacionin e vet të brendshëm në këtë sferë.

Vërejtja ime ka të bëjë me atë se duhet të ketë një nen ose dispozitë të veçantë, e cila flet për funksionalizimin e laboratorit të forenzikës dhe se çfarë analizash dhe testesh do të bëhen.

Po ashtu, sa u përket implikimeve buxhetore, është e paqartë se a i ka Ministria, gjegjësisht a është ndarë buxheti për zbatimin e këtij ligji, për arsye se do ta vështirësojë zbatimin e tij meqenëse, sipas buxhetit, vlerësohet se do të duhet diku një buxhet shtesë prej 1.600.000 eurove dhe kjo në periudhën prej nëntorit 2008 deri në 2010. Kjo nuk është përfshirë në procesin e buxhetimit dhe as në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Mirëpo, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka ky projektligj, mendoj se me amendimin në komisionin përkatës mund të arrihet qëllimi i këtij projektligji, prandaj Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah, në parim. Faleminderit, Kryetar, që s'e ndale mikrofonin, vazhdoje këtë traditë!

KRYETARI: Nuk e ke shfrytëzuar gjithë kohën që e ke pasur në dispozicion! Në emër të LDD-së, e ka fjalën deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar Projektligjin për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhe mendon njësoj sikur edhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, mendon se ky projektligj nuk është i qartë, është konfuz, ka shumë kontradikta, nuk është i kompletuar dhe për të gjitha arsyet që u thanë nga kryetari i Komisionit, mendojmë se duhet t'i kthehet për rihartim edhe njëherë Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz e ka kërkuar fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče! I mi smatramo da je ovaj nacrt zakona sa materijalnim nedostacima. Prije svega, ne bi trebalo da ima ovaj naziv – Nacrt zakona o departmantu. On bi mogao da bude samo Nacrt zakona o sudskoj medicini. Znači, takav zakon može da se napravi – kao Nacrt zakona ili Zakon o sudskoj medicini, koji je bio pripremljen još ranije u prošlom mandatu i koji bi trebalo da sponzoriše Ministarstvo zdravlja, jer i sada postoji Institut za sudsku medicinu u okviru Ministarstva zdravlja, odnosno QKUK.

Ovakav zakon ne može da reguliše ovu materiju. Ranije bila je regulisana kompletno zato što je jedan deo materije bio rezervisano pravo UNMIK-a – međunarodnih institucija i onda nisu dozvoljavali da se uradi ovaj zakon.

Mi ćemo prihvatiti da zakon bude u okviru, odnosno da ovaj departament bude u okviru Ministarstva pravde, ali mislimo da zakon, ovakav kakav jeste, ne ispunjava osnovne

kriterijume. Koliko god da se popravljja, ne može ukoliko se ne izvrše temeljne promene. Znači, samo Zakon o sudskoj medicini, u okviru kojeg će biti departman možda u Ministarstvu pravde, ali ovako kako je formulisano, ima dosta nejasnoća i mi nećemo podržati ovaj zakon.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS nuk ka të lajmëruar. I kemi të lajmëruar, por më duket se nuk ka nevojë, sepse jemi në parim. Komisioni kryesisht ka thënë që t'i kthehet Qeverisë dhe shumica e grupeve parlamentare e thanë të njëjtën gjë, andaj mendoj se është koha për ta vë në votim. Prandaj, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Mirëpo, mendoj se është në parim dhe nuk është e domosdoshme, mirëpo nëse është vullneti juaj që ta vazhdojmë, e vazhdojmë. Për fjalë është lajmëruar deputetja Zylfije Hundozi. Urdhëroni, deputete e keni fjalën!

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zotni Kryetar!

Ministra të pranishëm,

Kolegë deputetë,

Hartimi i këtij Projektligji ka qenë i nevojshëm edhe më herët nëse merret parasysh sa probleme kanë ekzistuar në këtë lëmi dhe pa mundësi që të zgjidhen ashtu si duhet dhe jo vetëm që nuk janë zgjidhur, por janë zvarritur deri në ditën e sotme. Shembull po i marr vështirësitë me të cilat është përballur Komisioni parlamentar për Persona të Pagjetur në mandatin e parë duke harxhuar shumë kohë dhe energji për të ndihmuar familjet e personave të pagjetur, pa ndonjë rezultat konkret për arsye se ka munguar adresa ku do të drejtoheshin për këtë ndihmë.

Besoj se ky Projektligj do t'i zgjidhë shumicën e problemeve ekzistuese në këtë lëmi dhe këta njerëz, familjet e këtyre personave e meritojnë pas nëntë viteve ta marrin një përgjigje dhe të kenë ku të drejtohen dhe çka të bëjnë më tutje.

Me qëllim të dhënies së kontributit për përmirësimin e këtij Projektligji, do t'i jap edhe disa vërejtje, të cilat shpresoj se komisioni funksional do t'i marrë parasysh.

Ngjashëm me atë që tha kryetari i komisionit funksional, në pjesën hyrëse, thuhet se "Departamenti për Mjekësi Ligjore është organ i pavarur, por njëherësh është në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë". Do të thotë, nuk është i pavarur. I pavarur nuk është sepse do të jetë edhe në mbikëqyrje të EULEX-it, edhe pse thuhet se kjo mbikëqyrje do të jetë për qëllime të përmirësimit të kualitetit të punës së këtij institucioni.

Zgjidhja më e mirë për këtë institucion ka qenë që ky të ishte institucion i pavarur. Dihet se në të kaluarën Instituti i Mjekësisë Ligjore është keqpërdorur, ku vdekjet e inskenuara nga ana e pushtetit komunist, domethënë vrasjet që i kanë bërë, i kanë shpallur si vetëvrasje. Prandaj, pavarësia e këtij institucioni me të vërtetë do të ishte zgjidhja më e mirë, edhe pse tash jetojmë në një sistem krejt tjetër dhe manipulimet me përmasa aq të mëdha sot nuk do të ishin të mundshme.

Në këtë Projektligj nuk është i përfshirë edhe Instituti për Forenzikë ose Departamenti për Forenzikë, pjesë kjo shumë e rëndësishme për përcaktimin e gjendjes psikike të personit në momentin kur e ka bërë krimin dhe në përgjithësi gjendja psikike e pacientit para krimit. Shumë manipulime mund të bëhen në këtë drejtim, siç janë bërë më herët, ku personi, i cili ka bërë vrasje ose ndonjë krim tjetër, duke luajtur rolin e personit psikik të

sëmure është liruar ose është drejtuar në një spital psikiatrik për shërim, ku nuk është e njëjta gjë sikurse ta vuash burgun. Ekspertiza forenzike është e domosdoshme, sepse ndonjëherë është faktor vendimtar për shqiptimin e dënimit, kështu që është e domosdoshme që kjo lëmi të rregullohet në të ardhmen me ligj adekuat ose të bëhet pjesë e këtij ligji, e jo të futen në këtë Projektligj vetëm projektet e kujtesës, gjegjësisht projektet psiko-sociale të cilat paraqesin një pjesë të problemeve psikiatrike që i ka kjo lëmi shumë e rëndësishme.

Unë e dëgjova me vëmendje kryetarin e komisionit funksional dhe sa i përket anës juridike ndoshta ka të drejtë, por ky Projektligj, miratimi i këtij Projektligji është më se i rëndësishëm. Ndoshta ju kujtohet të gjithëve çështja e helmimeve masive të nxënësve, ku për shkak të mungesës së një instituti toksikologjik dita-ditës ka mbetur e kontestueshme se a kanë qenë apo nuk kanë helmime.

Prandaj, lus komisionin funksional që të punojë në këtë drejtim që sot ky Projektligj të miratohet dhe të kihet një vend ku kjo lëmi shumë e rëndësishme të punojë, domethënë ku duhet drejtuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë e kam një kërkesë për kryetarët e komisioneve parlamentare që fjalën e tyre ose ta thonë në emër të komisionit ose në emër të vetin, por jo që kryetari të flet në emër të komisionit, e jep propozimin në emër të komisionit dhe pastaj dalin plotë grupe parlamentare kundër asaj, për çka mendoj se nuk është në rregull. Edhe një çështje që dua ta them, ju lute i bëni disa krahasime me tipin e shoqërisë në të cilin kemi hyrë dhe shoqëria komuniste ka kaluar dhe ne besojmë se nuk do të ndodhin më në Kosovë helmime të asaj natyre.

(Ndërhyrje)

Ju lutem, ajo i përket të kaluarës dhe ne nuk merremi me të. Fjalën do ta marrin të gjithë deputetët të lajmëruar për fjalë. Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Është vështirë të shtohet diçka pas diskutimit të kryetarit të komisionit funksional, por megjithatë ndonjë fjalë mund të thuhet për këtë ligj, sepse prej nenit të parë e deri te neni 11 ka gabime. Për mua, si deputet, ky ligj identifikon diçka që është shumë më serioze, që nuk është herë e parë që kthehen apo që diskutohet për t'iu kthyer ligjet në parim Ministrisë së Drejtësisë. Diskutimet që rrëshqasin dalëngadalë drejt asaj që të kthehet ligji Ministrisë së Drejtësisë dhe në parim të mos miratohet në Kuvend, reflekton dhe bartë në vete një mesazh shumë të rëndësishëm që atje ka inkompetencë profesionale. Megjithatë, aty janë disa procedura që duhet të përcillet ligji për deri sa të vjen në Parlament, që në ato procedura që janë të miratuara nga Qeveria, leximi i fundit bëhet nga ministri i Drejtësisë.

Unë, si deputet, kisha pritur që nga të gjitha ministrinë të vijnë pa formë ligji, por prej Ministrisë së Drejtësisë nuk kisha mund të pres, kështu që sugjeroj dhe i propozoj Ministrisë së Drejtësisë që të ngritë kapacitetet e veta të brendshme profesionale, që të jetë më e vëmendshme, që të mos thotë s'e kam lexuar apo që tenton të ofrojë argumente që nuk di ku e kanë burimin.

(Ndërhyrje)

“Po duhet të kalojë”! Po duhet të kalojë, nuk është argument për ligj të kalojë. “Është ligj nevojshëm”! Ligji është i nevojshëm, por i nevojshëm është ligji i mirë. Shkruaje mirë ligjin!

Kështu që, këto janë disa prej vërejtjeve të mia substanciale dhe sugjeroj që të jenë kontribuues në ngritjen e kapaciteteve të brendshme, duke filluar prej stafit politik, deri te shërbyesit civil, sepse i gjithë mekanizmi i Ministrisë së Drejtësisë është i përzier në procedurën para se të procedohet ligji në Parlamentin e Kosovës dhe së paku letër të mos humbim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të kemi parasysh se diskutimet bëhen në parim. Për fjalë është lajmëruar deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk është herë e parë që sponzoruesi i projektligjeve, në këtë rast Qeveria e Republikës së Kosovës, thënë konkretisht – Ministria që do të ishte dashur të jetë më e përgjegjshmeja në këtë fushë – Ministria e Drejtësisë sjell në Parlament ligje të papërgatitura si nga teknika juridike, po ashtu edhe për nga renditja e substancës për të cilën vjen një ligj para deputetëve të Kuvendit, të një shteti normal. Dhe, diskrepancat në mes të partnerëve të koalicionit, kryetari i komisionit funksional, që vjen nga partia më e madhe, me konsensus të plotë thotë që “ky ligj duhet të kthehet prapa”, kurse partneri tjetër i koalicionit thotë se “ky ligj duhet të procedohet”. Dhe, tani, unë po vërej këtu edhe moskuptime nga ana edhe e juristëve, në një aspekt tjetër, po edhe e vokacioneve tjera këtu. Ju lutem, në çdo shtet normal që pretendon të jetë anëtar i familjes së Bashkimit Evropian, ekziston Departamenti për Mjekësi Ligjore. Departamenti i Mjekësisë Ligjore nuk është institucion shkencor. Dikur, në kohën e komunizmit, ka qenë Instituti i Mjekësisë Ligjore pranë Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë dhe që është edhe sot e kësaj dite, por që me këtë Projektligj duhet të kalojë në Departamentin e Mjekësisë Ligjore në kuadër të një ministrie që e mbulon tërë këtë fushë, e ajo është Ministria e Drejtësisë.

Edhe Zyra për Persona të Pagjetur, që ka qenë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, sa ka qenë protektorati, dhe më vonë kur u themelua Ministria e Drejtësisë kaloi në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, që është shumë normale, duhet të kalojë në këtë departament.

Andaj, hiq mangësitë edhe gjuhësore, është një ligj nga aspekti gjuhësor skandaloz. Unë nuk di a po vijnë japonezët po na i hartojnë ligjet, në gjuhën shqipe, e kam fjalën, nuk e di për gjuhët tjera, apo çka është kah ndodhë. Dhe, a e kupton ministrja e Drejtësisë – Zyra ligjore pranë asaj Ministrie, që do të duhej të ishte shembull i hartimit dhe i të shkruarit me terminologji juridike normale, nuk po them perfekte, që thjeshtë çfarë Projektligji. Por në aspektin në substancë, duhet dalluar disa çështje: që Instituti i Mjekësisë Ligjore, i cili aktualisht vepron në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, Zyra për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore që aktualisht vepron në kuadër të Mjekësisë së Drejtësisë, duhen thjesht me një ligj kësioj të kalojnë në Departamentin e Drejtësisë. Pastaj, janë 3 ose 4 komponentë të rëndësishme që e bëjnë imediat që shteti i Kosovës ta ketë një ligj të tillë.

Ka edhe anë të mira në substancën e këtij Projektligji. Në këtë Projektligj përcaktohen qartë të drejtat për të siguruar ekspertizë mjeko-ligjore për të gjitha organet publike. Nuk është mjekësia ligjore, do të thotë, po e marrin edhe një pjesë dërmuese e diskutuesve

vetëm aspektin mjekësor. Jo! Është gjyqësia, është prokuroria dhe janë provat materiale që mund t'i shfrytëzojë policia e shtetit të Kosovës dhe, ju lutem, këto janë dallime esenciale.

E drejta ekskluzive për autopsitë e freskëta: vrasjet, vetëvrasjet, fatkeqësitë elementare, aksidentet dhe paqartësitë që paraqiten rreth këtyre rasteve të përditshme në jetën e përditshme, thjeshtë duhet të rregullohen me ligj, kush e bën autopsinë, si bëhet autopsia dhe ku shkojnë ato raporte.

Pastaj, e drejta për antropologji forenzike dhe eks-humime që është një rast që do ta përcjell Kosovën edhe në një fazë të caktuar të tranzicionit dhe duhet të jemi të sinqertë, nuk kemi pasur legjislacion në këtë drejtim. Kemi vakuume të shumta dhe janë edhe 1.996 qytetarë të Republikës së Kosovës që rezultojnë ende të pagjetur.

Është edhe një aspekt tjetër pozitiv në këtë materie të këtij Projektligji, aspekti edukativ dhe trajnimi i vazhdueshëm për studentë, në radhë të parë, për infermier mjeko-ligjor, hetues mjekësor të shkaqeve të vdekjes, që është shumë e rëndësishme, pastaj teknikë të mjekësisë ligjore, teknikë të histopatologjisë dhe autopsisë sipas standardeve bashkëkohore.

Aktet nënligjore që u potencuan këtu, pastaj duhet t'i nxjerrë Departamenti në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. Sa i takon autopsisë, duhet nxjerrë një ligj të veçantë që i rregullon dhe i përkufizon të gjitha këto procedura tejet të rëndësishme dhe komplekse për drejtësinë, pse jo edhe për sistemin në përgjithësi të funksionimit të ligjit të një vendi.

Andaj, edhe unë jam pro që ky ligj të kthehet pasi që është vlerësim i komisionit funksional, por ju lutem, ka mundësi dhe ka materie në këtë ligj që janë bashkëkohore, sepse mbi 98% e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian e kanë organizimin e mjekësisë ligjore që i ngërthen në vete të gjithë këta sektorë pranë Departamentit për Mjekësi Ligjore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet Hajdin Abazi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E mora fjalën, për dy arsye: një, së shpejt vjen fundi i vitit dhe tani, kur s'po ma jep fjalën, ata të NDI a kush po na teston këtu, po na i qesin njisha atje neve, koeficientin, a! Po e plotësoj me këtë, kështu që tjera herë, besoj se na e jepni fjalën.

E dyta, është arsyeja tjetër që më bëni kureshtar kryetari i komisionit parlamentar lidhur me këtë çështje, që ishte për mua një shpjegim shumë i mirë, prandaj po përfitoj, të them kështu, nga rasti se çfarë përshtypjeje fitova unë në këtë moment. Po, po, ama për hartuesin i kam dy pyetje:

E para, a mos ra në provim pra kjo eksperiencë, përvoja e alamet juristave në Qeverinë e Kosovës?

Apo, e dyta: mos është hartuesi i këtij projekti ndonjë ekspert fillestar prej Etiopisë që ka ardhur në Kabinetin e Hashimit, a këtu, të dimë e ta sqarojmë se për besë po na vjen

bajagi si rënd kjo punë. Unë do të abstenoj për veti, sepse nuk e di tash çka po bëni me këtë ligj.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Ju lutem, pjesë e barabartë është edhe diskutimi i deputetit Rexhepi. Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra dhe zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë,

Mendoj se pas fjalës së kryetarit të Komisionit, të gjitha diskutimet kanë qenë të mira, kanë qenë me qëllim të mirë, mirëpo në njëfarë mënyre thuaja se kanë qenë të panevojshme pasi që vetë komisioni profesional e shtroi kërkesën që ky ligj të rikthehet për t'u ripunuar. Kështu që në këtë aspekt, gjithçka që ne do të shtojmë më tutje, përsëri do të shkojë në funksion të atij konkluzioni të cilin e paraqiti, me argumente bindëse dhe vërtet të mbështetur se ku janë defektet e këtij ligji dhe çka duhet e si duhet të përmirësohet.

Prandaj, unë personalisht e mbështes, sepse ishin argumente të qëndrueshme lidhur me këtë ligj. Nuk është çështja këtu pse ligji është si është. Çështja është që ne ta bëjmë një ligj i cili do të jetë funksional dhe që ta bëjë mjekësinë ligjore të funksionojë. Ka edhe defekte të tjera, si për shembull: "Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore". Ndoshta këtu terminologjia duhet të jetë e kujdesshme, sepse ne duhet ta dimë a po bëjmë ligj për departamentin apo po bëjmë ligj për mjekësinë ligjore që pastaj statusi i të cilit do të vendoset si duhet të jetë.

Për këtë arsye, zoti Kryetar, mbase do të ishte mirë, se kemi edhe pika të tjera, të kufizohemi në këto diskutime, sepse në momentin kur ligji do të votohej për të shkuar në shqyrtim, e kemi mundësinë të gjithë që ta japim kontributin tonë në komisionin profesional dhe në komisionet e tjera përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuari deputet, le të merren vesh komisionet dhe grupet parlamentare! Te unë s'është problemi! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, që tash për tash, është i fundit.

RIZA SMAKA: Zotëri Kryetar!

Të nderuar qeveritarë dhe deputetë,

Në qoftë se ky projektligj do të kthehej në ripërpunim, do të ishte një punë e mirë, e mbarë, e nevojshme dhe e arsyeshme. Mirëpo, do ta kuronim pasojën jo shkakun. Nuk është fjala vetëm për këtë dokument juridik, por te të gjitha dokumentet juridike që vijnë këtu për lexim të parë, po e zëmë, janë tepër të dobëta gjuhësisht. Sepse, nuk është fjala këtu të nxjerrim, si të them, spira, por është fjala te aplikimi dhe atje paraqiten problemet e patejkalueshme. Aq më parë, kur në tri gjuhë janë aq larg këto terma dhe shprehje, sa që del se janë 3 dokumente të ndryshme, kurse duhet të jenë krejtësisht të njëjta. Prandaj, shkak do të duhej të ishte i zgjidhur në këtë mënyrë, që me të vërtetë Qeveria mund ta bëjë këtë dhe le ta bëjë, le ta formojë, po e zëmë, një këshill legjislativ dhe një grup të juristëve specialistë që do të merrej vetëm me legjislacion, sepse puna primare e Kuvendit të Republikës së Kosovës është legjislacioni dhe Qeveria më pastaj e lidhur aty për ekzekutimin e tyre. Këto të tjerat janë sekondare. Faleminderit!

KREYTARI: Atëherë, të shkojmë në procedurën e votimit. Më falni! E ka fjalën Lulzim Zeneli. Urdhëro, dil e fol këtu!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Jemi të bindur se, nëse ky debat do të shërbente si porosi për Qeverinë e Republikës së Kosovës, se është ndoshta koha e fundit të adresohet një vërejtje se projektligjet nuk duhen të adresohen në Kuvend për plotësimin e organogramit të vet, por duhet të adresohen si nevojë që shtron shoqëria kosovare për një jetë më funksionale dhe kjo më së miri tregon se e kemi një projektligj që i ka 11 nene, 11 nene dhe nëse ndokush mund ta kuptojë se çka do të thotë një nen i caktuar, atëherë më së miri mund të definojë se ku qëndron realiteti.

Nëse ekspertët, ata të cilët thirren në mjekësi sot dhe mund ta kuptojnë se çka do të thotë termi “toksikologji”, më së miri mund të adresohet në këtë projektligj. Nëse doni, do ta lexoj. “Toksikologjia nënkupton studimet përkundër efekteve e përbërjeve kimike në organizmat e gjallë”! A din ndokush të kuptojë çka do të thotë kjo?

(Ndërhyrje)

Dhe, tash, dhe ky debat le të jetë një porosi e mirë për Qeverinë e Kosovës, që herëve të tjera të mos maltretohët Kuvendi me projekte të tilla të cilat nuk i bëjnë nder jo vetëm Qeverisë, por as shoqërisë kosovare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kalojmë në procedurën e votimit. Ju lutem, do të hyjmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 24 vota “për”, 30 “kundër”, 9 “abstenime”, Projektligji i kthehet Qeverisë për ripunim.

Mendoj se është koha për një pauzë prej 15 minutash.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Projektligjit për lizingun financiar

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 janë përmbushur kushtet për shqyrtimin në parim të këtij Projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Ramë Manaj, që ta prezantojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuari Kryetar,

Të nderuar deputetë dhe ministra,

Në vazhden e përpjekjeve për të kompletuar bazën ligjore për rregullimin e çështjeve financiare dhe ekonomike, sot sjellim para jush edhe Projektligjin për lizingun financiar.

Ky Projektligj është përgatitur për ta plotësuar zbrazësinë ligjore të deritanishme pasi që nga kjo fushë nuk ka qenë e rregulluar me asnjë akt juridik të veçantë, qoftë me ndonjë ligj, qoftë me akte të tjera nënligjore.

Në anën tjetër, duhet të sqaroj para jush se Projektligji për marrëdhënie detyrimore, i cili është duke kaluar nëpër procedura të hartimit dhe të miratimit, me disa nene të veçanta do t'i rregullojë disa çështje të mbetura të cilat nuk i rregullon ky projektligj, pra do t'i trajtojë çështjet që kanë të bëjnë me lizingun operativ.

Draftligji që e keni para jush, pra për lizingun financiar, trajton lizingun financiar, të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratën përkatëse dhe rregullon marrëdhëniet që lindin nga dhënia me qira financiare dhe të sendeve të luajtshme e të paluajtshme të cilat dallohen me veçoritë e tyre. Nga ana tjetër, zhvillimet e vrullshme të marrëdhënieve ekonomike dhe financiare në vend diktojnë nevojën për rregullimin ligjor të tyre. Kontrata e lizingut financiar nënkupton në mënyrë të përmblodhur, si në vijim:

Me kontratën e lizingut financiar njëra palë detyrohet të vë në dispozicion të palës tjetër për një kohë të caktuar një send të luajtshëm ose të paluajtshëm kundrejt një pagese me afate periodike të përcaktuara në lidhje me vlefën e sendit, me kohëzgjatjen e kontratës dhe eventualisht me elemente të tjera sipas marrëveshjes së palëve.

Sendi duhet të jetë i fituar ose të jetë ndërtuar nga lizingdhënësi, sipas dëshirës dhe përshkrimit të lizingmarrësit dhe ky i fundit ka të drejtë të fitojë pronësinë në mbarim të afatit të kontratës kundrejt pagesës së një shume të paracaktuar.

Lizingdhënësi përgjigjet ndaj lizingmarrësit sipas rregullave të përgjithshme për mosdorëzimin e sendit ose vonesën në dorëzimin e tij, si dhe për të metat e sendit. Me marrëveshje mund të parashikohet që lizingmarrësi para se të kërkojë nga lizingdhënësi të drejtat e tij, duhet t'i drejtohet atij që ka dhënë sendin, pra furnizuesit për të drejtat e tij ose të atij që i janë kaluar.

Me hartimin dhe përfundimin e Projektligjit për lizingun financiar, krahas Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ka marrë pjesë edhe Zyra e Kryeministrit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Banka Botërore, ICO, e të tjerë.

Projektligji për lizingun financiar ka 8 krerë dhe 30 nene.

Në fund, propozoj që ta miratoni Projektligjin për lizingun financiar në parim, në mënyrë që gjatë procedimit të mëtutjeshëm të plotësohet me amendamente të ndryshme eventuale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për lizingun financiar rregullon në mënyrë gjithëpërfshirëse lizingun financiar të aseteve. Objekt lizingu paraqitet çdo pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme, por nuk përfshihen paratë, dokumentet, instrumentet financiare, llogaritë ose garancitë e investimeve.

Çështja e kontratës së lizingut është e rregulluar edhe me një ligj tjetër shumë të rëndësishëm për ekonominë e lirë të tregut, siç është ai i detyrimeve, i miratuar në

Kuvendin e Kosovës në vitin 2004, i cili lizingun e rregullon prej nenit 772 gjer në nenin 778.

Në këto dispozita juridike rregullohet lizingu i sendeve të konsumueshme, lizingu investues, ai afatshkurtër dhe afatgjatë.

Praktika ka imponuar nevojën imediate që me ligj të veçantë të rregullohet edhe lizingu financiar, i cili nuk është i përfshirë në rregullativën ligjore të Ligjit të detyrimeve të Kosovës.

Në këtë kontekst, Ligji i detyrimeve paraqitet si *lex generalis* dhe bazament i fuqishëm i Projektligjit për lizingun financiar si *lex specialis*, i cili do të rregullojë në mënyrë të detajuar të gjitha marrëdhëniet që krijohen midis subjekteve të së drejtës në suaza të lizingut financiar.

Qëllimi prioritar i këtij ligji është përcaktimi i bazës ligjore, krijimi i një mjedisi optimal që mundëson ofrimin e shërbimeve palëve kontraktuese, lizingdhënësit dhe lizingmarrësit të lizingut financiar si dhe rregullimi i kësaj fushe me ligj të veçantë.

Projektligji mbi lizingun financiar është gjithëpërfshirës në aspektin e precizimit, të detajimit të të drejtave të palëve kontraktuese, duke i ofruar mundësinë lizingdhënësit që të ruaj të drejtën e tij të pronësisë mbi asetin objektlizingu gjatë gjithë kohës, pavarësisht masës së ndonjë bashkëngjitjeje në të ose inkorporimit si pjesë e një pasurie tjetër të luajtshme apo të paluajtshme, edhe nëse heqja e asetit objektlizingu do të shkaktonte dëm të pakompensueshëm.

Nga ana tjetër, Projektligji në mënyrë koncize precizon jo vetëm të drejtat, por edhe përgjegjësinë për dëmet e pësura nga shfrytëzimi i asetit objektlizingu në kundërshtim me kontratën e lizingut ose në kundërshtim me asetin objekt i lizingut financiar.

Projektligji për lizingun financiar përmban një teknikë juridike të mirë, një gjuhë juridike të qartë që e lehtëson implementimin e tij në praktikë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mirëpret dhe e përshëndet sjelljen në Kuvend të këtij ligji me rëndësi të veçantë. Vërtet, jo vetëm për imazhin e Kosovës së re, por edhe për funksionimin e shoqërisë së re demokratike dhe sundimin e ligjit. Kuvendit të Kosovës i është sjellë një ligj vërtet i mirë dhe do lavdëruar punën e Grupit Punues në këtë drejtim. Përkundër kësaj, mendoj se nuk ka arritur Grupi punues që t'i evitojë edhe disa mangësi dhe shmangie, të cilat, besoj se janë të korrigjueshme dhe ne do t'i korrigjojmë gjatë procesit të amendimit të këtij ligji në komisionin funksional.

Ligji i propozuar plotëson një zbrazësi juridike që ka ekzistuar te ne, krijon një infrastrukturë ligjore të domosdoshme, të harmonizuar me standardet dhe direktivat evropiane.

Unë e përshëndes ministrin për punën e bërë, për intensitetin e shtuar në drejtim të miratimit të ligjeve funksionale, të ligjeve të cilat na nevojiten për ekonominë e lirë të tregut.

Në emrin tim personal dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, konsiderojmë se ligji i propozuar duhet të miratohet në shqyrtim të parë. Ju falënderoj për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim Projektligjin për lizingun financiar. Faleminderit!

KRYETARI: Gjithashtu, edhe prej teje, faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, për fjalë është paraqitur deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Disa vërejtje parimore në këtë dokument. Fillimisht, fjalia e parë në preambulë është gjysmë për gjysmë e cunguar. Thotë, “në mbështetje të nenit...” kaq e kaq, “të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.” pikë.

Neni 1, po e zëmë, tre terma janë të kundërta. Në shqip “marrëdhënie”, në anglisht “transaction”, në serbokroatisht “pravni posao”. Parimisht nuk duhet kësioj sepse duhet të jenë shprehje adekuate të një kuptimi, jo të kuptimeve të ndryshme.

Ky dokument titullohet “Ligji për lizingun financiar”, mirëpo më pastaj i përjashton instrumentet financiare dhe vetëm iu referohet aseteve, sendeve të paluajtshme, të luajtshme, e tjera, e tjera.

Në tekstin serbisht-boshnjakisht, trajtohet “tapia”, në anglisht jo, në shqip jo.

Neni 4 definon formën e kontratës për lizingun dhe ashtu bëhet presedent, i pavend, ngase në biznesin, në ekonominë e tregut transaksionet kryesisht kryhen konform me parimin jus dispozitivum e jo me jus imperativum, që kryesisht është aplikuar në socializmin etatist.

Më pastaj, në nenin 5, po ashtu veprohet kur këtij dokumenti i caktohet edhe përmbajtja e kontratës. Krejt tematika e këtij ligji, praktikisht i referohet kontratës për lizingun. Sipas këtij koncepti, do të duhej të bënim ligj të veçantë për arendën, ligj të veçantë për emfiteuzën, ligj të veçantë për qiramarrëdhënien, sepse lizingu është një lloj i qiramarrëdhënies dhe do të ndërhyhej në të drejtën autonome për kontrakte. Në ekonominë e tregut, në shtetin demokrat, shteti nuk interferon në kontrata, vetëm në qoftë se kontrata do të ishte në kolizion me moralin dhe me interesin shtetëror apo me kushtetutën. Ndryshe, kontrata është çështje që përcaktohet nga kontraktorët. Këtu mandej shkohet e numërohen obligimet, elizorit, të lizit, e tjera, e tjera, që ato nuk mund të caktohen me ligj për shkak se nëse do të bëheshin 1000 kontrata për lizingun, ka mundësi që 1000 variantat të bëheshin, sepse vetë kontraktorët i përcaktojnë kushtet, i stipulojnë obligimet dhe autorizimet reciproke.

Konsiderojmë se ky dokument nuk ka nevojë fare të bëhet dhe në vend të këtij të bëhet një dokument tjetër, sepse kemi vakuume juridike dhe kjo është çështje që nuk duhet të rregullohet me ligj. Në socializmin etatist ka qenë tendenca që të rregullohet nga shteti me ligj, ndërsa në ekonominë e tregut, nuk rregullohet me ligj kontrata. Kjo eventualisht mund të jetë në kodin për obligimet, apo civile, e tjera, e tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Do të shkojmë, pra, sipas grupeve parlamentare, sepse grupet parlamentare e kanë radhën, por juristët është mirë të konsultohen në mes veti. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj e ka kërkuar fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Me këtë projektligj po plotësohet një vakum ligjor, i cili ka ekzistuar në mungesë të lizingut financiar, i cili i përcakton të drejtat dhe obligimet e palëve në marrëdhënie të lizingut financiar. Dhënia e lizingut financiar afron shfrytëzimin e aseteve, pra të gjërave të luajtshme dhe të paluajtshme, ose të them më mirë në gjuhën shqipe, dhënia dhe marrja me qira e aseteve dhe kthimi në gjendje si është marrë.

Unë shpresoj se ky projektligj është mjaft i duhur, në momentin e duhur dhe përgëzoj Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave për një ligj të mirë. Edhe rreshti i fundit, por edhe Grupi i Aleancës i përkrah projektligjet e mira dhe sugjerojmë që në këtë Kuvend të bihen ligje të mira në sferën ekonomike për arsye se mungojnë shumë ligje dhe duhet të them se vetëm Ligji mbi letrat me vlerë dhe shumë ligje tjera të cilët e bëjnë të pamundshëm edhe kthimin e Fondit të Trustit Pensional, që u diskutua para dite, dhe në mungesë të legjislacionit edhe po të dëshirojmë, në mungesë të legjislacionit që e kemi në bazën ekonomike, nuk mund ta kthejmë për momentin, por dëshirojmë nga Qeveria që të sjellë ligje të sferës ekonomike me qëllim të një zhvillimi edhe më të hovshëm ekonomik, por edhe me qëllim të realizimit të disa problemeve që janë duke na ndodhur, sidomos me fondet. Prandaj, në emër të Grupit të Aleancës, përkrahim Projektligjin dhe do të kontribuojmë në komisionin funksional dhe në komisionet kryesore ku do të kalojë projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet Neziraj. Fjalën e ka në emër të LDD-së, deputeti Naser Rugova. Unë e kam të shënuar këtu Naser Rugovën, mirëpo urdhëro, fjalën e ka Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka qëndrim në përkrahje parimore në raport me këtë Projektligj, mirëpo çështja që ka të bëjë me trajtimin e aseteve, të cilat janë objekt i lizingut financiar, mbetet shumë si një dilemë që duhet të sqarohet në detaje gjatë procedurës së amendimit dhe kjo sidomos ka të bëjë me nenin 12, ku trajtimi që i bëhet me nenin 12 bie në kundërshtim të plotë me krejt Projektligjin. Dhe, vetëm po e theksoj “lizingdhënësi nuk ka përgjegjësi ndaj lizingmarrësit në lidhje me të metat materiale të asetit objekt lizingu”. Pra, kjo çështje bie në kundërshtim të plotë me çështje të cilat janë adresuar më herët dhe këtu shtrohet si pyetje – paska mundësi edhe mashtrimi, po paska mundësi edhe të trajtohet ndryshe dhe në raport me krejt këtë nuk do të ketë llogaridhënie. Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në komisionin funksional do të kontribuojë përmes anëtarit të vet në procedurën e amendimit. Ju faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Mufera Shinik e ka fjalën.

MÜFERA ŞINIK: Sayın Başkan, Bakanlar ve Milletvekilleri

Finansal lizing Yasa Tasarısı Kosova toplumu için büyük önem taşımaktadır. Çok iyi hazırlanmış bir Yasa Tasarısı. Sadece 11. maddenin 2. noktasında şöyle denilmektedir: “ Borçlu olan taraf görevini kendisi yerine getirmezse, alacaklı taraf sigortayı kendi başına düzenleyebilir ve bu durumda ödünç alan taraf, ödünç veren tarafa bu sigortayla ilgili tüm masrafları ödemekte zorunludur“. Burada harcamaların ödünç alan tarafından ödenmesi gerektiği vurgulanmaktadır. Ancak burada ödeme süresi saptanmamıştır. Buraya ek olarak ödeme süresinin katılması gerektiğine inanıyoruz. Onun dışında 7+ Parlamenter grubu olarak bu Yasa Tasarısını kabul ediyoruz Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Nga SLS, nuk ka. Atëherë, radha është e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar! Hera e tretë që po e marr fjalën, jo që po dëshiroj, por e kemi obligim, se s’na paguhet në fund të muajit pastaj!

Atëherë, unë do të jap opinionin tim dhe disa vlerësime lidhur me Projektligjin për lizingun financiar. Mendoj se ky Projektligj edhe në përmbajtje edhe në çështjet që i adreson duhet mirëpritur dhe i plotëson ato kondita për të cilat kemi pasur vërejtje për disa projektligje tjera, që në këtë rast mirë është që s’janë ashtu.

Vetë subjekti që trajton kjo dhe shumë saktë përcakton edhe kompanitë, edhe ndërmarrjet të cilat duhet të jenë objekt brenda këtij ligji, të drejtat dhe obligimet e tyre edhe për pronën, për asetet dhe lëvizjen e tyre. Lizingu jo vetëm sot, por edhe më herët ka ofruar një mundësi, një lehtësim shumë të madh në ekonomi për ndërmarrjet, si një stimulim për zhvillimin, për investimet dhe për bartjen apo këmbimet teknologjike që janë të nevojshme edhe në vendin tonë, sepse kushtet e vështira për marrjen e kredive bëjnë që afaristët të mos kenë mundësi që të rrisin gamën e investimeve në ndërmarrjet e tyre, prandaj unë e shoh lizingun, sikur që ka ndodhur edhe në vende të tjera në praktika, që kanë ndihmuar shumë sektorin e caktuar, që do të ndihmojë pra prodhimtarinë, do të ndihmojë ngritjen e kapaciteteve të reja, do të rritë produktivitetin, e po ashtu do të ndihmojë ndërmarrjet për një konkurrencë në tregun e hapur, e kështu me radhë.

Prandaj, unë mendoj se duhet mirëpritur nga vetë sektori i ekonomisë dhe është mirë që Parlamenti, gjegjësisht Qeveria e ka vë në rend dite dhe e ka përgatitur. Pra, unë e përkrah në parim. Kam, si të them kështu, një vërejtje timen, që pjesa përfundimtare – te dispozitat përfundimtare, të shikohet që vërtetë të jetë kompatible me të drejtën kur janë në pyetje kontratat e ndërmarrjeve të jashtme apo vendore dhe ky Projektligj të mos biejë ndesh qoftë me traktate, qoftë me ligje të tjera, sepse aty do të na krijohet një problem i madh dhe unë nuk them se kam ndonjë përvojë, por do të kisha lutur që të kemi kujdes për arsye që vërtetë nesër në praktikë ky të shërbejë për qëllimet që është bërë. Prandaj, në këtë rast, unë megjithatë po jap vlerësimet më të mira që duhet, sepse kështu projektligje na duhen dhe duhet të ecim përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po i shfrytëzoj këto 5 minuta dhe po shpresoj se RTK-ja është kah na përcjell. Lidhur me seancën e 17 tetorit, pikën 11, u pa se ministri i Financave nuk po i lexon ligjet. Kërkoj, për asgjë tjetër, për hir të tij, që t’ia transmetojnë e t’i kuptojë përgjegjësitë e veta, edhe nga fakti se disa jashtë më thanë se Qeveria ka reaguar që ajo seancë, për shkak se është kritikuar shumë keq Qeveria, ka reaguar për të mos u transmetuar ajo seancë. Unë nuk

besoj, nuk besoj se kjo Qeveri, për shkak të parimeve të veta, ndërhyt në redaksinë e RTK-së – Televizionit publik. Po ashtu, nuk besoj se redaktorët e nderuar të RTK-së tolerojnë që dikush nga Qeveria t'i censurojë ata, por do t'i dalin haku detyrës së vet dhe detyrave që i kanë ndaj qytetarëve për shkak se ata janë parapagues.

KRYTARI: Driton, të lutem përmbaju rendit të ditës, sepse nuk e kemi RTK-në në rend dite!

DRITON TALI: Shumë bukur e kam. Kjo është në proces të asaj, zoti Kryetar, i kam nja 10 minuta. Unë thashë se nuk pajtohem me atë, andaj RTK-ja duhet ta transmetojë atë seancë për t'ua mbyllur gojën gojëkëqijve dhe për t'i treguar detyrat të cilat i ka ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kaq, sa i përket pikës 11 të Trustit, që është shumë i përfolur në kohën e fundit.

T'i kthehem lizingut. Unë po flas tash dhe më lejoni pak ta patronizoj Parlamentin. Jam nismëtar i këtij ligji. Në korrik të vitit 2005, sa isha në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe atëherë ideja ka qenë që të dy lizingjet, domethënë edhe atë kapital, edhe këtë financiar, t'i inkorporojmë për nevoja të ekonomisë dhe të ndërmarrësisë në Kosovë.

Nuk di pse është zhagitur kaq shumë. Kam kuptuar se vjet ky ligj ka kaluar te Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe shoh se shumë gjëra i kanë ikur nga origjinali. Ky ligj ka ra në atë kurthin, që ne jemi munduar, po flas për atë draftin e parë, ti ikim, domethënë lizingun mos ta identifikojmë si ligj mbi qiranë – rentën, që ky tash e ka këtë formë. Nëse e merrni kreun IV, domethënë atje neni 6, neni 7, neni 8 e tjera, të japin përshtypjen se kemi të bëjmë me një ligj për rentën, ligj mbi qiranë, që nuk është. Lizingu financiar është një instrument financiar, i cili rregullon shumë gjëra.

Prandaj, do të doja që Komisioni përkatës ta ketë parasysh, që t'ia japë formën e lizingut si instrument financiar, i cili është, e jo si një kontratë e rëndomtë e rentës afatgjatë.

Për të mos e zgjatur, po them, kjo është ajo kritika esenciale të cilën do të doja ta ngrehja këtu, por janë edhe do të tjera. Zoti Zeneli e përmendi një çështje shumë të rëndësishme këtu, çështjen e përgjegjësisë ndaj produktit joadekuat për shkak se lizingmarrësi duhet të trajtohet si konsumator. Domethënë, dikush duhet ta marrë përgjegjësinë në qoftë se objekt apo aset-lizingu ka të meta. Këtu nuk është qartësuar vetëm se është, si të them, hequr nga përgjegjësia e lizingdhënësit që mund të jetë ashtu, por atëherë duhet të ngarkohet furnizuesi me atë përgjegjësi për shkak se lizingmarrësi në këtë rast ka më së paku fajë nëse aseti, nëse malli të cilin e blenë nuk është sipas konditave të duhura.

Ka edhe mangësi të shumta, në përkthim, sidomos. Aset-objekti nuk mendoj se i takon përkthimit, ai është aseti në lizing apo objekti në lizing, s'ka aset- objekt në lizing. Pastaj

më lë përshtypje dhe po çuditë, duke pasur parasysh ekspertizën e ministrit të Financave, këtu një instrument shumë të njohur financiar, shatell-letrën e ka përkthyer me instrumentin garantues, që është shumë idiotesk përkthim. Them që sinjerisht ka buzëqesh çdo financier që e ka parë këtë përkthim. Është dashur të jetë shatell-letra, që e ka një rëndësi të caktuar, ata që i marrin vesh këto sende, e dinë se çka është. Po them edhe një herë, po habitem dhe sinjerisht, duke u nisur nga fakti se edhe dikush tjetër i lexon këto sende, të mos tregojmë aq naivitete.

Çka tjetër më tërhoqi kështu? Sidoqoftë, po e shkurttoj pak, duke pasur parasysh se jemi lodhur. Të keni kujdes që t'ia jepni karakterin e lizingut, si instrument, e jo të qirasë. Kjo nuk është qira. Qiraja është krejt tjetër send, renta është tjetër send. Duhet t'ia jepni karakteristikat, dy a tri i ka, nuk ka shumë. Që doni, pas kësaj seance, për të mos e maltretuar opinionin e gjerë, shpresoj se RTK-ja po e përcjell këtë(në të qeshur), me gjithë dëshirë do të bashkëpunoj. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet, unë të kuptoj se kemi nganjëherë pamundësi për ta gjetur fjalën e duhur, por vërtet nuk është e thënë që nëse s'mund ta gjejmë fjalën e duhur, t'i themi fjalët që s'duhet.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohet për transkriptim)

Unë kam mirëkuptim, por megjithatë ekziston një mirësjellje. Vazhdojmë. Nuk ka të lajmëruar, prandaj lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohet për transkriptim)

Prezent janë 67 deputetë. “Për” kanë votuar 53, “kundër” 3 deputetë dhe kanë abstenuar 4, andaj konstatoj se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për lizingun financiar.

Në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues;
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi;
3. Komisionin për Komunitete, dhe
4. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Ju faleminderit!

Pika e radhës është:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit për amendimin e Ligjit Numër 03/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës**

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 17 korrik 2008 dhe mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës dhe në afatin e paraparë Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotin Bahri Hyseni që para deputetëve të prezantojë raportin.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje, të nderuar kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, brenda afatit të paraparë, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Kosovës, ka hartuar raportin për deputetët e Kuvendit dhe, sa për njoftimin tuaj, ju tregojmë se ky projektligj është aprovuar disa muaj më parë në këtë Kuvend, por nuk është nënshkruar nga Përfaqësuesi Special.

Me rastin e rikthimit nga Përfaqësuesi Special, nuk është bërë ndonjë vërejtje specifike në Projektligj, prandaj Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk ka pasur se çka të shqyrtojë më tutje, por ka bërë 3 amendamente, duke harmonizuar preambulën dhe dispozitat përfundimtare me Kushtetutën e Kosovës dhe, natyrisht, ka bërë edhe një amendament të ri, ku fjala “e përkohshme” kërkohet që të hiqet nga Projektligji në fjalë dhe kjo fjalë të hiqet edhe në tërë tekstin e Projektligjit. Prandaj, ne iu rekomandojmë deputetëve të Kuvendit të Kosovës që t’i aprovojnë këto amendamente. Faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI: Le të bëhen gati edhe deputetët, edhe teknika, të vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Votojmë amendamentin 1.

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti numër 1.

Amendamenti 2.

Konstatohet se me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, plus një votë me ngritje dore se s’ka kartelë. Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Kalojmë në votimin e amendamentit 3, votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet edhe amendamenti numër 3.

Tani do ta votojmë tekstin në tërësi, me amendamentet që posa i votuam. Votojmë tani tekstin në tërësi, votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, asnjë kundër, 3 abstenime, votohet Ligji në tërësi.

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës së seancës:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit për amendimin e Ligjit numër 03L-003 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës**

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 17 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës dhe në afatin e paraparë Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim. Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotëri Bahri Hyseni, që para deputetëve të paraqes raportin.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për ndryshim nga Kodi penal, këtu te procedura penale Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka qenë e domosdoshme dhe është dashur të intervenohet edhe në Kodin e procedurës penale, edhe pse nuk ka qenë në leximin e parë dhe arsyeja ka qenë që neni 212 i Kodit të procedurës penale të harmonizohet me Kushtetutën e Kosovës. Arsyeja e

intervenimit në këtë nen ka qenë për shkak të ndalesës që aktualisht bëhet edhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, ndalesa nga ana e policisë e personave të cilët ndalen përkohësisht mbahet 72 orë, që bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pikërisht me nenin 29 pika 2, sepse në Kushtetutën e Republikës së Kosovës ndalesa parashihet të jetë 48 orë.

Me qëllim të harmonizimit të Projektligjit në fjalë, ne kemi intervenuar dhe kemi rekomanduar që sot Kuvendi i Kosovës ta aprovojë këtë harmonizim të këtij neni konform Kushtetutës së Kosovës. Natyrisht, kemi bërë edhe disa amendamente të tjera, sepse e kemi pasur një rekomandim nga Përfaqësuesi Special që në procese ku duhet të zhvillohen aktgjykimet e formës së ndryshme, të mos bëhen pa prezencën e avokatit apo të mbrojtësit në fjalë. Këtë e kemi marrë si të domosdoshme dhe, natyrisht, i kemi hartuar si amendamente.

Prandaj, kërkoj që deputetët e Kuvendit të Kosovës t'i marrin parasysh këto rekomandime dhe t'i votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni, zoti kryetar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi!

Unë i thërrasë deputetët të bëhen gati për votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Konstatohet se me 60 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Konstatohet se me 61 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Konstatohet se me 58 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti numër 3.

Amendamenti 4.

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti numër 4.

Amendamenti 5.

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë kundër, 4 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Konstatohet se me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti i fundit, numër 9.

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Ju thërrasë që ta votojmë tekstin e Ligjit në tërësi, me amendamente që posa i votuam.

Ju lutem, votojmë tash:

Konstatoj se me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, votohet dhe miratohet në tërësi Ligji i amendamentuar. Faleminderit!

Kalojmë pikën tjetër të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i rekomandimit për amendimin e Ligjit nr. 03L-018 për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 17 korrik 2008 dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore dhe në afatin e paraparë Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, zotëri Agim Velin, që para deputetëve ta prezantojë raportin e Komisionit. Urdhëro!

AGIM VELIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në bazë të rregullave 39 dhe 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, në mbledhjen e mbajtur më 13.10.2008, duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për rishqyrtimin e ligjeve të aprovuara në Kuvend, por të pashpallura, e rishqyrtoi Ligjin për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore dhe Kuvendit i rekomandon që ta aprovojë me amendamentet e propozuara.

Raporti me rekomandime ka vetëm 2 amendamente dhe ato kanë të bëjnë me preambulën dhe dispozitat përfundimtare, hyrjen në fuqi të ligjit, do me thënë nuk ka asnjë ndryshim nga varianti që është aprovuar pak muaj më parë në këtë Kuvend.

Prandaj, i ftoj deputetët që ta aprovojnë me këto amendamente që i ceka më lartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri kryetar i Komisionit.

Kalojmë dhe bëhemi gati të votojmë amendamentet.

Amendamenti 1.

Konstatoj se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

I thërras deputetët që ta votojmë tekstin e Ligjit në tërësi bashkë me 2 amendamentet e posavotuara.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Miratohet ligji në tërësi. Faleminderit!

Kalojmë në pikën 10 të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i rekomandimit për amendimin e Ligjit nr. 02/L-073 për ndërprerjen e shtatzënisë

Në bazë të Vendimit të Republikës së Kosovës, datë 17 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, Komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë dhe në afatin e paraparë Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet dhe amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj anëtarin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zonjën Teuta Hadri, që para deputetëve të paraqesë raportin.

TEUTA HADRI: Faleminderit!

Mendoj se Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë ka qenë i miratuar edhe në mandatin e kaluar, mirëpo për shkak të ankesave që i ka pas bërë një grup i deputetëve “6+” dhe ankesa e tyre është pranuar nga PSSP-ja, ky Ligj ju ka kthye Qeverisë së Kosovës që edhe njëherë të riamendamentohet për shkak se problemi kyç ka qenë te neni 6 i këtij Ligji. se neni 6 i Ligjit për abortin nuk ka qenë në koordinim me Ligjin e shëndetësisë sipas nenit 107, do me thënë ka ra ndesh me këtë ligj. Prandaj, ne deputetët dhe Komisioni i Shëndetësisë të gjithë së bashku kemi ardhur në konkludim që ky ligj me amendamentet që sot propozohen, të miratohet sipas amendamenteve.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Hadri!

Unë kam dy emra që janë paraqitur: Nyrishahe Hulaj dhe Gjylnaze Sylja. Unë do të marrë arsyetimet paraprake, a janë paraqitur për ndonjë nen të veçantë, apo donë në fillim ta thonë ndonjë fjalë të veten.

Nurishahe Hulaj, çfarë do ti?

NURISHAHE HULAJ: Ju faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë në mandatin e kaluar është miratuar nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale me vota të plotfuqishme, me përjashtim të një vote nga një anëtar i Komisionit që ka vu edhe mocion dhe mu për këtë arsye është bërë mocioni dhe kanë reaguar edhe organet e UNMIK-ut, që të mos lejohet ndërprerja e shtatzënisë deri në javën e 12, por të lejohet deri në javën e 10, dhe mu për këtë arsye është kthyer ky ligj.

Unë e kam një arsyeshmëri të plotë dhe qëndroj pranë asaj që duhet të jetë deri në javën, ndërprerja e shtatzënisë të jetë deri në javën e 12 për shumë arsye. Duke e ditur se kemi Ligjin për shëndetësi, e kam përpara, kam përpara Ligjin për shëndetin riprodhues dhe kam përpara Ligjin...

KRYESUESI: A është amendamenti këtu?

NURISHAHE HULAJ...amendamenti 4 dhe amendamenti 5. Unë do të abstenoj në këto dy amendamente...

KRYESUESI: Atëherë, mos fol, kur të vijmë atje, e merr fjalën edhe mos mbani teori kur nuk duhet.

NURISHAHE HULAJ: Jo, vetëm arsyeshmërinë po dua ta them.

KRYESUESI: Kur të vijmë te amendamenti, mos mbaj teori se nuk ka nevojë.
Zonja Gjylnaze, çka do ti?

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Nëse e keni lexuar rekomandimin e Komisionit, keni parë se një anëtar ka abstenuar. Unë dëshiroj ta sqaroj qëndrimin tim, gjegjësisht pse kam qenë “kundër”. Esenca e krejt ndryshimit dhe amendimit të këtij ligji pikërisht ka të bëjë me përcaktimin e periudhës kohore dhe dua t’ia shpjegoj këtë Kuvendit.

Në mandatin e kaluar kjo ka qenë 12 javë. Tash është propozuar 10 javë. Unë mendoj se nëse duhet të kujdesemi për shëndetin e gruas shtatzënë dhe për kujdesin institucional...

KRYESUESI: Edhe ti prite amendamentin!

GJYLNAZE SYLA: Kam të drejtë të sqarojë, është me rëndësi që abortet ilegale të jenë 12 javë. Këto janë të dhëna që mund të gjenden edhe në praktikë edhe në terren. Prandaj, ftoj deputetët që në nenin 4 dhe 5 të jetë 12, e jo 10 javë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Jo, jo nuk ke çka thua, vijmë te nenet. Po nguteni, ju gratë, pak. Unë po ju them, pritni te nenet.

Kalojmë në votim.

Amendamenti nr. 1, votojmë tash:

Ju lutem, 43 janë “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti nr. 1.

Kalojmë në amendamentin nr. 2

Kemi 56 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti nr. 2.

Amendamenti 3.

Kemi 51 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti nr.3

Amendamenti 4

Jemi për amendamentin nr. 4. Pritni, rregullat janë, para votimit mund të thuhet një fjalë. Veç një moment, të bëhemi racional. Këtu janë paraqitur një, ndy, tre, katër, pesë, gjashtë, ju them edhe emrat se keni qejf, sigurisht: Teuta Hadri, Driton Tali, Gjylnaze Sylja, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj, dhe Nekibe Kelmendi. Tema është: Amendamenti nr. 4. Ju lutem, shkurt!

TEUTA HADRI: Zotëri, kryetar!

Ky amendament është kthyer edhe nga PSSP-ja për ta korrigjuar nga se është bërë një lëshim. Shoqet që flasin nuk janë profesioniste, për këtë lëmi jam e thirrur edhe në emër të profesionit. Zonja Gjylnaze është në kundërshtim me vetveten sepse kur thotë u ndihmon grave, nuk mund t'iu ndihmojë grave me 12 javë, po bën krim me 12 javë. Me 10 javë ju ndihmohet. Unë jam me profesion dhe unë i them gjithë parlamentit se duhet ta mbështesin profesionalistin në këtë lëmi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Hadri! Zotëri Driton Tali!

DRITON TALI: Fillimisht, zotëri kryesues, desha të ankohej te kryeparlamentari. Nuk është korrekte mënyra se si sillet ai. Nuk është mënyrë shumë korrekte e tij, në realitet fare nuk është, e ka fjalën e fundit dhe neve na qetë jashtë loje. Sidoqoftë, për këtë nen unë do të doja ta di qëndrimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ta debatojmë atë. Është pjesë e kësaj dhe nuk mund t'i iket përgjegjësisë për diçka që është shumë e ndjeshme.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Tali! Gjylnaze Sylja e ka fjalën!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Unë kam një respekt për doktoreshën Teuta, por qëllimi im i të qenit deputete është të mbroj interesin e gruas dhe jo të individëve, qoftë edhe të doktorëve.

Tash do ta arsyetoj pse nuk duhet të jetë 10 javë, por 12 javë. Atë çka ju referuat Teuta PSSP-së, që e ka kthyer për 10 javë, ka qenë kërkesë në mandatin e kaluar e doktor Feridit, për shkaqe religjioze, për arsye se religjionii nuk e lejon. Tjetra, kjo ka qenë kërkesë e tij.

Tash unë po kthehem për qëndrimin tim pse duhet të jenë 12 javë...

KRYESUESI: Thuaje mendimin tënd, nëse e ke, ta marrë fjalën. Thuaje mendimin.

GJYLNAZE SYLA: ... arsyeja 12 javë është se praktika ka treguar se gratë tona lajmërojnë zakonisht më vonë dhe në qoftë se lejohet vetëm 10 javë, atëherë do të rritet numri i aborteve ilegale në Kosovë dhe me këtë rrezikohet shëndeti i gruas, sëmundshmëria dhe vdekshmëria e gruas. Përpos kësaj, shtetet e zhvilluara, si Austria, Belgjika, Danimarka, Estonia, Gjermania, Hungaria, Italia, Lituania, Sllovakia, Sllovenia etj., të gjitha e kanë abortin në tremestrin e parë ose më vonë, sipas kërkesës, do të thotë vendet e zhvilluara perëndimore. Prandaj, mendoj që është në interesin e gruas të jetë 12 javë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: E ka fjalën, zotëri Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Zotëri kryesues!

Fatkeqësisht, kjo çështje nuk duhet të banalizohet, as nuk duhet të merret me buzëqeshje, sepse ka të bëjë me një çështje që ka të bëjë me nënat tona dhe motrat tona dhe femrën kosovare në përgjithësi. Prandaj, unë mendoj se edhe ata që thirren ekspertë, edhe ata që janë mjekë, duhet t'i kushtojnë një vëmendje më të veçantë dhe ta kemi një pasqyrë dhe një mendim konstruktiv se a do të duhet të jetë 10 javë, apo 12 javë. Kjo nuk është punë hajgare apo shaka.

Unë mendoj se, siç shihet, duhet të shtyhet votimi i këtij projekt amendamenti dhe të vendosim në konsultim me ekspertët se çka do të bëjmë. Prapë po them, mos ta banalizojmë se është çështje shumë me rëndësi.

NURISHAHE HUALJ: Unë thirren në Ligjin për shëndetin riprodhues që përfshinë periudhën riprodhues të nënave, moshë 18 deri 49 vjeç, që thotë: “duhet të kenë të drejtën me informata, edukim, komunikim dhe mjete të cilat do t’ju mundësojnë atyre që vendimet të jenë të mbështetura në evidencë”. Duke e ditur se ne nuk kemi evidencë të plotë në praktikën private, meqenëse sistemi i informimit shëndetësor ende nuk është i përkryer dhe nuk kemi informata të sakta se çka po ndodhë, andaj nënave duhet t’u japim kohë që të rregullohet ndërprerja e shtatzënisë deri në javën e 12-të. Unë jam për këtë.

KRYESUESI: Unë e dua mendimin e Ministrit të Shëndetësisë që është ekspert i madh i shëndetësisë, zotëri Alush Gashi.

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Ne me shumë kujdes e kemi përcjellë punën e komisionit funksional lidhur me këtë çështje. Të ndërgjegjshëm se lidhur me këtë çështje ka pikëpamje të ndryshme në shtresat e ndryshme të shoqërisë, ka pikëpamje të ndryshme në besëtytni të ndryshme, ka pikëpamje të ndryshme në kultura të ndryshme dhe kemi pasur mundësinë e ndërhyrjes në amendamentin tonë, por aq sa ne jemi në dijeni, pas muajit të tretë krijohet fryti dhe ne e kemi mbështet dhe mendojmë se kjo qasje e cila është e propozuar nga komisioni funksional është e drejtë.

Nëse Kuvendi kërkon nga Ministria ekspertizë, një analizë të thukhtë, ne mund ta punojmë me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. Unë do të votoj për propozimin e komisionit funksional, si deputet i Kuvendit të Kosovës.

KRYESUESI: Zotëri dhe zonja deputetë! Unë, nëse doni, ua jap fjalën edhe të tjerëve, janë edhe 6 njerëz. Objekti është shumë i thjeshtë, nuk di pse e komplikoni. E dini shumë mirë, a lejohet të ndërpritet shtatzënia deri në 12 javë apo deri në 10. Edhe populli punues i Kosovës le ta dijë, edhe ju vet. Ky nen është ky, nuk ka filozofi. Nekibe Kelmendi!

NEKIBE KELMENDI: Unë nuk jam eksperte e fushës të cilën po e trajtojmë, por çështjen do ta trajtoj nga sensi juridik. Nëse kemi Ligjin për shëndetësinë, me të cilin në mënyrë më të gjerë është rregulluar çështja e shëndetësisë dhe me atë ligj është paraparë afati 12 javësh për mundësinë e abortit, atëherë me Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë konsideroj se është rregulluar vetëm një pjesë e shëndetësisë, e fushës së shëndetësisë, është rregulluar çështja e abortit. Tash, nëse sot i miratojmë këto amendamente dhe këtë ligj, atëherë krijojmë amulli. Cili ligj, me cilin ligj do të punojnë apo do të zbatohet në jetë me rastin e ndërprerjes së shtatzënisë, kur i kemi dy ligje, kemi Ligjin për shëndetësinë. Dikush i bën kërkesë Komisionit t’i lejohet ndërprerja e shtatzënisë në bazë të Ligjit mbi shëndetësinë, kurse dikush kërkon në bazë të Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë. Këtu është problemi.

KRYESUESI: Zonja Tetutë, ulu bre zonjë! Po, është i harmonizuar, unë e di që është me 10 atje, por Nekibja ndoshta nuk e di, e këqyrë. Është problem tjetër. Po është e harmonizuar, unë e di, e kam përcjellë atë punë.

Unë, ju lutem shumë, diskutimi nuk ka më objekt. Neni që propozohet, neni 4, ta bëjmë të qartë edhe për ata që nuk e kanë lexuar, se shumë nuk po i lexojnë, kërkon që mundësia e ndërprerjes të jetë 10 javë. A është ashtu? Në vend të 12 javëve.
Votojmë nenin 4

Amendamenti 4.

E sjell në votim. Votojmë, tash:

Kemi 36 vota “për”, 14 “kundër” 13 abstenime. Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Kemi 38 vota “për”, 9 “kundër”, 16 abstenime. Miratohet amendamenti 5

Votojmë amendamentin nr. 6

Votojmë tash:

Kemi 42 vota “për”, 3 “kundër”, 6 abstenime. Miratohet amendamenti nr. 6

Votojmë amendamentin nr. 7

Votojmë tash:

Kemi 49 vota “për”, 4 “kundër”, 7 abstenime. Miratohet amendamenti 7.

Votojmë për Ligjin në tërësi bashkë me amendamentet e votuara pak më parë.

Votojmë tash;

Me 47 vota “për”, 5 “kundër”, 13 abstenime, miratohet Ligji bashkë me amendamente.

Kalojmë në pikën 11 të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 03L-056 për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet e tyre. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se Projektligji për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” e ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Komunitete ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për Ansamblin e këngëve dhe të valleve “Shota” dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamente të propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, e ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotëri Agim Veliun, nëse e sheh të nevojshme për të arsyetuar Raportin me rekomandime.

Zotëri Agim Veliu nuk do të japë shpjegime plotësuese. Ne tani po procedojmë me votimin e amendamenteve dhe rekomandimet e komisionit funksional. Të bëhemi gati për votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Me 47 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti nr.1.

Amendamenti nr. 2.

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti nr. 2.

Amendamenti nr. 3.

Me 48 vota “për”, 2 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti nr.3.

Normalisht, 64 deputetë janë të pranishëm.

Amendamenti nr. 4.

Me 53 vota “për”, 2 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti nr. 4

Amendamenti nr. 5.

Me 50 vota “për”, 2 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti nr. 5

Amendamenti nr. 6.

Me 58 vota “për”, 2 “kundër” 2 abstenime, miratohet amendamenti nr. 6

Amendamenti nr. 7.

Me 57 vota “për”, 2 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti nr.7.

Amendamenti nr. 8.

Me 50 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti nr. 8

Amendamenti nr. 9.

Me 46 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti nr.9.

Amendamenti nr. 10.

Me 51 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti nr.10.

Amendamenti nr. 11.

Me 52 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti nr.11.

Amendamenti nr. 12.

Me 51 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti nr.12.

Amendamenti nr. 13.

Ky 13 qenka gjysma e Ligjit.

Kemi 51 votë “për”, 1 “kundër” 2 abstenime, miratohet amendamenti nr.13.

Amendamenti nr. 14.

Me 47 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti nr.14.

Amendamenti nr. 15.

Me 52 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti nr.15.

Amendamenti nr. 16.

Me 48 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti nr. 16.

Amendamenti nr. 17.

Me 50 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti nr.17.

Amendamenti nr. 18.

Amendamenti i fundit 18 miratohet me 52 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime.

Në sallë janë 63 deputetë. Unë ju ftoj që ta votojmë në tërësi këtë ligj me amendamentet që i kaluam tash së bashku.

Votojmë për Ligjin në tërësi bashkë me amendamentet, tash:

Ligji në tërësi votohet me 59 vota “për”, 2 “kundër” dhe 4 abstenime.

Seanca për sot kryhet. Nesër vazhdojmë në ora 10,00 .

Më 7. 11. 2008

Vazhdimi i seancës plenare, ora 10:00

Mbledhjen e drejton Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në sallë janë 79 deputetë, kështu që janë plotësuar kushtet për t’ia filluar punës. Por, para se t’ia fillojmë punës, lus shefat e grupeve parlamentare të vijnë tek unë në një konsultë, në mënyrë që pikën e paraparë dhe për pyetje parlamentare që do të duhej të ishte në fillim të seancës, për shkak të mungesës së ministrave, ta lëmë në fund të seancës, kurse tani të fillojmë me pikat e tjera të rendit të ditës.

KRYESUESI SABRI HAMITI: Kolegë të nderuar, po vazhdojmë punën.

Kemi në rend dite pikën e dymbëdhjetë.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 03L-060 për kualifikimet kombëtare

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për kualifikimet kombëtare dhe Kuvendit ia kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se Projektligji ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Komunitete ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Integritet Evropian ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka vlerësuar se është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për kualifikimet kombëtare dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e komisionit funksional, nëse e sheh të nevojshme për ta arsyetuar raportin me rekomandime. Fjalën e ka zoti Agim Veliu, kryetar i komisionit funksional.

AGIM VELIU: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, si komision funksional, në mbledhjet e veta ka vlerësuar se dispozitat e këtij projektligji dhe amendamentet e propozuara janë kornizë e mjaftueshme ligjore për sistemin kombëtar të kualifikimeve, andaj i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Projektligjin për kualifikimet kombëtare me amendamentet e propozuara nga komisioni. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar i komisionit funksional!
Ne po procedojmë me votimin e amendamenteve.
E lus teknikën që të jetë gati. Votojmë tash:

Amendamenti 1.

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Konstatohet se me 58 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Konstatohet se me 72 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.
Ju sugjeroj, para se ta lexoj amendamentin, nëse dikush ka të thotë diçka para se të hymë në votim, se pasi të thërras për votim, nuk lejohet.

Amendamenti 4.

Konstatohet se me 69 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Konstatohet se me 56 vota “për”, 1 kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Konstatohet se me 62 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Konstatohet se me 67 vota, plus zonja Hadri-votim me dorë, 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Konstatoj se me 72, plus 1, 73 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 11, i fundit.

Tash i thërras deputetët që të përgatiten ta votojmë në tërësi Ligjin për kualifikimet kombëtare me amendamentet që sa i votuam.

Votojmë tash për ligjin në tërësi:

Konstatoj se me 76 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet Ligji për kualifikimet kombëtare. Faleminderit!

Kalojmë në pikën trembëdhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 03/L-077 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se projektligji ka bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Komunitete ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Integritet Evropian ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka vlerësuar se është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, e ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotëri Agim Velin, nëse e sheh të nevojshme për ta arsyetuar raportin me rekomandime. Urdhëroni, zoti Velin.

AGIM VELIU: Faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, si komision funksional, në bazë të rregullave 35.4, 36 dhe 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në mbledhjet e mbajtura më 15 shtator dhe 13 tetor 2008, shqyrtoi Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat dhe vendosi që Kuvendit t’i paraqes raportin me rekomandim dhe amendamentet e propozuara.

Amendamentet e propozuara e shndërrojnë Drejtorinë e Arkivit të Kosovës në Agjenci Shtetërore të Arkivit. Andaj, i ftoj deputetët që ta miratojnë Projektligjin me amendamentet e propozuara nga komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Veliu!
Fjalën e ka kërkuar deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryesues!

E kisha kërkuar fjalën me kohë edhe herën e mëparshme, edhe në mënyrë elektronike, edhe me dorë, por besoj që nuk u vërejtta. Prandaj, e kërkoja për nenin e parë dhe nenin e dytë. Ky ligj për ndryshimin e Ligjit për arkivat ka vetëm 2 nene dhe tërheq vërejtjen që është fjala për një Projektligj për ndryshimin e Ligjit, por në tekstin e propozuar nga Komisioni, në fjalinë e fundit është “miraton Projektligjit”, një që është gjuhësisht absurde “Projektligjit”. E dyta, miraton “Ligjin” dhe jo “Projektligjin”. Projektligji është deri në fazën e miratimit dhe kjo është konform edhe të amendamentit 2, që është në fund, “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë”. Prandaj, duhet të jetë “miraton ligjin” dhe si është tutje në tekst. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hydajet Hyseni për precizimet dhe vërejtjet. Është koha të kalojmë në votim të amendamenteve, me vërejtjet e dhëna, normalisht.

Amendamenti 1.

Konstatohet se me 59 vota “për”, 5 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Konstatohet se me 64 vota “për”, 6 “kundër”, 4 abstenime, miratohet edhe amendamenti 2.

Tani do ta votojmë tekstin e plotë bashkë me amendamentet që i kaluam.

Konstatohet se me 60 vota “për”, 6 “kundër”, 3 abstenime, ligji miratohet. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 03/L-42 i produkteve për mbrojtjen e bimëve

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe Kuvendit ia kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se Projektligji ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Komunitete ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Përpara se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin ose raportuesin e komisionit funksional. Nuk paraqitet askush nga Komisioni dhe nuk e shoh të nevojshme për arsyetimin e amendamenteve. Kjo nuk është e domosdoshme, domethënë nuk ka paraqitje. Atëherë, kalojmë në votimin e amendamenteve. Votojmë tash:

Amendamenti 1.

Konstatohet se me 79 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Armend Zemaj e ka fjalën për amendamentin 2.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Tek amendamenti numër 2, desha ta them edhe në fillim, titulli i Projektligjit duhet të përdoret njësoj në tërë tekstin e projektligjit. Pra, duhet ta dimë a është Projektligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve apo Projektligjin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

KRYESUESI: Deputeti Berat Luzha!

BERAT LUZHA: Zoti kryesues, titulli është: Projektligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve. Po ka pasur disa variante gjatë tekstit të ligjit, prandaj është bërë ky amendament - Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve.

KRYESUESI: Urdhëro, zonja Elhame!

ELHAME HETEMI: Po, zoti kryesues, ju faleminderit!

Gjatë shqyrtimit në komisionit funksional, do me thënë janë përdorë të dy alternativat edhe ka qenë kontestuese të përdoret - Ligji për produktet për mbrojtjen e bimëve apo Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe në Komision është amenduar dhe vendosur që në ligj të përdoret- Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve. Domethënë, kështu të përdoret në tërë tekstin e ligjit- Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve.

KRYESUESI: U krye. Ju faleminderit zonjë, por pikërisht ky formulim ishte edhe këtu si e lexova unë.

Kalojmë në votimin e amendamentit nr. 2

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamentin nr. 3.

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamentin nr. 4.

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr.4.

Amendamentin nr. 5.

Me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti nr.5.

Amendamentin nr. 6.

Më 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Tani votojmë ligjin në tërësi, bashkë me amendamentet që i votuam tash.

Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve miratohet me 77 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim.

Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën 15 të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë private

Projektligji për sigurinë private është miratuar në parim në seancën plenare të mbajtur me 4 prill 2008.

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional, e ka shqyrtuar disa herë radhazi këtë projektligj dhe Kuvendit i ka paraqitur Raport me rekomandim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, zotin Rrustem Mustafa, që të paraqesë Rekomandimin e Komisionit. Urdhëroni, zoti Mustafa!

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Projektligji për sigurinë private, ashtu siç e thatë ju, është proceduar nga Komisioni në lexim të parë, por edhe në lexim të dytë.

Kryesia e Kuvendit, në pajtim me grupet parlamentare, më 17 korrik 2008, u pajtua për ta ndalur procedimin e mëtutjeshëm. Ne kemi gjetur rrugë dhe kemi kontaktuar me ICO, EULEX edhe Zyrën amerikane dhe kemi ardhur në përfundim për ta bërë një punëtori në Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, kështu që ajo punë ka ndodhur. Aty kanë ndodhur ndryshime të shumta në ligj, kemi shqyrtuar ligjin nen për nen dhe kemi ardhur në përfundim se është punë e vështirë, por ne kemi bërë përpjekje për ta amenduar këtë ligj, kështu që e kemi parë të arsyeshme që Komisioni të rekomandojë që t’ia kthejmë sponsorit - Ministrisë së Punëve të Brendshme për ta proceduar më tutje ligjin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ne e dëgjuam rekomandimin e komisionit funksional për Siguri dhe unë këtë rekomandim, që thotë: Ligji t’i kthehet sponsorit, e nxjerr në votim. Votojmë tash:

Me 80 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet Rekomandimi i Komisionit. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën 16 të rendit të ditës:

Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Telekomunikacion, në pajtim me nenin 35 të Ligjit për konkurrencën, ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë për emërtimin anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime. Raporti i Komisionit, së bashku me dokumentacionin, u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetaren e Komisionit, zonjën Myzejene Selmani, që para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë Raportin me rekomandime. Fjalën e ka zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në bazë të vendimit që ka ardhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, më 19.8.2008, në përzgjedhjen prej 10 kandidatëve për Komisionin e Konkurrencës, sipas procedurave të përcaktuara të Ligjit për konkurrencën në Kosovë, ka marrë një vendim në seleksionimin e një grupi punues më 2.10.2008, ku janë intervistuar kandidatët dhe Komisioni, në pajtim me Ligjin e konkurrencës, ka miratuar listën prej 5 kandidatëve të Komisionit të Konkurrencës.

I ftoj deputetët që të votojnë këtë grup të pesë kandidatëve për Komisionin e Konkurrencës. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Radha e diskutuesve është nga grupet parlamentare. Ftoj përfaqësuesen e Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeten Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përkrah rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Telekomunikacion dhe Transport dhe është i mendimit që ky këshill i konkurrencës më në fund duhet të zgjidhet, sepse është obligativ për respektimin e ligjit, për zbatimin e Ligjit për konkurrencën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Hadergjonaj!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deri të merreni vesh ju LDK-ja, Shkumbin Demaliaj, besoj, në emër të Grupit të AKR-së.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse kryetarja e Komisionit e tha fjalën e vet lidhur me rekomandimet që kanë sjellë në Kuvend, ne si grup parlamentar jemi “për”.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Demaliaj! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Po, në Komision kemi pasur shumë debate rreth zgjedhjes së kandidatëve. Mendoj se ka ardhur në shprehje funksionimi i plotë i koalicionit LDK-PDK në zgjedhjen e konkurrencës, prandaj ka mbetur që të shkojë edhe më tutje. Ne i kemi mbështetur vetëm që të vijmë sa më shpejt deri te zgjedhja e këtyre anëtarëve të këtij komisioni, që është shumë i rëndësishëm për konkurrencën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, Agim Veliu e ka fjalën!

AGIM VELIU: Ju faleminderit, Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit dhe si të tillë e pranon.

KRYETARI: Berim Ramosaj e ka fjalën!

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Pas shumë peripecive që ka pasur Komisioni funksional për Ekonomi, vërtet kemi pasur telashe në përzgjedhjen e këtij grupi, respektivisht të këtyre anëtarëve të Komisionit për Konkurrencë. Kam obligim para Kuvendit të them se interferimet politike ishin aq të

mëdha sa që nuk kanë lënë as panelin intervistues në fakt të bënë përzgjedhjen në bazë të kualiteteve.

Mirëpo, duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë që ka në këtë fazë ky grup, vërtet për të respektuar konkurrencën në treg, qoftë në format koncesionare, qoftë në format partneriste, qoftë format e tenderimeve që paraqiten, ne jemi për atë që të bëhet grupi, por si LDD ju jap të drejtë deputetëve të LDD-së të përcaktohen individualisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, a e dëshiron dikush fjalën?

MÜFERA ŞINIK: Sayın Başkan, biz bunu 7+ Parlamenter grubu olarak görüştük, ancak adaylar arasında topluluk temsilcilerinden hiç bir aday olmadığından dolayı oyumuzu çekimser kullunacağız. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të SLS-së, nuk ka të paraqitur për fjalë. Atëherë, kalojmë në procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konsideroj se me 55 vota “për”, 5 “kundër”, 16 abstenime, Kuvendi e miratoi rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës.

Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e radhës:

18. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Raportin e grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin e grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm dhe ka rekomanduar që ai të shqyrtohet në seancën plenare.

Raporti i Grupit të punës dhe rekomandimi i Komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Kryetari i këtij Komisioni ka qenë deputeti Armend Zemaj.

Ne e kemi një raport të Komisionit dhe ia japim fjalën anëtarit të Komisionit që ka qenë përgjegjës për ta bërë raportin, pra ne presim fjalën e anëtarit për ta paraqitur raportin e tij. Por, ne nuk mund ta presim dhe e shtyjme pikën e rendit të ditës për shkak të mungesës së ministrit. Nëse ju jeni dakord për ta hequr këtë pikë të rendit të ditës, ne mund ta bëjmë këtë, nuk ka problem. Ta dëgjojmë fjalën e deputetit Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe unë do të isha plotësisht shumë dakord që të jetë ministri i pranishëm, por për shkak të rëndësisë edhe procedurës që ka filluar për ndryshim dhe plotësimin e këtij ligji, mendoj që nuk kemi arsye shtesë që ta shtyjme. Edhe ashtu rekomandimet do t'i dërgohen Ministrisë përkatëse dhe Qeverisë së Republikës të Kosovës. Unë mendoj që nuk është e tepërt ta diskutojmë edhe të gjitha ato çka dalin nga debati edhe nga ju,

deputetë të nderuar, Ministria përkatëse apo Qeveria mund t'i marrë. Nuk e di nëse është e nevojshme ta shtyjme apo mos ta shtyjme për ndonjë seancë të radhës për shkak të kohës.

(Reagime nga vendi, nuk dëgjohen për transkriptim)

KRYTARI: Të nderuar deputetë,

Ne e kemi obligim ta dëgjojmë raportuesin, pastaj secili nga ju e keni të drejtë ta merrni fjalën dhe ta shfaqni mendimin tuaj. Prandaj, ta dëgjojmë deputetin.

Fjalën do ta merrni pasi ta thotë fjalën e vet raportuesi, Armend, e ke fjalën!

(Reagime nga vendi, nuk dëgjohen për transkriptim)

ARMEND ZEMAJ: Jo, po presim pak.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, veç shkurt e jep propozimin.

BESA GAXHERI: Shumë shkurt, zoti Kryetar.

Faleminderit, zoti Kryetar! Grupi punues prej 4 anëtarëve të Komisionit të Buxhetit ka punuar raportin për Ligjin për auditimin e brendshëm. Edhe në ligj thotë që ministri ka obligim që për çdo vit t'i raportojë Kuvendit për implementimin e ligjit të caktuar të dikasterit të vet. Pikërisht ky komision ka bërë këtë raport për ta lexuar këtu para deputetëve, opinionit të qytetarëve, por të jetë ministri prezent, kështu kërkon Rregullorja dhe ligji dhe, natyrisht, ministri duhet të na jap përgjigje pse nuk implementohet ligji konkret që sot kemi bërë raport për te. Andaj, unë propozoj që ky raport nuk mund të diskutohet pa prezencën e ministrit.

KRYETARI: Faleminderit, shumë! Ju keni propozuar, unë jam i obliguar ta hedhë propozimin tuaj në votim.

Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Kërkesa e deputetes është për ta hequr. Ju lutem, asnjë fjalë më tepër. Është mocioni për ta shtyrë këtë pikë të rendit të ditës për shkak të mungesës së ministrit dhe unë tash këtë kërkesë, këtë mocion po e hedh në votim, ju keni të drejtë të votoni.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota "për", 27 "kundër", 5 abstenime, shtyhet pika e 18 e rendit të ditës për seancë tjetër.

Pika 19 e rendit të ditës:

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i SLS-së ka vendosur që anëtar i Komisionit për Punë të Jashtme, në vend të deputetes Radmila Vujoviq, të emërohet deputeti Dragisha Miriq, ndërsa në Komisionin për Bujqësi dhe Pylltari në vend të deputetes Kosara Nikoliq, të emërohet deputeti Dragisha Miriq. Ky ishte njoftim.

Tani në radhë është koha për pyetje parlamentare. Ne po e caktojmë një pauzë deri në 11,45 minuta, e pastaj kthehemi në sallë dhe kërkojmë që ministrat dhe Qeveria të jenë të pranishëm për përgjigje.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, zini vendet tuaja!

Të nderuar deputetë, pika- pyetje parlamentare, për mungesë të ministrave të Qeverisë hiqet nga rendi i ditës për sot, domethënë shtyhet për një herë tjetër. Sot, në orën 14,00 do të mbahet seancë e re parlamentare.

Ftesa u është shpërndarë, bashkë me rendin e ditës dhe e keni në kutitë tuaja.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës